

E

BIBLIOTEKA

8JH-32

P 93

SHTETIT

GJIROKASTËR

Josif Prifti

**Një mbrëmje
vonë**

tregime

8JH-32

PP3

JOSIF PRIFTI

3573



Një mbrëmje
vonë
tregime

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Një mbrëmje vonë

Sillni ndër mend një sondë që kërkon naf-të pranë një pylli buzë lumit. Pikërisht kësh-tu ndodhi kjo ngjarje.

Nisi një mbrëmje vere, kur dielli u fsheh pas kodrës, poshtë së cilës ndehet deri në det një fushë. Atje mbi kodër ai la purpurin e vet që ngjyrosi një re të bardhë. Në kufi të pyllit dalloje shelgje, plepa dhe rrape. Puhiza e mbrë-mjes i freskoi motin. Mevlani ndjeu të ftohtë dhe ktheu kokën nga shoku në krah.

— Do ta ndezim zjarrin? — tha.

Tjetri nuk iu përgjigj në çast, por vështroi dritën në qiell.

— Është herët, — tha ai, — nuk mblidhet kush në barakë në këtë kohë.

Mevlani rrotulloi trupin, u mbështet në bërryla dhe hodhi sytë lart, nga ngriheshin majat e pemëve.

— E di çfarë, — tha ai, — mbrëmja po vjen aq e pastër, sa nuk të shkon mendja për mot të keq. A nuk e nderim këtu?

Xhevat Çela i dha të drejtë Mevlanit. Ata do të qëndronin pranë pusit, në gatishmëri. Gjatë procesit mund të kishte avari. Xhevat Çela, mirëmbajtës motorësh dhe Mevlani, elektrikist, prej aty do ta kishin më të lehtë ta ndiqnin punën.

Pas pak pluhuri i muzgut u vështirësoi të parët. Mevlani ndezi dritat e kullës. Vëndi përçark u ndriçua, kurse përtej këtij kufiri mbrëmja u bë më e errët.

Puhiza tanimë ndihej fare pak. Shushurima e pyllit humbiste në zhurmën e motorëve, që u bë më e mprehtë. Mevlani shkoi në barakë e sollti peliçet. Zjarri bubullonte. Xhevat Çela kishte grumbulluar një kopicë me shkarpa dhe, kur u mbështet, mori një syresh.

— Mos na dalë ndonjë avari sonte.

— Kushedi, varet nga tubimi në pus, — u përgjigj Mevlani.

Xhevat Çela pohoi me kokë dhe hodhi sytë në drejtim të kullës. Kishte një fytyrë të vogël, me mjekrën të lakuar paksa përpjetë; gojën e mbante të shtrënguar dhe nuk i dalloje dot formën e buzëve, veçse kur fliste, por edhe atëherë e mbante kryet ulur. Kurse sytë e vegjël, nën vetullat e përhimta, i ngulte diku anash, si i menduar.

Dikur, vinte më parë, ai kishte punuar krye-

sondist në pusin e shpim-kërkimit. Një natë, në ndërresën e tretë, ndaj mëngjesit, u plagos në kokë. Dërrasat e bazamentit u lagën nga një shi i hollë që nisi në të gdhirë dhe ai gjatë lëvizjes u rrëzua. Plagën e mori të rëndë. Në spital qëndroi disa muaj, sa u shërua mirë. Kur doli, kërkoi të punonte në vendin e mëparshëm, por nuk pranuan. Detyra e kryesondistit kërkon tendosje të fortë nervash. Ai nguli këmbë, por nuk e lanë. Madje në drejtori kishin mendimin të largohej për fare nga sonda. Por nuk donte Xhevat Çela, sepse zanati i naftëtarit i kishte hyrë në shpirt. Atëherë shokët vendosën ta mbanin. Nga kjo kohë Xhevat Çela punoi si mirëmbajtës motorësh. Për të mjaftonte të qe pranë sondës e të dëgjonte zhurmën e saj. Kur gjente kohë të lirë, ngjitej lart dhe i tërë pulsi i sondës i hynte në vena.

Në qetësinë e mbrëmjes, dëgjohej gjithnjë e më tepër zhurma e motorëve. Kush është naftëtar i regjur, e ndien pulsën e motorëve edhe pa qenë pranë. Kudo qoftë, duke dëgjuar që zhurmojnë në rëndë, mendon se kryesondisti ka ulur çelësin e gazit dhe talja ngrihet lart. Pas një minute ai kap një tingull metalik që vjen nga montimi i tubit në elevator. Përsëri motorët zhurmojnë dhe tubat, duke u rrotulluar, ulen poshtë, drejt thellësive të reja. Ndodh që gjatë shpimit motorët sforcohen vetiu dhe nxjerrin shtëllunga tymi të cilat vrapojnë lart. Atëherë naftëtari mendon se dalta ka ndeshur në tokë të fortë; fill pas kësaj kryesondisti manevron me bishtakun.

Edhe Xhevat Çela atë mbrëmje dëgjonte zhurmat, duke u përpjekur të zbulonte ndonjë defekt që mund të shkaktohej gjatë punës. Sa për Mevlanin, fikja e dritave ishte sinjali që do të dukej faqeza defekti. Po rrinte përballë drurëve me trungjet e zhveshura që ndriçoheshin zbehtë

nga drita. Prej andej ai dalloi të lëvizte diçka, pastaj edhe një tjetër. Ishin dy kafshë me samarët bosh. Pas i ndiqte një njeri. Pasi hodhën edhe ca çape, ai doli përpara dhe i lidhi kafshët në trungun e hollë të pemës. Iu kthye pastaj zjarrit, hodhi sytë nga gjerdani i llambave në kullë dhe u çapit ngadalë. Mevlani po e ndiqte me sy, ndërsa Xhevat Çela nuk e ndjeu nga zhurma e motorëve, veçse, kur ai u avit pranë, i dalloi hijen. Ktheu kokën dhe pa një mesoburrë që priste në këmbë.

— Tungjatjeta e mirë se rrini, — tha i porsaardhuri.

— Mirë se vjen, — i thanë me një gojë ata dhe lëvizën.

I porsaardhuri u afrua dhe drita e zjarrit i ndriçoi qartë fytyrën.

— Ju ka bujtur një mik sonte, — tha ai.

— Miku që është mik, nderohet — i tha Xhevat Çela, — Urdhëro e ulu me këto që kemi!

— Falemnderit, do të ulem se s'kam kasolle më të ngrohtë sonte. — Dhe u ul.

— Nga të kemi, or mik? — pyeti Xhevat Çela.

Miku hoqi nën vete një dru shkarpe.

— Përtej lumit... — tha duke treguar fshatin.

— Nuk qenke larg, or mik, — foli përsëri Xhevat Çela.

— I kësaj krahine jam, — ai ai. — M'u mbyll lundra dhe mbeta këtej.

— Zjarr kemi boll. Bukën e kemi atje lart, në mensë. Po t'u hëngër, shkojmë, — tha Xhevat Çela.

— Kam në trastë, — u përgjigj miku duke bërë me kokë në drejtim të kafshëve.

Ai mbante veshur një xhakëtë kadife të zezë dalëboje. Dukej se dielli e kishte rrahur tepër.

Nga xhepi i xhaketës nxori kutinë me duhan dhe nisi ta dridhte në gjethe.

Ata të dy u zunë ngushtë. Miku më parë duhej ta ndizte nga kutia e tyre, por asnjëri nga të dy nuk e pinte. Ai drodhi cigaren i qetë, ndërsa ata e vështronin.

Ai kishte një fytyrë të kuqe, të përzhitur, në formën e potkoit. Mbi flokët e shkurtër mbante një kasketë. Trupin e kishte të brishtë, ndërsa dy pëllëmbët e duarve të trasha e të mëdha kishin ca gishtrinj që mezi lëviznin kur dridhnin fletën. Mbaroi, mori një thëngjill në pëllëmbë, ndezi cigaren dhe e thithi fort.

— Kërkoni naftë?

Ata tundën kokat.

— Kemi vite që jetojmë këtu dhe nuk e dinim se nën themelet toma...

— E ku ta dinim. Kemi qenë injorantë.

Miku uli kokën dhe vështroi zjarrin i men-duar. Si dukej nuk e kuptoi fjalën «injorant».

Pas një grime heshtjeje ai pyeti për punën e naftës përsëri. Pastaj e pyetën ata. Mësuan se quhej Gani Vëngu, nga një fshat në zemër të krahinës. Kishte dy djem dhe tri vajza. Djalin e madh e kishte martuar këtu e dy vjet të shkuar. Të voglit atë vit do t'i bënte dasmën.

Pasi foli Gani Vëngu, heshtën. Errësira kishte rënë gjithandej. Vetëm në territorin e pusit ndriçonte drita disi e kuqe, si agu i mëngjesit. Kush është naftëtar, di se ç'është agu i mëngjesit me ngjyrë alle, mjegulla e kaltër që vesh pastaj mallin dhe lindja e diellit që ndrit vesën dhe kërcellin më të hollë. Di ç'është vapa dhe zhegu plasaritës, por sheh edhe perëndimin e mah-nitshëm mbi kodër, në një qiell të kthjellët. Sheh edhe shndritjen e dëborës mbi tubat e çeliktë, ndien spicat e mprehta të erës që flak tej mbe-turinat e vjeshtës bashkë me frymëzimin e poe-

tëve. Ja, pra, naftëtari i ndien këto në jetën e tij dhe gëzohet sepse e di ç'ndodh përçark botës.

Motorët utërinin fort. Xhevat Çela vështron-te gjithnjë andej. Miku pinte duhan dhe mendohej. Herë - herë hidhte sytë nga kafshët.

— Pse nuk kullotin? — pyeti Mevlani.

— Boll hëngrën, — u përgjigj Gani Vëngu.

— Lëshoji të përtypen, — u hodh Xhevat Çela. — Kafsha, edhe kur dremit, përtypet.

— Jo, — tha prerë miku.

— Lëshoji, or mik, lëshoji, — i tha Xhevat Çela si për t'i mëshiruar kafshët.

— Ikin, — u përgjigj Gani Vëngu, — sot i mora. Nuk e kanë shkelur këtë udhë, edhe mua pak më njohin.

— Sa i bleve? — pyeti Mevlani.

Gani Vëngu tha shumë e lekëve.

— Pse dy, or mik, boll një. Puna e kafshës ka rënë në fshat, — foli Xhevat Çela.

— Do të ketë hall ndonjë shok... — u justifikua miku.

— Aha... do të bësh tregti. Bie erë spekulim... Kështu ishte njëri në fshatin tonë. Thashë «ishte», o mik. E kuptoj se është prodhim pa bukë kjo punë.

Xhevat Çela e vështroi gjatë kur mbaroi. Miku e pa dhe nuk i erdhi mirë. Nxori përsëri kurtinë e nisi të dridhte cigaren.

— Ke ditë që ke ikur nga fshati? — pyeti përsëri Xhevat Çela duke mos ia hequr sytë.

— Tri ditë sot. Sonte do të isha sosur, mos...

— Tri ditë punë të humbura.

Gani Vëngu nuk iu përgjigj. Ai nuk kishte dëshirë ta zgjaste këtë bisedë. Një fjalë të mirë nuk dëgjoi. Një natë më parë ishte gdhirë te një mik. Edhe ai me gjemb e kishte shpuar. Po Gani Vëngu ç'bënte tjetër, përveçse gjuante mallin e zgjedhur? E blinte dhe e shiste gjetkë. Si-

gurisht fitimi bënte punën e vet (mundi i tij duhej të shpërblehej). Bleu tri lopë dhe tani kishte hequr ca para mënjanë, për dasmën e djalit. Djali i madh ia theu zemrën. Bisedonte një ditë me të.

«Shko shite kafshën në pazar. Shite dhe blije më të lirë. Mbaje ca kohë, pastaj shite më shtrenjtë».

Djali nuk e kishte dëgjuar.

«Po të them se të kam pjellën time. Nuk rron vetëm me krahët në kooperativë».

Djali përsëri nuk kishte folur. Kur i shihnin ndarë, i pati thënë se nuk i pëlqente puna e tij... E rriti, e bëri me nuse, tani ia hidhte poshtë punën. «Po s'i bëre hije vetas, nuk të dallon tjetri», mendonte. Fjalën «spekulim» e kishte dëgjuar për herë të parë nga kryetari i këshillit në fshat. E ndeshi përpara zyrave, buzë mbrëmjes. Ai kthehej nga pazari. Kryetari e pa dhe e ndali. Ai qëndroi në mëdyshje.

«Ke kohë që s'e ke parë baltën e arave», kishte thënë kryetari.

«Më dhembin kockat tani, kryetar», ishte përgjigjur.

Kryetari nuk e kishte besuar.

«Të mbetën këmbët lart e poshtë fshatrave, Gani Vëngu. Nuk je në udhë të mbarë.»

Gani Vëngu kishte dashur të bënte shaka.

«Të mbledh dhe unë ndonjë lek, i tha, shokët rrojnë më mirë.»

«Rrojnë me djersën e ballit, prandaj u ndrit shtëpia, ia kishte kthyer kryetari, ti bën spekulim».

Ai hëngri veten udhës deri në shtëpi. Ky kryetari plakej me hallin e tjetrit. Kush i kishte thënë? Ndonjë nga ata që i lëpihet. U mundua të sillte ndër mend ndonjë syresh. Të gjithë në një vijë rridhnin për të. Pse flisni për

Gani Vëngun?... Pse flisni, hë?... Pse...? Se spekulon. Ç'do të thotë kjo fjalë? Vjedhje? Më mirë nën dhe, se të hysh në hakun e tjetrit. Kusa-rit ia bëjnë me gisht në fshat... Sa të rëndë e kishte fjalën ky kryetari i këshillit. Po, kryetari me atë llaf e ndau nga fshati. Pse e ndau? Se spekulonte. Po kjo nuk ishte vjedhje. Po pse e quajti ashtu kryetari atëherë? Më shkoqur ta kishte thënë. Kush e ka shtyrë? Se edhe kishte që nuk e donin Gani Vëngun... apo jo? Më parë nuk flisnin kështu. Më parë e lëvdonin. Po ai nuk donte lëvdata. Donte lekë. Kjo punë kishte lekë... po nder kishte? Më mirë të mos qe nisur, një llaf të mirë nuk dëgjoi. Kryetari, shokët, miqtë... edhe ky shoku këtu pranë zjarrit shtrembër e pa. «Gani Vëngu nuk është në udhë të shokëve»... Ngriti kokën e i pa. Ata rrinin pranë zjarrit.

— Dremite, or mik?

— Më lodhi udha, — u përgjigj ai, — afroi pleqëria.

— Kemi barakën atje. A shkon t'ia marrësh me gjumë?

— Jo, mirë jam këtu.

Dëgjohej vetëm zhurma e fortë e motorëve. Ata po punonin të sforcuar. Këtë mendoi Xhevat Çela. Zjarri ndriçonte vendin me flakë të kuqe. Kafshët dremitnin në këmbë.

Befas motorët ulën ritmin, u dëgjua një thirrje, më pas përsëri zhurma e motorëve, këtë radhë e butë.

— Avari. — tha Xhevat Çela dhe u ngrit në këmbë.

U ngrit dhe Mevlani. Të dy vrapuan drejt sondës, duke e lënë mikun pranë zjarrit. Ai qëndroi një kohë të shkurtër aty, pastaj mendoi të shkonte, por mbeti në këmbë, kur vuri re naftëtarët që po ktheheshin.

— Ç'ka ndodhur? — pyeti ai.

Xhevat Çela qëndroi përballë zjarrit duke vështruar nga barakat e punëtorëve.

— Është këputur litari.

Miku nuk e dinte ç'do të thoshte të këputej litari gjatë procesit të tubimit. Kuptoi vetëm se ishte diçka e rëndësishme. E kuptoi nga shqetësimi i tjetrit. Por nuk pyeti, se kushedi si e kishin punën naftëtarët e s'donin llaf.

Xhevat Çela e prishi qetësinë.

— Ti, Mevlan, shko zgjo turnin. Litari i ri duhet të vihet derisa të agojë.

Mevlani humbi pas fashës së dritës. Xhevat Çela mbeti në këmbë.

— Ti, mik, do t'ia marrësh me gjumë? — i tha ai Gani Vëngut duke e parë drejt.

— Mirë jam. Po më erdhi gjumë, do të mbështetem këtu.

— Mirë atëherë. Unë po iki në sondë. Po shkove në barakë, ja tek e ke çelësin, — i tha dhe ia hodhi në prehër.

Gani Vëngu mbeti vetëm me zjarrin dhe dy kafshët që përtypeshin në këmbë. Zhurma e motorëve u shua. Nga sonda dëgjoheshin zëra punëtorësh.

Kishte kaluar mesnata dhe moti u ftoh shumë ngaqë vesonte. Ai i hodhi dru zjarrit dhe qëndroi në këmbë, me fytyrë nga sonda. Nga barakat po vinin punëtorët që ishin në pushim. Ata kaluan duke nxituar në sheshin me dritë, derisa hipën në bazament. Pas disa minutash ai pa aty disa trupa që lëviznin me kujdes dhe ndriçoheshin herë - herë nga drita. «Do të bien», tha me zë të mekur. Por asgjë nuk ndodhi. Litari i këputur u ul në tokë. Pas atij çasti Gani Vëngu mendoi se punëtorët do të pushonin dhe shtyu zjarrin. Por kaluan minutat dhe askush nuk u duk aty. Ndërkohë u afrua një grup punëtorësh, të cilët vetëm se kthyen kokat dhe qëndruan më

tej, pranë tamburit me litarin e ri. Ai duhej të çohet pranë sondës. Provuan ta shtynin, por nuk mundën ta lëviznin nga vendi. Erdhën të tjerë, por përsëri ai nuk lëvizi. Punëtorët nisën t'i vinnin rrotull për të gjetur mënyrën se si ta shkëputnin nga vendi ku ishte hedhur.

Gani Vëngu iu afrua grupit të punëtorëve dhe ndoqi lëvizjet e tyre.

Në jetën e tij ai nuk kishte pasur rast të shihet natë më të zhurmshme. Në fshatin e tij nata ishte e qetë, me ndonjë të lehur qeni aty-këtu. Vetëm në pranverë ushtonin traktorët që çajnë ugaret. Bile edhe ata ai kishte kohë që nuk po i ndiente. Netët po kalonin në udhët qorre. Sa herë ai i kishte thënë vetes: mjaft më! Këtë fjalë e kishte pëshpëritur shpesh kur gjendej në qoshet e errëta të pyllit, por gdhiehet e nesërmja, dhe ai harronte ç'kishte thënë. Ditët kalonin dhe ai përherë e më shumë e ndiente veten të huaj mes fshatarëve. Disa mezi i flisnin, disa të tjerë hidhnin romuze kur kalonte ai. Kishte ditë që nuk dilte fare nga shtëpia. Herën e fundit i qelutur një miku t'i gjente dy kafshë të forta, se do të ngrinte shtëpinë e djalit. Tri ditë kishte ai që qelut larguar nga shtëpia. Në pazar kafshët qelut në rralluar. Pastaj mezi kishte rënë në ujdin për çmimin. Kur mori kafshën, pati dëshirë të shkonte një orë e më parë në fshat. Në vetmi, mes udhëve të errëta të pyllit, vetja i dukej i dobët, i huaj. Duke ecur drejt fshatit, kishte dëshirë të mbërrinte sa më parë atje. Vetëm kaq, të mbërrinte atje. Më tej nuk e dinte se çfarë do të bënte. Nuk kishte kurajë të mendonte asgjë. Vetëm një dëshirë kishte, të ndeshte edhe një herë kryetarin. Vetë do të heshte.

— Duhet makina ta tërheqë, — tha një punëtor.

— Makina ka shkuar për furnizim, — u përgjigj inxhinieri i pusit. Pastaj ai foli përsëri dhe tha të nxitonin. Punëtorët e provuan përsëri, por pa sukses.

— Përsëri, — thirri Gani Vëngu dhe iku tutje.

Ai solli kafshët. Ishin dy mushka të shëndosha. Gani Vëngu zgjidhi me të shpejtë litarët dhe i hodhi në tambur. Pas një minute ai nisi të lëvizte drejt sondës. Punëtorët e shtynin nga pas.

Se si vazhdoi puna më tej, një naftëtar e kupton më mirë. Litari kaloi në të gjitha karrukullat me shpejtësi. Kur mbaruan, u ndezën sërishmi motorët. Toka u drodh nga zhurma e tyre. Po bëhej prova e litarit.

Gani Vëngu kishte qëndruar disi i veçuar, me duart të lyera me grason e litarit. Ai nuk e kuptoi se si kaloi tërë ajo kohë nëpër natë. Vetëm i kujtohej që punëtorët gjatë punës, e kishin vështruar me dashuri. Kur lidhën litarin, Xhevat Çela i tha:

— Qëndro me ne or mik.

Ai nuk iu përgjigj. Shkoi më tej dhe ndoqi provën e parë të litarit. Motorët uturin fort. Ai mendohej. Dy mushkat kullotnin në pyll. Prushi dallohej në shpuzën e rënë, së cilës vesa i kishte veshur një cipë hiri. Nuk i vinte gjumë, këmbët s'i bënë të lëvizte. Buzëqeshja e naftëtarëve i kishte mbetur në sy.

Në qiell kishte plasur drita. Ai nuk e vuri re se si iku aq shpejt ajo natë. Ngadalë vendi u mbush me dritë dhe Mevlani fiku llambat elektrike. Ai atëherë u kujtua për dy mushkat që kullotnin në pyll. I mori dhe u kthye ku ishte. Aty gjeti Xhevat Çelën. Nga sonda po vinte Mevlani me naftëtarët.

— Po ikën? — i tha Xhevat Çela.

— Ra dita, — tha ai, — tani hapet lundra.

U përçaruan të dy si miq të vjetër. Kur u ndanë, Xhevat Çela i tha:

— Të na falësh, se të prishëm gjumin sonte.

— Ç'është ajo fjalë. Unë ju bujta mik, por ju gjeta në hall. Po ja, bashkë e kaluam, — tha duke vështruar zjarrin e fikur. Ata heshtnin në këmbë. Ai donte të thoshte edhe diçka tjetër, por nuk foli. Me gjithë dashurinë e naftëtarëve ai e ndjeu veten ngushtë dhe nuk e kuptoi pse pati frikë mos ata zbulonin hallin e tij. Ndoshta pati frikë se pas kësaj fshihej nga fytyra e tyre ajo ndjenjë mirënjohjeje e dashurie. Ngriti kokën dhe buzëqeshi ngadalë. Pastaj i përqafoi. Në sytë e tyre dalloj lodhjen, por edhe buzëqeshjen. Atij i erdhi vërtet keq që po ndahej.

Nuk tha më asnjë fjalë, kërceu në samar të mushkës dhe ngau duke kthyer kokën, derisa humbi në drurët e dendur të pyllit.

Edhe gabon...

Ishte koha kur ndërrohej turni i dytë me të tretin. Mensa për pak minuta u mbush me naftëtarë. Në sportelin e kuzhinës punëtorët nxitonin, se po afronte koha e fillimit të punës. Shoferi ktheu kokën dhe pa në një tavolinë brigadierin, që qeshte me një djalosh të qethur shkurt. Ai vetë qe ulur në skaj të sallës, pranë banakut, me berberin e asaj qyteze naftëtarësh. Salla gumëzhinte nga bisedat që mbytnin njëra-tjetrën. Shoferi shihte herë pas here djaloshin e qethur shkurt.

— Nafta nuk ka disiplinë, — foli berberi që

qe ulur kundruall tij. Ai e vështroi me kujdes këtë njeri. Në fytyrën e berberit dalloheshin ca vija të holla gjaku. Dhe nuk e kuptoi pse ajo lloj lëkure i kujtoi kasapët. Sytë i kishte krejt të rrumbullakët e të dalë si kokërdhokë. Në mollëzat e faqeve, atje ku shquheshin më tepër venat, nisnin hendekun dy rrudha, të cilat treteshin pranë gojës së madhe. Hundën e kishte të përthyer, me gungë në mes.

— E qorrollis kalin me një të penguar, or mik, — tha shoferi.

Pastaj ai shkëputi sytë nga shoku përballë dhe pa naftëtarët. Në tavolinë pasoi një heshtje e shkurtër.

— Ti nuk e di, por thuamë mua që më vij në në rrojtore turlu njerëz, — foli përsëri berberi. — Ja, e sheh atë karafilin që ha bukë me brigadierin?... Shikoje si e kam bërë. Erdhi para ca ditësh. Mbi vesh i kishte flokët. I futa makinën dhe ja...

Shoferi pa përsëri nga tavolina ku po hanin brigadieri me djaloshin dhe diçka mendoi i heshur.

— Të them, — vazhdoi berberi, — se edhe ai brigadieri që është i moshuar e kishte lënë deri në atë pikë. Dhe ja, në vend që t'i flasë rreptë, qesh me të.

Shoferi ngriti gotën.

— Hajde, gëzuar... Po ti, pse s'more një?

— E kam zakon të mos pi lokaleve, — u përgjigj berberi. Shoferi ktheu njëherësh rakinë që kishte mbetur në gotë dhe i tha berberit:

— Unë jam shofer i naftës dhe i njoh naftëtarët. Ai brigadier gjysmën e jetës e kalon me atë djaloshin.

Berberi këtë radhë nuk foli. Shoferi vazhdoi.

— Ata janë punëtorë shpimi dhe vështirësitë që kalojnë ata në punë ti nuk i njeh. Ndaj të

thashë, që nuk qorrolliset kali me një të pen-
guar.

Në heshtjen që pasoi, berberi kundroi fyty-
rën e gjatë ezmere të shoferit, me flokët krejt të
bardhë e me një fizionomi të qeshur. Kuptohej
se ai burrë qe thinjur para kohe. Dy buzët e
holla i puthiste lehtë kur heshte.

— Marrim nga një gotë?

— Nuk po ta prish këtë radhë, — tha berberi.

Shoferi u kthye nga banaku dhe, për çudi, tha
«tri».

— Eja edhe ti, — i tha ai banakierit.

— Përse?

— Eja ulu! Puna mbaroi, iku turni.

Banakieri u ul dhe toku gotën. Berberi e
vështroi ngultas.

— Je në punë, djalo, — tha ai.

— S'ka gjë, — tha shoferi, — një gotë nuk i
bën dëm.

— Kështu mësohet kjo. Është dhe i ri.

Shoferi e vështroi në sy. Ky berberi iu duk
tip i çuditshëm. Kishte shëtitur shumë vende
dhe kishte zënë shumë shokë, por ky berberi
nuk ishte për të... Shoferi po mendonte diçka,
një histori të shkuar, e cila nuk po e linte të
qetë. Ajo i kishte ndodhur vitin e kaluar, kur
punonte në një qytet bregdetar... Berberi me ba-
nakierin diç bisedonin. Ai i ndoqi me sy. Berbe-
ri tha:

— Ju të rinjtë nuk duhet të pini.

— E ke gabim, or mik, — ia ktheu me të qe-
shur shoferi. — Ne kemi detyrime si prindër kar-
shi fëmijëve që t'u mësojmë këngën, rakinë, da-
shurinë për të tjerët. — Pastaj vazhdoi ngadalë —
Jo t'i presim gjërat me sëpatë. Gabon fëmija, ga-
bojmë edhe ne. E pastaj, ç'do të ndodhë?

— Nuk gabon prindi me fëmijën, — tha ber-
beri.

Shoferi pati dëshirë t'i shfrehej këtij njeriu. Por ata s'kishin veçse disa orë që ishin njohur dhe ai ngurroi për një çast. Sepse një shoku mund t'ia përplasësh të vërtetën në sy e pas kësaj të ecësh përsëri krah për krah me të, po me një njeri që porsa je njohur ndryshon puna. Megjithatë ai ia tha se ç'mendonte, me një zë të butë.

— Ne prindërit e fëmijëve gabojmë shumë në ndonjë rast, aq sa bëjmë edhe veprime të rënda.

Heshti, shkundi hirin e cigares në taketuke e ndërkohë iu shfaq përsëri ajo histori e shkuar. Dhe mendoi se njeriu e ka më të lehtë t'ua tregojë të tjerëve ato që e mundojnë, sesa t'i blujë në heshtje.



Atë mbrëmje ai e ndjeu veten tepër të lodhur. Gjithë ditën kishte qëndruar në timon. Dielli po ulej mbi det. Ai mbylli makinën dhe shkoi të çlodhej. Hoteli që ngritur në një kënd të qytetit, nën hijen e ullinjve ku pushonin punëtorët e naftës. Përçark ishte qetësi, vetëm tej nga lindja, në rrëzë të kodrës zhurmonte motori i një makine që kalonte me shpejtësi mbi asfalt. Pastaj ngadalë zhurma binte e dëgjohej vetëm era që tundte gjethet e ullinjve të moçëm. Ai priti një copë herë ulur në një stol të lulishtes përballë, derisa erdhi nëpunësja e hotelit. Kur iu afrova, ajo e vështroi një çast me dyshim, sidomos rrobat e tij gjithë vaj e uli sytë mbi regjistër.

— Do të jesh me një djalosh, — foli ajo kur

mbaroi. Ai ndjeu antipati në të folurën e saj. I kërkoi çelësin. Ajo e pa një hop, pastaj pyeti:

— Do të bini herët?

— Jam i lodhur, — ia ktheu ai.

Ngjiti shkallët me përtesë dhe hyri në dhomë. Ai hotel ishte pak komod dhe shoferi mendoi se që i përshtatshëm për ato rroba pune që mbante ai. Punën e kishte nisur që në pikë të mëngjesit, trupin e ndiente të lodhur. Ra mbi shtrat dhe e zuri gjumi. Nuk e kuptoi sa kishte fjetur kur e përmendi kërcitja e derës. Hyri një djalosh fare i ri. Kishte dy sy të butë ngjyrë gështenjëqë, për çudi të shoferit, shprehnin një pezmatim të madh. Fytyra e bardhë i vinte majuce, ndërsa mbi ballë flokët gështenjë i rrinin si strehë. Djaloshi iu afrua shtratit të shoferit, sa i preku pak dorën dhe u ul. Zgjidhi ngadalë këpucët, u shtri në shtrat thujse pa bërë zhurmë fare dhe ndenji shtrirë me shikim në tavan. Shoferit iu fashit gjumi. Djaloshi vazhdonte të shihte tavanin i menduar. Tjetri e kuptoi se ai s'kishte ndër mend të fliste, prandaj vendosi ta thyente vetë heshtjen.

— Nga të kemi, orë djalë?

Shoferi vuri re se djali s'kishte dëshirë të fliste. Ia nguli sytë i heshtur dhe priti. Djali më në fund u përgjigj:

— Nga ky qytet jam.

O, po pse nuk flinte në shtëpi? Një hall i madh e kishte pushtuar këtë djalosh, derisa flinte në hotelin e naftëtarëve. Të jesh pranë shtëpisë dhe të flesh në hotel, këtë s'mundi ta kuptonte shoferi. Prandaj e pyeti përsëri. Djaloshi tha se nuk ishte naftëtar, por që strehuar aty përkohësisht. Shoferin e brejti përsëri dyshimi.

— Përse nuk fle në shtëpi?

Djali nuk donte të fliste, por shoferi ngulmoi.

— Më ka dëbuar babai nga shtëpia, — foli ai më në fund.

— Përse?

Djaloshi nuk u përgjigj. Errësira kishte hyrë tinëz në dhomë. Shoferi u ngrit dhe ndezi llambën elektrike. Dalloi menjëherë brengën që pushtonte fytyrën e djaloshit.

— Përse? — përsëriti. Por në çast qortoi veten që ngulmoi. Djaloshi vuante, ndërsa ai shuante kureshtjen. Por tjetri nuk e la të mendohej gjatë sepse e theu vetë heshtjen.

— Diçka e paqartë më duket. Kur u ktheva nga ushtria, njerka u soll shumë mirë me mua. Më jepte lekë për cigare e gjithçka që më nevojitej... — nisi të tregonte ai ngadalë, me zë të ulët. Shoferi u bë i tëri sy e vesh. Ai fliste dhe shoferi mendohej të përfytyronte fytyrat e njerëzve për të cilët po flitej.

Një ditë prej ditësh, kur u kthye nga shëtitja me shokët, njerka e kishte pyetur se deri kur do të bridhte pa punë. Ai kishte vetëm një javë që ishte liruar nga ushtria. Mendonte të rrinte edhe ca ditë. Fjalët e njerkes i erdhën fare papritur. Dhe ç'të thoshte ajo në atë shtëpi, do të bëhej. Këtë e kishte provuar para ushtrisë. Megjithatë, njerka nuk i kishte folur asnjëherë ashpër. Ai punonte në një ndërmarrje ndërtimi. Aty paguhe-shin mbi rrogë sepse punonin edhe jashtë orarit. Kur shkoi ushtar, njerka sikur e harroi fare. Tani që u kthye, ajo befasi po ndryshonte qëndrim.

Të nesërmen, pa fjalë, shkoi në komitet. Atje i thanë të zinte punë në minierë, por ai nuk pranoi. Kërkoi ta çonin përsëri në ndërtim, por ata të komitetit nuk e ndryshuan mendimin. Kur i tha njerkes, ajo u xhindos, i tha se nuk mban-te dembela në shtëpi. Ai u mundua ta qetëson-te, por ajo i tha se pas kësaj që bëri nuk kishte më vend në atë shtëpi. Ai doli dhe shëtiti me

shokët. Në mbrëmje njerka po bisedonte me babanë. Edhe ai, sa hyri djali, ato fjalë i tha. Por djali nuk lëvizi. Mendoi se ishte inatosur e do të qetësohej; por babai nuk u qetësua as të nesërmen. Bile ia përsëriti më ashpër fjalët... Kishte ikur. Plot tri ditë që flinte aty. Dhe prej asaj dite nuk i kishte parë më. Vetëm e motra i erdhi të djeshmen. Ai nuk shkoi, megjithëse ajo iu lut me lot ndër sy. I la ca lekë e iku. Atij iu duk se i la lëmoshë...

Djaloshi heshti dhe vështroi në sy shoferin. Pas atij tregimi shoferit iu duk dhoma e zbrazët, e ftohtë, e heshtur. Dëshironte ta dëgjonte gjatë atë djalosh, pa pushim. Shoferit iu kujtu-an shtëpia, familja, gruaja e fëmijët në qytetin atje poshtë. Dhe nuk e kuptoi pse ndjeu mall për ta. Do të donte që të mos ishte kurrë larg. Por në çast e qortoi veten dhe tha se ai gjithmonë do të largohej me udhëtime, sepse puna e kërkonte gjithandej. Por kur të kthehej në shtëpi, gruaja do ta priste te dera. Pastaj pranë sobës do t'i tregonte me dashuri se djali i madh kishte marrë këtë notë në shkollë, vajza kishte mësuar filan këngë, ndërsa i vogli kishte filluar të ecte. Dhe ai, duke u larguar ca ditë nga fëmijët, do të kishte përse të mendonte... Po babai i djaloshit që flinte në një dhomë me të, përse mendohej vallë në ato çaste? Ndoshta bisedonte me të shoqen për plaçkat e reja që i duheshin shtëpisë.

Shoferi ngriti kokën dhe pa nga djali. Ai rrinte shtrirë, me sytë në tavan.

— Përse nuk zure punë në minierë, more djalë?

— Nuk e di si vendosa. Më kanë thënë se është front i vështirë, nuk e njoh.

— Po si mendon, në rast të kundërt do të ishin sjellë keq?

— Nuk e di.

— Ç'mendon të bësh tani?

Djaloshi ngriti supet.

— Do të zësh punë?

— ...

Biseda vazhdoi gjatë, derisa të dy i kllaposi gjumi.

Kur la hotelin në mëngjes, shoferi ndjeu dashuri për atë djalë.

Ngruhej herët në mëngjes, kur djali flinte ende dhe kthehej kur ai gjendej diku jashtë në qytet. Kur ishte në punë, i kujtohej ai. Dhe shpesh e pushtonte një melankoli e lehtë, sepse ai mund të largohej gjatë asaj kohe dhe s'do të kishte rast ta përshëndeste. Dhe çdo mbrëmje, kur e priste në dhomën e hotelit, gjithmonë e më shumë bindej se ai djalë një ditë nuk do të vinte. Por kalonin ditët dhe ai hynte në të njëjtën orë, duke sjellë trishtimin e syve të vet. Shoferi nuk e vështronte gjatë në sy, sepse nuk i bënte dot ballë atij trishtimi. Dhe ky çast po ia rëndonte mbi supe peshën e përgjegjësisë gjithmonë e më shumë. E ndjeu veten të detyruar t'ia largonte nga sytë atë trishtim.

*

* *

Ata të dy u ulën në stolat e një platforme betoni që zgjatej në det. Poshtë në shkëmbinjtë e bregut ushtonin valët shkumëbardha. Dielli por sa që zhytur në ujërat e detit të blertë. Nga Kepi i Gishtit deri tek ishulli, digjej një qiell i kuqërremtë. Në ujërat e gjirit nuk voziste asnjë anije. Buzë kanalit u ndezën fenerët e anijeve

të peshkimit; pas pak u ndezën edhe dritat e portit. Kur je buzë detit, mugëtira të pushton më herët, sepse deti e ka hijen më të rëndë nga toka. Pas shpinës së tyre shëtitorin çifte të rinjsh që shkonin në lokalin e madh anës detit. Babai i djalit ngriti pak jakën e xhaketës dhe tha:

— Me sa biseduam, kuptoj se unë nuk kam aspak të drejtë në këtë mes.

— Nuk erdha t'i jap të drejtë njërit apo tjetrit, por mendoj se veprimi juaj si prind është i gabuar, — tha shoferi.

Babai i djalit u mendua një çast duke parë valët shkumëbardha.

— Unë jam prindi i tij dhe kam të drejtë ta ndëshkoj kur gabon, — foli ai ngadalë, pa e ngritur kokën.

— Prindi ka detyra ndaj edukimit të fëmijëve. Kurse ai gaboi, gabuat edhe ju... Për sa i përket ndëshkimit, s'duhet bërë fjalë në këtë rast. Ndëshkimi më i mirë do të ishte që ju ta bindnit djalin se puna në minierë nuk ka kushedi ç'ndryshim nga ajo në ndërtim.

— Më falni, por mendoj se nuk e meritoj gjithë këtë moral. Me këto ligjëratat flitet vetëm në seanca gjyqësore.

— Unë, si qytetar i thjeshtë, erdha të bisedoj me ju si shok. Dhe mendoj se gjithkush që e ndien mbi shpatulla edukimin e brezit të ri, kështu si unë do të vepronte... E t'i lëmë këto. Po ju pyes. Si mendoni ju, se duke larguar djalin nga shtëpia, zhvishni edhe përgjegjësinë që mbani ndaj tij, po të qëndronte ai pa punë?... Jo, kurrësi jo. Duke mos e pasur pranë, ai ndoshta do të gabojë përsëri dhe juve ju shtohet përgjegjësia. Atëherë ju do të pendoheni për gabimin e parë që solli të dytin dhe pse jo, edhe të tre-

tin. Atëherë do t'i vijë radha ligjit të na korrigjojë... E prita gjatë një natë në hotel por ai s'po vinte. I mërzitur më zuri gjumi me mendimin se që kthyer në shtëpi. Vonë më zgjoi zhurma që bënte. Ai po zhvishej pa e ndezur dritën. U ngrita dhe e ndeza. U zu ngushtë. Ishte skuqur flakë në fytyrë dhe më tha:

«Më fal se të prisha gjumin.»

«S'ka gjë, — i thashë dhe u ula në shtrat. — Dëgjo, ne të dy jemi larg familjes, por ama jemi si një familje e vogël. Nuk po ta them si më i shtyrë në moshë, por sepse një tjetër i gjykon më mirë veprimet e shokut. Këto ditë ne jetojmë bashkë dhe s'do të më vinte mirë të të ndodhte diçka. Të lutem, eja më herët sepse shëtitja e vonë ndodh që është e dëmshme... Ai uli kokën dhe vështroi dyshtemenë. Ra në shtrat pa asnjë fjalë. Dhe nuk e përsëriti.

— Po ju kuptoj në një pikë. Jam nxituar kur u largova nga shtëpia.

— Ky është filli prej nga varen të tjerat.

— Jo, — kundërshtoi babai i djalit, — filli është kundërshtimi i tij për të zënë punë në minierë.

— Të kuptohemi drejt. Djali juaj nuk është parazit. Ai shfaq vetëm një koncept. Po përvoja ka treguar se rinia i ka flakur si lëvozhgë konceptet e dëmshme. Është një pretendim i lehtë, e sjell ngurrimi kur hedh hapat e zë një udhë të pashkelur. Më pas ajo rrugë atij i bëhet e dashur e plot kujtime. Djali juaj sapo ka hedhur hapat e vërtetë në jetë.

— Po kuptoj se jeni vënë plotësisht në mbrojtje të djalit tim.

Shoferi nuk iu përgjigj. Qenë ndezur dritat buzë detit. Mugëtira ishte shpërndarë gjithandej si pluhur i errët. Deti shtoi kumbimin e valëve. Nga pijetorja vinte melodia e një kënge që tretej

tej në valët kreshtëbardha. Në horizont, si gjethe ulliri luhateshin fenerët e motobarkave të peshkatarëve. Ata u ngritën dhe dolën në rrugë. Kumbimi i valëve u zbeh. Babai i djalit i kapi krahun shoferit dhe duke ecur i tha:

— Dje më thirrën në organizatën-bazë të partisë për këtë.

Një pjesë të udhës e kaluan në heshtje. Kur po ndaheshin, babai i djalit foli përsëri:

— Pas darke do të bisedoj edhe me gruan.

Shoferi e vështroi gjatë dhe i toku dorën. Babai i djalit kuptoi shumë nga ai vështtrim dhe pa majat e këpucëve. Kur ngriti kokën, shoferi i kishte humbur nga sytë.

*

* *

Shoferi rrinte në kreun e shtratit, mbi jastëkun e palosur. Djali që ulur përballë. Ata kishin këmbyer pak fjalë atë mbrëmje. Shoferi e pyeti si e kishte kaluar ditën. Djali i tha se kishte shkuar përsëri në komitet, por ata nuk e kthenin mendimin. Pastaj shtoi me zë të dobët se kishte ardhur përsëri e motra. Ajo i që lutur të shkonte. I tha se babai me njerikën ishin grindur natën e kaluar. Në mëngjes i kishte dërguar vajzën. Djali i tha shoferit se nuk e dinte a kishte bërë mirë që nuk vajti me të motrën.

Shoferi heshtte. Ç'e lidhte aq shumë me këtë djalë? Çdo mbrëmje e priste derisa lahej e vishej dhe dilnin bashkë. Ai po mendonte përsëri se një ditë djali do të largohej dhe kur të kthehej nga puna do të gjente dhomën bosh.

Në korridorin e hotelit u ndien hapa. Trokitën dhe dera u hap përgjysmë. Në kornizën e saj u duk babai i djalit. Ai mbeti një hop më këmbë, pastaj hoqi kasketën ngjyrë hiri dhe ho-dhi rëndë hapat në dyshtemenë e dhomës.

— Më falni, — foli ai duke parë nga shoferi.

— Ju lutem, — ia ktheu shoferi dhe u gjend në këmbë.

Babai u kthye nga djali, i cili rrinte ndenjor mbi shtrat me vështrim të papërqendruar dhe e pa ngultas në një grimë heshtjeje.

— Eja, — i tha babai djalit.

Djali nuk tha asnjë fjalë. U ngrit, mblodhi plaçkat e u nis. Te dera u kthye, përqafoi fort shoferin, i tha diçka e iku duke vështruar dyshtemenë. Babai dhe shoferi mbetën ca në këmbë. Pastaj dolën nga dhoma. Shoferi e shoqëroi një copë udhë. Djali ecte diku përpara. Trupi i tij i hollë shfaqej herë-herë nën dritën e neonit. Ata të dy bisedonin me zë të ulët e tërë kujdes, sikur u druheshin gabimeve në të shprehur. Në bulevard ndiheshin vetëm hapat e tyre. Befas babai i djalit tha:

— T'ju them diçka. Të kishte gabuar djali juaj, çfarë do t'i thoshit?

Shoferi ndali hapin dhe e pa drejt në sy.

— Si të jetë gabimi. Por gabimi nuk ndreqet me gabim.

Babai i djalit e pa drejt në sy dhe tundi kokën lehtë. Vazhduan të ecnin një copë udhë në heshtje. Diku tokën duart dhe u ndanë. Shoferi nuk shkoi drejt në hotel. Iu formua një zbrazëti në shpirt, kur mendoi se nuk do ta gjente atë djalë në dhomë. Edhe pse ai nuk e kishte vendin atje, për shoferin që bërë njeriu më i dashur në qytet.

Pas ca ditëve iku dhe nuk e pa më atë djalë.

Më vonë udhëtoi shpesh andej me makinë, e përherë e sillte ndërmend këtë ngjarje. Dëshironte gjithmonë t'ia tregonte dikujt por nuk mundi. Dhe ndoshta do ta kishte harruar atë histori, sikur ai djalë të mos i qe shfaqur para syve. Djali qeshte me brigadierin dhe shoferi u lumturua sepse kujtoi trishtimin e huaj që tretnin atëherë sytë e tij.

Gjyshi

Vitet e fundit jeta e tij shtrihej ndërmjet shtëpisë ku banonte dhe stanit. Shtëpia dhe stani ngriheshin në dy skajet e një kodre të bleruar. Në kodrinë ishin mbjellë pemë aty-këtu, kurse më pranë stanit ato dendësoheshin. Më poshtë, në rrjedhën e përroit, shtriheshin lëndinat e bukura me bar e lule. Akoma më poshtë, pranë lumit, bari mbulonte njeriun.

Bari i këtyre lëndinave kishte qënë për shumë kohë ushqim i njerëzve. Edhe tani luante po atë rol në jetën e tyre. Tregojnë, njëherë e në një kohë, bëri thatësirë e madhe, pikë shiu nuk

lëshoi qielli e bari, pa u mbirë mirë, u tha e u bë shkarpë. Njerëzia u merakos, me çfarë do t'i mbanin dhentë gjallë? U hapën mullarët e vjetër, trokitën dyert për hua, e përsëri në çdo stan ngordhën bagëti. Më pak vuajti Uan Çali, se bari i tij dukej sikur nuk shterrte kurrë. Përçark stanit të Uan Çalit ngriheshin mullarët e barit. Doje bar njëvjeçar, dyvjeçar, gjer edhe katërvjeçar kishte atje. Dhe përsëri ai nuk u ndahej lëndinave. Kur bari zgjatej e bëhej tendë, ai nuk gdhiehej asnjëherë në shtëpi.

Në mbrëmje Uan Çali thërriste plakën:

— Do të korrim sonte, apo jo?

Plaka vraponte të përgatiste darkën në trastë.

— Foli djalit, — dëgjonte ajo nga dritarja zërin e tij.

Uan Çali ulej në gurin e latuar, ku rrihte grurin, dhe vështronte oborrin. Hardhia po mbulonte me degët e saj avllinë gjithandej. Atë vit gjethja dukëj e mbarë. Shi ra deni në mesin e prillit dhe e rriti shumë gjethen.

«Lëndina do të mbulojë një bojë njeriu», mendoi Uan Çali dhe u ngrit të merrte draprin. Në derë ndeshi Banin. Ai priti që i ati t'i thoshte, si çdo mbrëmje, «nxito», por Uan Çali qenkësh i ngeshëm atë mbrëmje. Bani i lëshoi udhë të kalonte, u ul në gurin e latuar dhe priti.

Bani ishte rreth të pesëmbëdhjetave. Nga trupi i kalonte vërsnikët e tij, sepse ishte rritur lëndinave me bar e lule, pas gjyshit. Në të vërtetë atë e kishte baba, por mosha e gjatë që i ndante e bëri që në fëmijni ta thërriste «gjysh». Uan Çali nuk kundërshtoi. Bani ishte djali dhe fëmija e fundit që i mbeti. Gruaja e parë i la dy djem, por e ëma i mori shpejt me vete. Gruaja e dytë i dha dy djem të tjerë. (Ishte prag i ndezur për djem ai i Uan Çalit.) I madhi iu vra në luftë. Shokët e tij i sollën vetëm yllin që

mbante në kapele. Kishin kaluar nja tre vjet prej atëherë dhe ai ende e ruante yllin në sënduk. Banin e donte shumë, edhe emrin vetë ia kishte vënë. Dhe jo më kot... Edhe atëherë ishte pranverë e korrej bari. E shoqja erdhi ta ndihmonte. Ai i tha të shkonte në shtëpi se ishte shtatzënë, por ajo nuk iu bind. Ai korri shumë, kurse ajo mblodhi. Vonë atë e zunë dhembjet dhe lindi djalë. Foshnja hapi sytë mbi barin e njomë. Uan Çali nuk pyeti kumbarë kur vendosi ta quante «Bari». Po u kujtua se këtë emër e përdornin të gjithë fshatarët në fshatin e tij, prandaj e ndryshoi pak dhe djalin e quajti Bani.

Gjyshi doli, vështroi djalin dhe eci. Në sup i lëkundej drapri. Bani hodhi në krah trastën e bukës dhe eci në gjurmët e tij. Gjyshi kishte shpatulla të gjera dhe duar e këmbë të mëdha. Dielli kishte mundur t'i nxinte vetëm pjesën e sipërme të qafës, sepse Uan Çali nuk e zërbënte asnjëherë jakën. Në kokë mbante një feste të rrumbullakët si hënë e plotë me një bisht të vogël në mes. Kur ishte fëmijë, Bani i kishte thënë ta punonte në ngjyrën e hënës, por nëna ishte përgjigjur se ata nuk kishin dele të verdha. Uan Çali kishte qeshur me lot...

Bani gulçonte pas tij. Balli iu mbush me bulëza djerse. Me hapin e Uan Çalit s'kishte burrë të matej. Dolën në kodrinën e bleruar. Prej atje kuptohej mirë që pranvera kishte hedhur kudo farën e gjelbërimit. Iu afruan kasolles. Flladi i mbrëmjes tundte lulet e bardha të dardhës. Një tis i hollë po zbriste nga mali. Uan Çali u mbështet në trungun e dardhës. Bani nuk i dha rëndësi. Pleqëria bën punën e vet. Gjyshi kishte një jetë të tërë që nuk e kishte mbështetur dorën asgjekundi.

Para kasolles Uan Çali u ul mbi barin e ndehur për t'u tharë. Mbështeti shpatullat në gardh e thirri:

— Bani, o bir, zgjidhe Zikun!

Qeni erdhi e iu hodh në krahë e në prehër. Ai ia mori kokën e ia puthiti në gjoksin e tij. Qeni lehu ngjirur nga dhembja. Bani po i ndiqte çdo lëvizje. Gjyshi e ndiente, por s'e bënte veten. Qeni u hodh e iku tutje, derisa nuk u dallua më. Po binte muzgu i mbrëmjes.

Uan Çalit nuk i vinte të ngrihej. Bani iku të merrte mushkën. Atëherë doli hëna si napë e plotë djathi. Gjithçka përçark u vesh me argjend. Edhe vetë ai. U dëgjua zilja e mushkës. Ai mendohej i tretur në të kaluarën. Mushkën e kishte marrë nga reforma. Bagëtinë e shtoi vetë, edhe shtëpinë vetë e ngriti. Dorën askujt nuk ia shtriu. Vetëm një merak kishte pasur ngahera — të rritej Bani, pa dhe të vdiste, se vitet, kushedi, i kishte mbushur. Por për Uan Çalin s'gjendej vdekje. Vërsnikët e tij, ca kishin vdekur, ca s'mund të kalonin as lesën e oborrit. Kurse ai ende kornte bar e gdihej lëndinave.

«Si nuk vdiq atëherë...» Banit iu kujtua rrëfimi i nënës. Kështu tregonte gjithmonë ajo. Si nuk vdiq atëherë... Uan Çali e kishte parë nënën e tij, kur kjo ishte vajzë, te pushi i fshatit. E pa dhe e kërkoi për nuse. Si jetim, Uan Çali shkoi vetë në shtëpinë e saj. Por kishte thyer zakonin. Vajzën e kërkonte lajmësi. Krushku në vend të fjalës i tregoi pushkën. Uan Çali nuk fliste për herë të dytë. Iku, por fjalën e la aty. Nusen e rrëmbeu një ditë vjeshte. Vjehri i dërgoi fjalë se do ta trashëgonte i vdekur. Krisi pushka, e me të madhe. Krismat pushuan kur ajo lindi fëmijën e parë. Dhe pas kësaj Uan Çali rroi dhe e trashëgoi. Të gjithë besonin se për

të nuk do të kishte vdekje. Motmot vdekja e tij u harrua. E mbuloi puna e tij...

Atë natë pse nuk po ngrihej? Ashtu e gjeti Bani. Uan Çalit i ngjau përsëri se i biri po e vështronte gjatë atë mbrëmje.. «Do ketë ndonjë hall, — mendoi — u rrit tani. Me atë Rinën, vajzën e bujkut, si shumë i hahet muhabeti. Atë natë, prandaj u vonua. E priti, kur ajo shejtane kthehej nga lopët, kështu më tha plaka. Eh, dhe ajo plaka ime, sa shumë i vë re këto gjëra. Unë s'dua t'ia di. E do, merre. Vetëm po ta desh zemra, po foli ajo. Zemra, ajo është e gjitha...»

— Doli hëna, — foli Bani si për ta përmendur.

— Si herët më duket, — u përgjigj Uan Çali dhe u rehatua më mirë në barin e butë. Bani u ul pranë. Bari lëshonte erën e trëndelinës dhe ai u kujtua se ndaj binte erë qumështi i deles. I biri mendohej e nuk fliste. Edhe gjyshi mendohej. «Kërkon nuse shejtani», tha me vete. Kurse Banit i rëndonte zemra. Tani gjyshi duhej të kishte nisur të korrte, ndërsa kotej e vështronte yjet dhe hënën.

— Dëgjon, Bani?

— Po, gjysh.

— Hëna e ka dritën më të mirë se dielli.

—Po, gjysh.

Bani mendoi se gjyshi kishte të drejtë të fliste ashtu. Atë e kishte rrahur më tepër drita e saj.

Ai qëndronte mbështetur në gardhin e kësulles. Donte të çlodhej, të shtrihej, ta kapiste gjumi gjersa t'i mpiheshin kockat. Ngadalë iu kujtua një këngë e largët:

*Hasmi kurrë s'të pa të shtrirë.
Perçen kurrë s'ta preku dheu.*

Oi, oi, Uan Çali kishte derdhur djersë si uji i kroit. Kush më tepër se ai kishte punuar mbrëmjeve me hënë? Kush më tepër se ai kishte thithur aromën e barit të njomë? Kush? Ai edhe njomëzakun e porsalindur e mbështolli me bar... Ngriti dorën dhe i largoi tutje turinjte e mushkës. Ajo ishte afruar pa u ndier. Si nuk e dëgjoi zilen ai? Ktheu kokën dhe pa që ajo ishte zënë me bar. U ngrit me kërcim e u afrua.

— Kush e zuri zilen? — pyeti.

— Unë, gjysh!

— Po përse?

— Mos të të shqetësonte ty, gjysh.

Uan Çali qeshi nën mustaqe. Sytë e zinj u mbyllën edhe më.

Perçen kurrë s'ta preku dheu...

Ky varg i këngës herë afrohej, herë largohej, si ajo dega e dëllinjës që tundet nga era.

Mushka çante udhën. Tingujt e ziles treshin në zukatjen e natës. Uan Çalit po i kujtohej ajo kohë e këngës... Atëherë shkoi me Kito Vllahun në luftë. Ishin shokë dhe vëllezër. Këngën e këndonin bashkë, pas betejës. Mblidheshin tok dhe komandanti gëzonte me ta. Ai ishte një burrë i shkurtër me mustaqe. Këngën e donte shumë. Më vonë edhe atij i ngritën një këngë. E këndonin mbrëmjeve pas betejës. Mblidheshin kokë më kokë dhe mbanin iso. Uan Çali e merrte shtruar, ngrinte sytë lart, drejt maleve, si t'u kërkonte jehonën, Kito Vllahu i hidhte dorën në sup e ia kthente. Pastaj isoja e shokëve mbushte krejt hapësirën dhe këngët pasonin njëra-tjetrën. Shokët e plagosur afroheshin ngadalë; kënga u shëronte plagët. Ndodhte në mbrëmje që në grupin e këngës të mungonte një iso.

Shokët këndonin me lot në sy. Në mes atij korrri zërash melodiozë ndihej betimi për fitore. Dhe erdhi beteja e fundit, kur e hodhën hasmin tute. Por Kito Vllahu nuk u kthye me këmbët e veta. Plumbi e mori në kraharor. Uan Çali i vuri krahun të mos binte dhe e solli në shpinë. Ecën një ditë udhë...

Në këmbë rrojte, në këmbë vdekjen prite.

Mushka ecte me zor në të tatëpjetën. Fshatarët e tjerë kishin nisur të korrnin më herët. Tani çlodheshin e bisedonin. Atij i erdhi të kthehej, t'u fliste, t'u uronte punë të mbarë, por u kujtua se ishte vonuar shumë të kasollja. Ai kishte kaluar një jetë të tërë me ta. Ishin të gjithë të mirë, të ndershëm e punëtorë. Vetëm nuk jetohet. Vetëm edhe druri nuk digjet. Kishte nga ata që shalonin hilenë. A, të ligut largoj. Po fjete një natë me qorrin, vëngër do shohësh, po fjete dy net, do të gdhiesh qorr.

Mushka ndali. Bani doli para dhe hodhi draprin. Kishte nisur të vesonte. Bari i gjatë ndehej si dallgë. Ata nisën të korrnin. Bani bënte kapiçat. Vendi i korrur u bë pellg.

Korrën shumë, derisa u lodhën. Bani ndjeu se gjyshi nuk mbushej mirë me frymë. Uan Çali u ul mbi barin e njomë, me fytyrë nga qielli.

Dëgjohej kënga e bilbilit dhe përtyppja e mushkës që zgjidhte barin. Uan Çali vështronte të birin. Draprin në dorë e kalonte si tespihe.

— U rrite tani, bir, u bëre burrë.

Bani nuk po kuptonte se ku do të dilte i ati.

— Unë u plaça shumë, e hëngra çairin. Ti të bëhesh i fortë e të mbash shtëpinë.

— Po, gjysh, do të bëhem.

Bani nuk po kuptonte se ç'kishte i ati atë natë. Zërin e nxirrte të butë, pushimet i bënte

më të gjata. Mbase ishte i lodhur. Kush s'di të gatujë, sit gjithë ditën. Oi, po Uan Çalit nuk i kishte përtuar kurrë dora dhe këmba! Zilja e mushkës nuk po dëgjohej më.

— Merr më vonë një nuse që të ta dojë nëna dhe zemra, — foli gjyshi.

— Edhe ti ta duash, gjysh.

— Po, bir, po. Sonte u vonuam ca, hë?

— S'ka gjë, gjysh. Erdhëm vonë. Bar kemi.

— Nesër do të vijmë më herët, hë?

— Po, herët.

Bani u ngrit të kërkonte mushkën. Uan Çali e ndoqi një copë herë me sy, gjersa humbi në mugëtirën e dritës së hënës. Pastaj u mbështet mirë në barin e posakorrur dhe mbylli sytë. Dëllinja — këngë i luhatej në kokë! Qëndroi gjatë ashtu, gjersa ndjeu të ftohtë. Vesonte dendur. Diçka tej tundi barin. «Po ky Bani përse nuk u duk?» U ngrit dhe për një çast qëndroi ashtu në këmbë, i kthyer nga iku i biri. Kur u ul të merrte draprin, i therën kockat. «Ndenja shumë shtrirë, veson», tha ai me vete dhe eci. Hapat i hodhi të rëndë. Brezi i barit gjendej larg. Arriti atje e nisi të korrte me të shpejtë. Vesa përthiente në draprin e lagur dritën e hënës.

Korri gjatë, derisa u lodh e ra mbi bar. I erdhi të mbyllte sytë, të flinte një copë herë. Ai mbyllte sytë kur hëna fikte dritën mbrapa malit. Tani ajo ndriçonte mbi kokë e atij iu duk se po qeshte me të. Dëllinja — këngë nuk po i lartgohej nga mendja.

Në këmbë rrojte, në këmbë...

Oi, oi, Uan Çali u turpërua në pleqëri. U ngrit mbi bërryla e vështroi përreth. Nata ishte e bukur, si një ditë që e vështron nga xhami

i verdhë. Ai nuk gjeti forca të ngrihej. Këputi një kërcell dhe e përtypi. Lëngu iu duk i shijshëm. Pastaj e pa. Iu duk i verdhë. Po ai vetë, Uan Çali me mustaqe, si do të ishte vallë? Zgjati dorën dhe nxori pasqyrën nga xhepi. Në dritën e hënës pa fytyrën e vet. Hoqi festen dhe e la mbi bar. Flokët i kishin rënë mbi ballë. I rregulloi me dorë, derisa në xhamin e pasqyrës ra hëna. Ai vështroi lart. Lëvizi dorën tjetër dhe me pëllëmbën e madhe mbuloi xhamin e pasqyrës. Hëna fiku dritën në pëllëmbën e tij. Koka po i rëndonte. Edhe sytë. Ngadalë drita e hënës u fik edhe në sytë dhe Uan Çali nuk ndjeu më asgjë nga bota që e rrethonte dhe e gëzonte...

Bani nuk e gjeti te kapicat e barit kur u kthye. Pengoi mushkën dhe vështroi përçark. Dëgjoheshin zukatja e natës dhe kënga e bilbil. Gjyshi nuk ishte aty dhe ai u shqetësua. Ndërkohë u kujtua se frymëmarrja e gjyshit atë natë kishte qenë e rëndë, si asnjëherë tjetër. Nisi ta kërkonte, por nuk e shquajti gjëkund.

Bari i korrur kishte shkuar larg. Vesa i lagu këmbët.

— Gjysh, — i mëshoi zërit fort.

Asnjë nuk u përgjigj. Atij iu duk se zëri nuk e grisi dot perden e natës. Ecte pa ditur ku shkelte. Nata i dukej hon pa fund.

— O gjysh, o babë, — thirri, por u përgjigj vetëm bilbili i natës. Herë ecte, herë rëndonte mbi barin që i plekste këmbët. Ai nuk ndiente asgjë, ai kërkonte gjyshin, babën e vet. «Si nuk vdiq atëherë!...» Bari i pengonte këmbët. «Motmot vdekja e gjyshit u harrua fare. Atë e mbuloi puna e tij.» Ai u rrëzua. U ngrit përsëri. Duart ia lagu vesa. «Të gjithë besonin se për Uan Çalin s'kishte vdekje.» Po ku do të ishte? Këtë pyetje e bëri disa herë... Befas ndali. Edhe hë-

na ndali vrapin në qiell. Gjyshi i tij nuk po korrte. Gjyshi i tij po flinte. Në buzë i kishte rënë një fiqe bari. Në buzë... ato nuk po lëviznin. Çfarë kishin belbëzuar për herë të parë në këtë botë? Ndoshta nënë, ndoshta bar e punë. Po së fundi? «Unë u plaka shumë, e hëngra çairin. Ti të bëhesh i fortë e të mbash shtëpinë.» Ndoshta aty, mbështetur në kopicën e barit të korrur, kishte belbëzuar edhe diçka tjetër. Diçka si amanet të punës, të draprit. Ndoshta gjyshi kishte thënë që krahët e të birit të bashkoheshin me ata të fshatit. Kështu kopicat bëhen më shumë, edhe dhentë shtohen më shpejt, edhe misri mbin më dendur... «Mirë, gjysh, mirë». Por gjyshi nuk e dëgjo. Nuk lëvizi as qepallat. Ai flinte përgjithnjë.

Bani iu afrua dhe i hoqi draprin nga dora.

«Le të flejë është lodhur. Lodhja do gjumin.»

Bani pëshpëriti pa e hequr shikimin nga fytyra e Uan Çalit.

Mushkën e kërkoi në mëngjes herët.

Lirikat e dy stinëve

Një ditë vere

Një mëngjes vere kthehesha nga fshati. Kur dola mbi kodër, përpara m'u hap një pejzash i mrekullueshëm. Fusha e gjelbëruar ndehej si qilim nën mjegullën e hollë të mëngjesit; shiriti kaltërosh i lumit e priste mes për mes. Në kufirin e tejme të fushës nisnin kodrat e Malla-kastrës e pas tyre maja e Tomorit zbardhëllonte prej dëborës së përjetshme.

Vështrova lart qiellin, i cili qe zhytur i tëri në avuj të kaltër. Dielli plasi si një lëmsh i zjarrtë mbi Tomor. Toka ndriçoi më tepër, vesa e paktë shkëlqeu dhe kënga e zogjve kumboi në pyllin aty poshtë. Mes drurëve të pyllit pa-

shë një shtresë lulësh të bardha. Petalet e tyre lidheshin fort në polenin e verdhë e të butë si pluhur, e gjithë kurora mbahej në një kërcell të brishtë, të kuqërremtë. Toka nën pyll qe mbushur e tëra me lule. Ja, më tej një trumbë vezake me një lloj tjetër luleje. Petalet e bardha të kësaj formonin një kurorë të bukur të rrethuar si me dantellë, e cila lidhej në një kërcell ngjyrë jargavani. Bëra çudi se polenin nuk munda ta dalloja në mes të petaleve. Mblodha shumë lule atë mëngjes, dhe secilës i flisja me emrin e vet. Por këto dy lule nuk munda t'i përcaktoja. I mbylla në çantë dhe mendova të pyesja biologun e shkollës së fshatit tonë, ose më mirë xha Koçon. S'ka bimë mbi tokë që të mos e njohë xha Koçoja. Siç njeh me pëllëmbë tokën e këtyre anëve.

Pylli vinte i ulët e me shkurre. Lulet e verdha të ilqes mbushnin vendin trumba-trumba. Midis degëve dëgjohej kënga e zogjve. Këndonin kryeartëza, bilbili, mullenja... fiu... fiu... uuu. Kënga e zogjve në mëngjes, nën degët e pyllit, është dehëse. Ja dhe një zog tjetër. Ç'do të qe? Ai kërcente në degët e ilqes, fshehur në lulet e verdha. Çrë.... çrë... çrë, lëshonte ai zërin e bukur, duke u përdredhur rreth vetes. Ishte një zog me sqepin si të kaftë, me kapuç të zi, me gushën e bardhë e me pupla të përhimë. Ai kërcëu mbi një degë tjetër dhe nisi përsëri këngën e vet.

Udha zbriste gjithmonë nëpër pyll. Pasi eca edhe ca, rashë në zabel. Prej aty kundroja si në pëllëmbë shtratin e lumit të gjerë. Mbi rërë, buzë ujit, vura re dikë që hidhte guralecë në lumë. Kur u afrova, pashë se qe vajza e xha Koços. Ajo nuk më ndjeu. Ndoshta nga rrjedha nanuritëse apo ngaqë në një mëngjes të tillë njeriu harrohet lehtë. Ajo po këndonte me të ulët një motiv fshati. Këndonte me zërin e hollë të fshe-

hur thellë në gjoks, siç këndojnë vajzat kur gjenden vetëm. Kënga që shumë e bukur, me një melodi që ta hovte kraharorin si në vrapin mes pyllit në ajrin e mëngjesit.

Mora një guralec dhe ia hodha pranë. Stërkalat e ujit i lagën fytyrën. Ndërpreu këngën dhe u kthye nga unë.

— O, tungjatjeta, poet! Ke ardhur të shkruash për fshatin?

I thashë se do të që më mirë të më fliste në emër, si bashkëfshatarë që ishin. Ajo buzëqeshi. Ngaqë ishte përballë diellit, i rrudhi paksa sytë e zinj. Kishte lidhur një shami të bardhë në qafë, siç bëjnë vajzat e fushës për t'u ruajtur nga dielli, një bluzë basme dhe pantallona dotu të përveshura gjer në gjunjë. Sandalet i kishte lënë mënjanë, kurse këmbët e nxira nga dielli i mbante në ujë.

Vajza e xha Koços vazhdonte shkollën e lartë, në pushimet e verës hynte në punë në kooperativë.

Dielli i mëngjesit të përzhiste kokën në një pikë. Mbi rërë, në këmbë, qëndronin pelat dhe kuajt e kooperativës.

— Nuk kullotin? — pyeta duke bërë shenjë me kokë.

— Tani kullotin herët, — tha ajo. — Po doli maji, vesa është e paktë.

I thashë për vesën në barin e kodrës.

— Qe nga mjegulla, — tha ajo. — Sot kishte pak mjegull. Në këto ditë kafsha zbret në lumë vetëm për t'u freskuar. Etjen që u jep bari e shuajnë me vesën që pinë.

Një pelë e veçuar qëndronte pa lëvizur, në këmbë, mbi rërën e nxehtë. Në hijen që formonte trupi i saj, mbi rërë, shtrirë në brinjë, rrinte një mëz i vogël që dremiste lehtë e qetë.

Lugina ndriste nga rrezet e mëngjesit. Ajri i

kulluar u mbështoll me një si mjegull të lehtë, të bardhë. Drita e fortë e diellit të vishte sytë. Ujërat e lumit rridhnin qetësisht mbi guralecë. Herë-herë në thellësi, një krap a troftë kërcente mbi sipërfaqe për të kapur ushqimin fluturak. Dy pulëbardha shkonin mbi lumë si të qenë në garë, pastaj një syresh u shkëput drejt ujit, sa mënt u mbyt, por ja, u ngrit përsëri. Në sqepin e saj përplaste bishtin një krap i hollë. Pulëbardha tjetër e priti në ajër gjersa mbërriti, dhe të dyja u tretën në sfondin kaltërosh, mes avujve të bardhë.

— Këta avuj do të formojnë retë, — foli vajza e xha Koços, — dhe përsëri këtu do të rridhin ujërat. Çdo gjë në lëvizje, çdo gjë jeton. I pe pulëbardhat? Siguruan ushqimin dhe u larguan. Patjetër ajo që priti në ajër ishte zogu që ka dalë nga veza e saj.

Vazhdoja të vështroja lumin tek rridhte në këngën e vet. Edhe lumi këndon. Ai këndon këngën e ujërave. Kur gjendesh thellë në pyll. nëpër degët e dendura dëgjon një shushurimë si rrëshqitja e gjarprit në gjethet e vjeshtës. Dhe thua se është lumi, sepse ke ndier këngën e tij. Çdo zhurmë është një notë nga melodia e madhe e natyrës.

Kuajt dhe pelat qenë larguar në pyllin tej. Vetëm pela me mëzin që flinte në hijen e saj rrinin mbi rërë.

I tregova vajzës për lulet që mblodha atë mëngjes dhe që mbaja mbyllur në çantë. Ato tani ndoshta qenë fishkur e rrudhur.

— Kur isha fëmijë, një ditë lulet që mblodha i hodha në zjarr, — tha ajo. — Babai i hoqi me të shpejtë dhe i nxori në shi. Më mirë t'i lagë shiu e t'i thajë dielli, — më tha.

Ajo nxori nga çanta një tufë me trëndelina. Atëherë e kuptova nga vinte ajo erë aq e kënd-

shme. Gjer atë çast pata përshtypjen se e dërgonte pylli me puhizën e lehtë. Ajo lagu kërce-llin e bimës në ujë. Pastaj më tha se trëndelinat i mblidhte për xha Koçon. Ai, pasi i than-te në diell, i shkërmoqte në duhan. Pra Koço Dëma pinte duhan me trëndelinë.

Edhe pse po frynte ajo puhizë që rrudhte lehtë sipërfaqen e shtruar të ujit, dielli u bë i padurueshëm. Mëzi vazhdonte të flinte në hijen e trupit të mëmës. Avujt e bardhë u dendësu-an, qielli u bë më kaltërosh. Mbi shpinat e ma-leave avujt zienin si një shtresë e xhamtë. Kish-te nisur zhegu përvëlues që vlonte edhe gurin.

Vajza e xha Koços u ngrit dhe përkuli më tepër strehën e shamisë mbi ballin e kuqërremtë. Pasqyra e ujit i hidhte mbi fytyrë r Rathë të bardhë.

— Do të shkoj, se erdhi koha, — tha ajo.

U ngrita, mora çantën dhe eca pas saj. Diku, ku udha ndahej, i lashë lamtumirën dhe ika. Rrugës qortova veten. Nuk qe asgjë e zorshme të pyesje për lulet dhe zogjtë që këndonin aq bukur në pyll. Mund ta kisha pyetur vajzën. Atë mëngjes më dukej sikur ajo dinte gjithçka për natyrën.

Ikën dallëndyshet

Kishte ditë që vapa qe platitur në gjethet e zverdhura të pemëve. Afshi i tretur digjte bu-zët e gjetheve pak e nga pak. Dielli në mëngjes hindte më i kuq, në mesditë përvëlimi i tij ndi-hej më tepër, kurse në mbrëmje era ia zbehte rrezet. Kur hyn vjeshta, pemët zhurmojnë më

shumë. Sepse edhe gulçi i erës shtohet. Ajo nuk është më një dorë ledhatare që të shpupurit flokët si dora e nënës kur mbështet kryet në prehrin e saj. Era nis e fortë e disi e vakët, toka thahet e plasarit, gjethet fluturojnë në qiell bashkë me balonat e fëmijëve. Për disa ditë fryn veriu, që nis aty nga mesdita, kur njerëzit ulen për drakë e vazhdon deri vonë. Mbrëmja bëhet më e bardhë dhe e ftohtë, nata nis e qetë, duke rrëzuar gjethë në kopsht. Por një ditë më pas era kthen drejtim, fryn me vrull juga e ngrohtë që rrëzon gjethë me potere. Në tokën e tharë formohet një pështjellim, pluhur e gjethë bashkë. Ajri bëhet i rëndë e mezi mbushesh me frymë.

Në një ditë të tillë kisha dalë në ballkon dhe shikoja kopshtin. Pemët kishin veshur petkun e verdhë. Diku në qoshe gjelbëronin ende gjethet e ftoit. Në kuisjen e erës ndiheshin edhe zhurma traktorësh. Diku në fushat e kooperativës po hapeshin brazdat e reja për mbjelljen e grurit.

Ishte ditë e diel. Motra ime e vogël, Ina, që posa ka nisur klasën e parë, më erdhi pranë në ballkon. Ajo ngriti kokën dhe pa follenë e dallëndysheve.

— Titi, shiko, po ikin dallëndyshet.

Ngrita kokën. Zogjtë e vegjël rrinin në buzë të folesë me krahë hapur gati për fluturim. Foleja që në formën e një gjysmësferë. Atë e ndër-tuan dy dallëndyshet e rritura me baltën dhe kashtën erëmirë të fshatit. Një mbrëmje ato fjetën aty. Kaluan shumë ditë dhe pastaj Ina dëgjoi e para, ciatjet e zogjve. Ajo u gëzua shumë dhe çdo ditë rrinte në ballkon e shihte si nxirrnin ato sqepin e vogël mbi buzët e folesë. Dy dallëndyshet e rritura i ushqenin të vegjlit me radhë, duke ua hedhur ushqimin në gojë. Ngadalë zogjtë e vegjël u rritën dhe nisën të stërviteshin në fluturim. Në fillim ata bënin

një rreth përmbi ballkon dhe ktheheshin në fole...

Atë mëngjes ata u shkëputën nga foleja dhe qëndruan mbi degët e hardhisë. Ishin pesë zogj dhe secili ciaste gëzueshëm mbi degë. Ata gëzonin për fluturimin e tyre të parë. Ina, hidhej përpjetë dhe tundte krahët fort.

— Shiko, Titi, shiko, fluturuan zogjtë e vegjël. Po ikin, po ikin...

Mezi e binda Inën dhe dolëm përtej kopshtit ku po hapeshin brazdat për mbjellje. Ina nuk donte të shkëputej nga zërat e zogjve të dallëndysheve. Derisa dolëm në fushë, ajo ktheu disa herë kokën pas.

Në fushë ndihej më mirë fryma e vjesh-tës. Bari që zverdhur gjithandej, buzë kana-leve koçanët gjembaçë qenë tharë. Ina kërcente lart për të mos u cimbisur. U ulëm buzë kanalit. Toka kishte marrë një ngjyrë kafe në të murrmë. Nga brazdat e posahapura ngrihej një pluhur i lehtë që ndiqte pas traktorin. Vështrova qiellin lart. Kaltërsia që bërë blana-blana nga retë e hirta. Mbi kurrizin e kodrave projektoshin hijet e reve. Ndjeva hapat e Inës që vraponte me kërcime. Në dorë ajo mbante si shkop kërcellin e thatë të fasules së egër.

— Titi, po vjen traktori, — thirri ajo.

Traktori ndaloi pranë nesh. Zhurna e tij na shurdhoi një çast dhe Ina u struk në trupin tim. Nga kabina nxori kokën Lila, motra jonë e madhe. Ajo kishte disa vjet që punonte traktoriste.

— Do të hipni? — thirri fort ajo për të mbytur zhurmën e motorit.

E kuptova nga shenja që bëri me kokë. Ina, sa e pa, u gëzua pa masë dhe nisi të hidhej përpjetë. Hipëm në traktor. Lila shtoi gazin

dhe traktori çau përpara. Kur mori kthesën, ajo tërhoqi litarin që hynte në kabinë nga një birë. Ina e vuri re dhe zgjati dorën.

— Mos e prek, shpirt. Kështu hapet brazda më thellë, — i tha Lila.

— Pse hapet ai kanali? — pyeti Ina të motrën.

— Do të bëjmë bukën, xhan.

— Bukë... — Ina qeshi fort. Unë e tërhoqa nga vetja se ajo s'përmbahej nga gëzimi. Shpesh prekte levat e hekurta me dorë, pastaj ngrinte kokën zgjaste dhe buzët nga vëshi im.

— Sa mirë, Titi, — thoshte duke qeshur. Unë i ledhatoja flokët e bukur që i binin mbi ballë. Lila vështronte përpara për të mbajtur drejtimin e brazdave. Ndonjëherë na vështronte ne dhe buzëqeshte. Ina s'pushonte së pyeturi motrën e vet.

— Sa shumë kanale hape ti, Lila?

— Shumë do hapim.

— Nuk bie ky traktori yt?

— Jo, nuk bie, xhan i motrës.

— Pushon ndonjëherë ky, Lila?

— Edhe pushon.

— Po kush i hap kanalet pastaj?

— Ky do t'i hapë dhe shokët e tij.

— Pse, kemi shumë ne?

— Po, shumë. I bëjmë vetë, xhan i motrës.

— Lila, po kur të rritem unë, do më japësh një?

Në kabinë hynte vlaga e brazdës së porsahapur. Nuk e di pse ajo kishte erën e grurit. Ndoshta ngaqë atje çdo vit dimëron fara e tij. Traktori bëri edhe një kthesë dhe ndali. U hodhëm poshtë me Inën dhe qëndruam buzë ledhit të kanalit. Traktori u nis përsëri dhe Ina vazhdonte të tundte dorën e vogël që përshëndeste motrën traktoriste.

Në tokë u ndeh hija e një reje të madhe që zuri dritën e diellit. Ndërkohë mbi fshatin tonë ishin shtruar retë e shiut. Kapërcyem kanalën dhe shpejtuam hapin. Atëherë nisi të rigojë edhe shiu. Ina më hoqi për dore e thirri:

— Po dallëndyshet?

Kur u gjendëm në ballkon, shiu nisi me furi e shqotë. Pikat e mëdha binin me zhurmë mbi gjethet e thara. Pluhuri ra, ajri u bë më i freskët. Nga toka ngrihej aroma e dheut të tharë. Përçark, gjithandej, natyra zhurmonte me një melodi ritmike.

— Titi, po lagen dallëndyshet.

Mbi degët e hardhisë dëgjoheshin ende ciatjet e zogjve. Ina që bërë pikë e helm në fytyrë. Zogjtë ngriheshin disa metra në qiell, por s'mund të fluturonin. Ata tani rrinin pranë e pranë. Pas pak në qiell u dukën dy dallëndyshet e rritura. Zogjtë thirrën fort nga gëzimi. Njëri u përpoq të fluturonte, por shqota e rrëzoi në tokë. Ina klithi dhe vrapoi në oborr. E arrita dhe e ktheva. Në sytë e vegjël pashë të njomeshin qerpikët. E qetësova dhe e çova përsëri në ballkon. Ajo nuk i shqiste sytë nga dallëndyshja e rrëzuar. Por atje shkoi dallëndyshja e rritur dhe të dyja së bashku fluturuan në qiellin me shi. S'kaloi shumë dhe dallëndyshja mëmë u duk përsëri në qiell e për çdo herë që vinte, ajo merrte nga një zog. (Sa shpejt që kthehej). Ina thërriste:

— Ikën, Titi, ikën dallëndyshet.

Ktheva kokën dhe i buzëqesha. Ajo hidhej lart dhe tundte krahët fort. Nuk e di përse më ngjau me një dallëndyshe që kërkonte të rritej. Ndoshta hidhej që të shkante te dallëndyshet, por ajo nuk do t'i arrinte dot dhe nuk do t'i shihte më zogjtë e saj të dashur që e braktisën posa hyri vjeshta.

Rita

Muzgu po binte ngadalë mbi kodrinën ku qe vendosur agjencia. Jashtë frynte një erë e ftohtë që të thante.

Në mëngjesin e asaj dite ra dëborë. Ajo u përplas me shkulme ere në dritare nga veriu, zbardhi shpejt çatitë, derisa qielli u plasarit dhe midis reve u duk një diell i zbehtë. Çatitë pikuan një copë herë e pastaj dielli u fsheh dhe nisi përsëri të frynte era e ftohtë që të priste fytyrën.

Kisha mbaruar punë në atë qytet të Jugut dhe dola në agjenci. Atje të rrihte pa pushim era e detit. Në sallën e vogël të biletarisë bënte disi ngrohtë. U ula në një stol pranë dritares dhe nisa të vështroja kodrat buzë detit. Kuro-

rat e ullinjve genë bërë si të përhimë nga rrahjet e pamëshirshme të erës. Në një pjesë të horizontit mbi kodra të dukej sikur vazhdonin reshjet e dëborës.

Në sallë ishte heshtje e plotë dhe kjo na bënte ta ndienim më tepër motin jashtë. M'u kujtua kthina ime e ngrohtë dhe nuk e di pse ndjeva një zbrazëti në shpirt, tani që gjendesha larg saj. Për një çast m'u duk vendlindja shumë larg, sikur s'do të mund të arrija atje. Dera e sallës u hap dhe dolën disa udhëtarë. Pa e kuptuar u gjenda vetëm, dhe kohën tjetër vazhdova të vështroja dëborën që zbardhte atë ditë janari.

U bë zhurmë në sportelin e biletave. Atje u duk koka bjonde e nëpunëses. Prisja të thoshte «a keni ftohtë», kur ajo rrotulloi sytë në sallë e pyeti:

— Kush është për në S.?

U ngrita dhe mora biletën. Vrunduajt e erës m'u përplasën në fytyrë. Ngrita jakën dhe vrapova. Ishte një autobus i vogël. Dera u hap një sekondë, sa hyra unë dhe u mbyll me vërtik.

— Ku është tjetri? — pyeti shoferi kur zura vend.

Ngrita supet. Ai mbante gazin ndezur. Pastaj i ra borisë fort, derisa në dritare doli nëpunësja. Ajo ngriti dorën si të thoshte, «prisni 5 minuta».

Shoferi bëri ca shenja nervozizmi. Nëpunësja iku nga dritarja dhe erdhi e hapi dërrën e makinës. Brenda hyri ajri i ftohtë.

— Mbylle, se na plevitose, — thirri shoferi.

— Teli, pas pak mund të vijë ajo çobania,
— tha nëpunësja.

Shoferi hoqi duart nga timoni dhe fiku gazin.

— Mos vonohet, e shikon se ç'mot po vjen?

— Nuk kam me se ta nis, pas teje.

— Mirë, mirë, po pres, — tha Teli.

Atëherë vura re se në autobus, pranë meje, qe një vend bosh. Në ndenjëset e tjera qenë ulur punëtorët e minierës ku shkante autobusi. Rruga për në minierë kalonte nga qyteza ku banoja... U hap dera dhe hyri një vajzë që mbante për dore një fëmijë. Kur ajo zuri vend pranë meje, shoferi ndezi makinën.

— Pse u vonove? — e pyeti shoferi.

— Tani mbaruam, sot kisha dhe mbesën.

— E ç'e more në këtë të ftohtë?

— Më qe lutur disa herë. Atje në stan nuk ka me se të merret.

Udha gjarpëronte mes ullinjve. Në çdo kthesë bërryli im prekte vajzën që posa hipi. E mbesa qëndronte në këmbë midis nesh.

— Ulu, — i thashë dhe i hapa vend.

Ajo u ul e bindur dhe më hodhi sytë me druajtje.

— Teli, nuk e prisja të kaloje në këtë orë, — foli vajza.

— U vonova në oficinë, — u përgjigj Teli.

— Pothuajse harrova që sot është e hënë.

Motori gulçonte në të ngjitur; minatorët për-kuleshin lehtë. Në dritën e projektorëve loznin fjollat e holla të dëborës. Makina kaloi një kthesë të fortë.

— Si është xha Pilua, — pyeti Teli.

— Të kujton gjithmonë. Atij djali i jemi borxhlinj, thotë.

Shoferi qeshi.

— Nuk u ngulët dhe ju në një vend. Jeta e stanit është e vështirë, — tha ai.

Vajza heshti duke vështuar fashat e bardha të fenerëve që ndriçonin rrugën, pastaj tha:

— Nuk i mbushet mendja babait. E ka lidhur shpirtin me dhentë. Me to linda dhe me to

do të vdes, thotë. Më thotë mua sa herë kthehem nga shkolla: «E ç'mundohesh, moj Rita, në të ftohtë e shi; ku do ta gjejmë ne tokën në majë të malit? Ajo shkolla jote është për fushën.» «Do të mësojmë të punojmë edhe tokën», i them. «Ku do ta hapim tokën?» Unë hesht. Ai diçka kupton dhe thotë përsëri: «E di unë ku të rreh mendja ty, po sa të jetë gjallë Pilo Koçua nuk do të bëhet ajo punë.»

— Mos udhëto vetëm natën, — i tha shoferi.

— Rrallë më ndodh, — tha Rita. — Kur s'ka makinë.

Rruga vazhdonte në të përpjetën me kthesa. Shoferi ia kishte ngulur sytë asfaltit të lagur. Vajza që quhej Rita u kthye nga unë dhe më pa drejt e në sy. Në dritën e zbehtë të llambës dallova fytyrën e saj ovale, flokët gështenjë dredha-dredha, sytë e kaltër, të butë dhe dy buzë të plota e të kërcyera.

— Edhe ju në minierë punoni? — pyeti ajo.

— Jo, jo, — thashë shpejt, — banoj në S., jo larg minierës.

— Telin e njihni?

I thashë se ishte hera e parë që hipja në makinën e tij dhe bëra çudi që prej kaq vitesh që banoja në S. të mos e kisha njohur.

— Rita, mbështille mbesën mos ftohet, — foli Teli.

Ajo hoqi shallin e leshtë nga qafa dhe mbështolli kryet e mbesës. Si heshtëm pak, Rita më pyeti përsëri:

— E bëni shpesh këtë rrugë?

— Kur jam me shërbim, — i thashë.

— Unë zbres tri herë në javë. Çudi si nuk ju kam njohur. Ngrita supet dhe pata dëshirë të thosha edhe unë ato fjalë. Ajo më vështronte shpesh me sytë e kaltër që qeshnin. M'u duk shu-

më i çiltër ai vështrim. Dhe nisëm të zgjatnim bisedat.

— Ju banoni në stane?

— Po, jam bijë çobani. Prindërit e mi më kanë mësuar të rrit dhen e qengja.

— Dhe tani dëshiron të bëhesh bujkeshë.

Ajo qeshi me çiltërsi të çuditshme. Mbesa e Ritës u kthye nga unë dhe mbështeti fytyrën në xham.

— Xhaxhi, pse ka shumë drita atje? — pyeti duke bërë me gisht.

— Janë puse, — i thashë, — për të nxjerrë naftë. E ke mësuar në shkollë naftën?

Ajo ngriti supet e vogla. Rita mori kokën e mbesës dhe e mbështeti në gjoksin e vet.

— Është shumë kureshtare, — tha, — pyet për gjithçka që sheh.

Makina ecte në një shpat mali. Era dridhte xhamat e dritareve. Diku Teli i ra borisë fort. Rita vuri buzën në gaz dhe më tha:

— Teli nuk e harron atë natë dhe sa herë mbërrimë këtu i bie fort borisë... sepse kur më dalloj në mesin e rrugës i ra borisë një copë herë, por unë nuk lëviza... Edhe atëherë ishte dimër si tani. Udhëtoja për në stan. Binte një shi i hollë me llohe. Në fillim prita makinë, por, kur ra muzgu, ika. Nata më zuri në udhë. Më kishin ngrirë këmbët dhe duart. Ecja shumë ngadalë. Diku u mbështeta në gurë buzë rrugës dhe prita. Era e ftohtë që vinte nga gryka e lumit më merrte mendtë. Ashtu më gjeti Teli. Dritat e fenerëve të makinës më vranë sytë. Doja të lëvizja, t'i flisja, por ai ndali dhe më erdhi pranë. Pastaj më mori në makinë dhe më uli pranë motorit. Aty u ngroha ca. Teli ngau makinën shpejt. Në fillim u habita që ai nuk e ndali te shtegu për në stan. Lëkundesha në kllapi nga lodhja. Teli ndali makinën në minierë. Aty më çoi

në një dhomë me sobë dhe u ngroha mirë. Vonë erdhi një shoqe e minierës, e cila më solli ndërresa të lara. Atë natë fjetëm të dyja. Të nesërmen në mëngjes Teli më çoi në stanet. U gëzua shumë babai dhe nuk dinte se si ta falënderonte Telin. Dhe prej asaj dite nuk e heq nga goja...

Në dritat e makinës dukej cipa e hollë e dëborës së shtruar në asfalt. Gjithandej errësirë. Dëgjoheshin uturima e motorit dhe rrëshqitja e rrotave në asfaltin e lagur. Rita mendohej. Përse mendohej ajo? E mbesa dremiste në gjoksin e saj. Një minator në krah ktheu kokën dhe i buzëqeshi Ritës. Edhe ai njihej me të? Ndoshta ai, Teli, do t'i kishte njohur. Era dridhte xhamat e dritareve. Autobusi ngjitej përherë. Zgjata kokën në xham e pashë që bora kishte pushuar.

Do të udhëtonim edhe për pak kohë nëpër këtë mal, derisa të zbrisnim drejt qytezës sime. Po Rita ku do të zbriste? Në këtë erë të ftohtë, mes natës së errët, trembej edhe egërsira. Ku do të qe shtegu që të çonte te stanet? Duke u munduar ta shquaja në faqen e malit, m'u kujtuan shtëpia, dhoma ime e ngrohtë, kujdesi i nënës dhe pyetjet e saj të pareshtura për shëndetin tim. Kur u nisa nga qyteza atë mëngjes, ajo më porositi kaq e kaq herë të mbështillesha mirë, të mos qëndroja gjatë në erë... Po nëna e Ritës ç'mendonte tani për të bijën? Ndoshta kishte dalë tej stanit me qenin e kopesë dhe po e priste. Dhe në të priturën e saj të gjatë e të akullt pyeste veten se me kë udhëtonte e bija atë natë. Ndoshta unë, udhëtari i panjohur, dilja në përfytyrimin e saj si një shok i Ritës së mirë. Dhe asnjë brengë nuk e brente. Sepse Rita e saj ishte rritur në stane, me një pastërti në shpirt si vetë ajri që thithte. Rita e saj nuk e njihte frikën, sepse asnjëri nuk i ki-

shte folur për të e asgjekundi nuk e kishte parë mes çobanëve. Zenira e saj ishte e pastër si buronja që del nga shkëmbi, e pushtuar nga një masë e madhe dashurie; dashuri për njerëzit, dashuri për qengjat, dashuri për ujin e bardhë, për lisat e bukur dhe malet me borë. Dhe ajo kishte ndeshur gjithnjë njerëz që ia kuptonin pastërtinë e shpirtit.

Shiritat gjatoshë të fenerëve ranë mbi një shkëmb të madh buzë rrugës. Teli ndali makinën dhe eci praptas. Shkëmbi kishte zënë një pjesë të rrugës. Kur kaluam, Rita tha:

— Ka pushuar bora?

— Po.

Teli po ngiste makinën ngadalë. Era mbeti pas qafës së malit. Rruga vinte e drejtë.

— Këtu do të zbres, — tha Rita.

— Është larg stani? — e pyeta unë.

— Nja tridhjetë minuta. Sonte kam edhe mbesën.

— Nuk ke frikë? — thashë unë më në fund.

Ajo ktheu kokën menjëherë nga unë dhe më pa drejt në sy.

— Frikë, e nga kush? Nga egërsirat më mbron Baluku im. Ti nuk e njeh Balukun... ai shqeu dy ujçer dimrin e kaluar. Tani po më pret atje, — tha ajo dhe bëri me dorë.

U mundova të përfytyroja qenin trupmadh.

— Kur të ndalë autobusi, ai do të lehë tri herë, — tha Rita.

— Përse e quani Baluku?

— Ka ca qime të gjata e ato të qafës i bien mbi ballë.

Heshtëm pak duke parë udhën e ndriçuar nga dritat. Makina po ecte ngadalë dhe unë prisja si me shqetësim çastin kur do të ndalte. Rita foli përsëri.

— Gjithmonë ktheheni vonë?

— Jo, vetëm sot u vonova.

Pashë sytë e saj të kaltër që ndritnin.

— Ndërsa unë kthehem vonë. Nuk dua të humbas asnjë orë mësimi.

Autobusi ndali diku rrëzë malit. Mbajta vesh. Dëgjohej gurgullima e përrrenjve që zbrisnin nga lartësitë. Era vazhdonte të ulërinte mbi xhama. Rita hapi derën, me mbesën për dore. Atëherë lehu tri herë Baluku.

— Natën e mirë dhe udhë të mbarë, — thirri ajo duke tundur dorën në ajër.

— Bëji të fala xha Pilos, — i tha Teli. Ajo tundi kokën që mbrapa xhamave. Autobusi që ndalur me ballë nga shtegu dhe dritat zbardhin një copë udhë. Për të fundit herë pashë siluetën e Ritës me mbesën për dore, qenin që u doli përpara duke kërcyer dhe udhën e shtegut që ngjitej përpjetë. Mbështeta kokën në xham dhe pashë larg; retë ishin çarë dhe në qiell ndritën yjet.

Rruga vazhdoi në heshtje. Secili bluante mendimet e veta. Diku Teli theu heshtjen dhe tha së vajzë më trime nuk kishte parë. Kurse unë mendoja se, po të mos që ai atë natë, ajo vajzë ndoshta do ta kishte bërë në këmbë për një orë e gjysmë rrugën që përshkuam. Dhe Rita e bënte këtë rrugë për të shkuar në shkollën bujqësore të mbrëmjes.

Në luginë u shfaqën dritat e qytezës sime. Pas pak zbrita në hyrje të qytezës. Në kodrat përçark shquheshin zbehtë blanat e dëborës së rënë atë ditë. Era që sillte deti nga lugina e lumit të cingëriste trupin. Hyra në dhomën time të ngrohtë, por nuk më flihej. Çobania e bukur nuk më shqitej nga mendja. Ku do të ishte ajo atë çast? Ndoshta ecte ende drejt stanit. Edhe

mund të kishte mbërritur e lexonte, se të nesërmen do të kujdesej për qengjat.

Që atëherë ka kaluar kohë. Tani Rita do të jetë brigadiere. Kishte shumë dëshirë, me siguri do të jetë bërë një bujkeshë e mirë. Dhe bujkeshën e mirë shoqet e zgjedhin në krye. Në qoftë ashtu, kur të lexojë këto radhë, sytë e kaltër do t'i rrudhen paksa, se do të gjejë aty historinë e saj. E ndoshta do të gëzohet.

Në të kthyer të vitit

Në mesditë qielli u vrenjt, drita në tokë u zbeh dhe pas pak mbi katramatin e barakës trokiti shiu i parë. Nga dritarja ai shihte vetëm pjesën lindore të vendburimit. Poshtë, nën këmbët e kodrës, oshëtinte lumi i turbulluar nga shirat e dhjetorit. Matanë lumit niste malësia e krahnës e tej, në një luginë të saj, shquheshin shtëpitë e bardha të një fshati me rrënojat e një kalaje të vjetër. Ai hapi njërin kanat të dritares dhe mblodhi perden. Trokitja e shiut në tokën e lagur hyri në dhomë si ritmi i një daulleje. Gjoksi iu freskua nga era e lagësht që sillte lugina.

Ndenji një copë herë duke parë horizontet e mbyllura me retë e përhimë që ngjiteshin për të zënë një copë vend në qiell.

Mbylli dritaren me përtesë, qëndroi përpara tryezës dhe ngriti telegramin. Për të dhjetën herë shkau vështrimin mbi ato fjalë: «Më prit për festë me fëmijët. Vera.» Si kështu? Para dy ditësh ai i kishte nisur gruas telegram: «Mos më prisni për festë. Jam me shërbim.» Dhe ja, ajo tani e njoftonte se do të vinte në vendburim bashkë me fëmijët. Përse ngulte këmbë e shoqja? S'mund ta kalonte një herë mbrëmjen e Vitit të Ri pa të shoqin? Ata gjithmonë e kishin kaluar bashkë, që kur u martuan e deri atë vit, kur kishin tre fëmijë të bukur e të shëndetshëm. Për ta thyer pak, Vera kishte propozuar që një vit ta festonin në shtëpinë e tyre dhe një vit te prindërit e saj. Dhe ashtu kishin bërë. E për çdo festë, sa herë ngrinte gotën, Izetit i kujtohej se në vendburim gjendej një inxhinier shërbimi. Atë vit i ra radha atij.

Kur e thirri shefi i zonës në zyrë dhe i tha se do të qëndronte në vendburim për festë, ai nuk shfaqti as ngurrimin më të vogël. Mori detyrën, shkoi në postë dhe njoftoi gruan. Pas kësaj bleu diçka për darkën, hyri në dhomë, pa drutë në stufë dhe kohën tjetër e kaloi në sonda.

Ai e la telegramin, i hodhi një sy rrëmbimthi dhomës së çrregullt e dy shtretërve të mbuluar me batanije dhe hapi garderobën. Brenda ishin dy shishe konjak, një me verë dhe gjysmë litër raki rrushi. I nxori dhe i la mbi tryezë; aty ishin edhe disa vezë të ziera, pak feta djathi, sallam dhe një bukë. Qëndroi në këmbë, pa ditur ç'të bënte. Dhoma iu duk e ftohtë. Ndezi stufën. Nën tavan nisi të lodronte një perde e hollë tymi. Hapi dritaren dhe pa shiun jashtë. Mjegulla po zbriste në luginë. Iu kujtua autobusi i linjës,

me të cilin do të vinte e shoqja me tre fëmijët. Ai tani do të qe duke gulçuar mes rrebeshit të shiut dhe ndoshta, gruaja nga xhami po u tregon-te fëmijëve lumin, kodrat përçark e shiun që binte e binte sikur donte t'i përmbyste, e ajo u thoshte fëmijëve të mos trembeshin nga rrëketë e shiut, sepse ato rrëshqitnin poshtë, drejt lumit, ndërsa autobusi ngjitej përherë lart. Ai pa orën dhe fërkoj sytë. Ndoshta në atë çast autobusi kishte mbërritur në qendrën e lokalitetit. Prej andej e deri në vendburim duhej edhe një orë e tridhjetë minuta. Sikur të mos qenë kumbimi i lumit dhe ritmika e shiut, ai kënd i botës do të kishte një heshtje vrasëse, një heshtje që do t'i cingëriste nervat, një qetësi që do t'i prishte qetësinë. Ndjeu lagështirën t'i përshkonte trupin. Mbylli dritaren dhe ngriti receptorin. Qendra e lokalitetit i tha se autobusi i linjës nuk kishte mbërritur ende. Uli dorën me përtesë dhe ra në shtrat. Dëgjohej bubullima e flakës në stufë dhe trokëllitja e shiut në katramat. Pastaj sytë iu mjegulluan vetiu dhe qepallat ndien një peshë lodhjeje. E kapi gjumi.

Kur u përmend, ndjeu të ftohtë. Zjarri në stufë kishte rënë. Nga xhami i dritares pa retë e dendura dhe pluhurin e përhimë të muzgut që shkundej prej tyre. Ai ndezi llambën elektrike dhe futi dru në stufë. Në korridor u dëgjuan hapa të nxituar. Ai rendi dhe e hapi pa trokitur njeri. Pa një punëtor të lagur që gulçonte.

— Ç'ka ndodhur, Fatmir?

— Më dërgoi kryesondisti, inxhinier. Pusi S 4 ka humbje argjile. Ka rënë presioni. Si të ve-projmë?

— Erdha, — tha ai dhe hyri në dhomë. Veshi çizmet, pellushin, hodhi mushamanë dhe vra-poi nëpër shi. Fatmiri e ndoqi pas. Diku inxhi-

nieri ndali dhe u kthye nga ai. Pa flokët e lagur të punëtorit që lëpiheshin mbi ballë.

— Ku e ke kapuçin?

— E lashë në sondë, inxhinier.

— Gabim ke bërë. Shiu është i dendur, të hyn në palcë.

Ata vrapuan përsëri. Në bërrylin e rrugës u dukën sondat. Në kulla vareshin gjerdanët e llambave që jepnin reflekse mbi hekurat e lagur. Pas shpinës dëgjonte dihatjet e Fatmirit. Diku ai rrëshqiti dhe mezi mbajti ekuilibrin. Trupi i qe ndezur flakë e mbi ballë i dolën bulëza djerse.

Kulla e S 4-ës ngrihej buzë lumit. Drita binte mbi ujërat e turbullta që vraponin teposhtë, drejt errësirës. Atij i ngjau se lumi kishte ndalur dhe aty pranë qe formuar një liqen me sipërfaqe vezulluese. Inxhinier Izeti e ndali vrapin mbi bazamentin e kullës, shkëmbeu vështrimin me Asimin, kryesondistin dhe pa manometrin. Presioni i argjilës kishte rënë shumë.

— Të rritim viskozitetin, — thirri dhe zbriti me të shpejtë shkallët. Qëndroi mbi piastrat që formonin rrugicën buzë kanalit metalik ku rridhte argjila. Niveli i argjilës kishte rënë në shtratin e kanalit. Ai urdhëroi të zbrazeshin thasët me byk orizi. U tha edhe të ndalnin motorët e ndezur. U zbrazën thasët e parë. Argjila në kanal uli shpejtësinë e rrjedhjes.

— Më shpejt, më shpejt! — thirri.

Punëtorët vazhdonin të zbraznin thasët. Ai ia nguli vështrimin kanalit dhe mati me sy viskozitetin. «Fillimi ka rëndësi, — mendoi, — po të ndalet humbja, do të thotë se ka filluar mbushja e vakuumit.» I erdhën ndër mend pasojat që mund të shkaktonte avaria po të mos ndalej. Në rastin më të mirë mund të pëlciste fontana. Atëherë do të humbiste një sasi e madhe nafte. Dhe sigurimi më i mirë do të ishte mbushja e

vakuumit. Llogariti me mend se sa mund të zgjas-
te ky proces. Rrjedha e argjilës e uli shpejtësi-
në. Fatmiri dhe një punëtor po e shtynin atë
me lopatë pranë vaskës. Inxhinier Izeti ngjiti
shkallët dhe pa manometrin.

— Po ngrihet, — i foli Asimi pranë veshit. Ai
iu përgjigj me sy fjalëve të tij. U mbështet në
mbajtëset anësore të kanalit. Shiu që binte e
vështirësonte punën. Mandej kanali ishte zbulu-
ar dhe kjo pengonte trashjen e argjilës. Pa orën.
Ndoshta tani gruaja me fëmijët do të kishin
mbërritur dhe prisnin atë. Përfytyroi dhomën
e tij, afshin e nxehtë të stufës, tryezën e ngar-
kuar dhe fëmijët përçark. E shoqja vinte rrotull
për të plotësuar diçka që mund të mungonte...
Pa natën e shiun që binte mbi vendburim. Fy-
tyra i ftoh dhe sytë iu mbyllën vetiu. Zhur-
ma e motorëve mbyste trokitjen e shiut. Por ai
mundi t'i veçonte këto dy zhurma. Shiu trokë-
llinte i largët, me një ritmikë ëndrrimtare, për-
kundëse dhe atij i ngjau se sillte zëra të njohur,
të ngrohtë, nga dhoma e tij:

*«Mama, babi po vonohet», — thoshte Gimi.
E shoqja përgatiste darkën. Ndoshta edhe
ajo këtë mendonte.*

«Mami, ta hap radion?» — pyeste Entela.

«Hape, xhan».

*Në tryezë ishin ulla të ullinjta e frutat që i kish-
te sjellë e shoqja nga shtëpia. Ajo po i thë-
rriste Entelës, për ta ndihmuar. Entela ta-
ni mund ta ndihmonte mamanë, ishte në
klasë të katërt.*

*Andi i vogël po dremiste në shtrat. Mbi
gjoks i kishte rënë një libër me figura
kafshësh. Ngrohtësia e dhomës ia kishte
rënduar qepallat. Herën e fundit e shoq-
ja i kishte thënë se Andi kishte nisur të*

ecte. Kur të shkonte ai, do ta priste babin në këmbë.

Entela ngrihej dhe dëgjonte zhurmën e shiut. Jashtë nuk shqoi asgjë veç perdes së shiut.

«Sa shumë po bie», — thoshte ajo.

«Po babi do të laget?» — pyeste Gimi.

«Mos rrini në dritare, se hyn era nga të çarat, — u thoshte Vera. — Afrohuni te stufa! Tani vjen edhe babi.»

— Ej, inxhinier, presioni po ngrihet.

Ai tundi kokën pa e pasur mendjen dhe tha «mirë». U kthye dhe pa kush foli. Njohu Asimin me mjekrën e zbardhur të parruar prej disa ditësh.

— E vumë në vijë më duket.

— Ëhë, — tha dhe tundi kokën. Vazhdonte të shihte rrjedhën e argjilës, që shkonte me vesh-tirësi në kanal in metalik.

— Një punëtor tha se ju kanë ardhur fëmijët dhe gruaja.

— Po, — tha ai.

— Mund të ikni, inxhinier.

— Jo, jo, në asnjë mënyrë.

— Ndoshta rreziku u hodh.

— Hë, ndoshta. E shikon se edhe ti nuk ma thua me bindje?

Kryesondisti pati dëshirë ta përçafonte. Me fjalë si këto ai u kishte hyrë në zemër të gjithëve.

— Do të marr bishtakun, — tha dhe ngjiti shkallët e bazamentit.

Ai u mat t'i thoshte të mos bënte asnjë lëvizje të kolonës, se mund të rrezikonin përsëri. Asimi që ngjitur në bazament dhe ai mendoj të shkonte edhe vetë. Aty u mpi. Kishte mbi dy

orë që ndiqte i ngurosur rrjedhën e argjilës. Lëvizi me ngadalë këmbët mbi piastra. Fatmíri dhe një punëtor tjetër vazhdonin të derdhnin bykun. Argjila mbi piastra shkëlqente dhe ai mbahej të mos rrëshqiste. Shiu binte me zhurmë mbi llamarinat që mbulonin motorët. Dhe sa do të zgjaste kjo? U ngjit në bazament dhe i tha Asimit ta fiksonte kolonën në një pozicion, derisa të normalizohej presioni. Eci buzë kanalit. Argjila gati s'po derdhej. Ndali pranë dy punëtorëve që derdhnin bykun me kujdes. Sa shumë po mendonte atë mbrëmje. Mos qe lodhur së tepërmi? Ankthi që e kishte pushtuar nga fillimi nuk po e lëshonte. Ç'të ishte? Mos frika e pasigurisë për fontanën? I qetësuar tha me vete se ky ankth nuk ishte frikë e pasiguri, por përgjegjësia e thellë që ndiente në atë vend.

Kalonte koha dhe zhurmat bëheshin më të kumbueshme në natën e thellë. Llambat varur vertikalisht formonin përçark një rreth drite me rreze deri në ujërat e turbullta të lumit, i cili shkiste me shpejtësi mes natës së errët, duke rrëmbyer ç'të mundte. Përtej lumit nata e zezë mbulonte gjithçka. Izeti përfytyroi pyllin e zhveshur atje tej dhe pas tij vendin historik ku qe mbledhur çeta e krahinës. Në ditët e ngrohta të verës ai gjente kohë të lirë, kalonte në va dhe ulej pranë lapidarit. Afër tij rridhte uji i një kroi që zbriste nga mali. Ai dëgjonte këngën e zogjve dhe gurgullimën e kroit. Ndoshta në pushim këto kishin dëgjuar edhe pjesëtarët e asaj çete të posaformuar. Diku do të qe ulur edhe i ati, që tani nuk ishte më. Vite më parë, kur Izeti ishte me pushimet e shkollës, ata vinin të dy bashkë. I ati pinte nga uji i kroit dhe pastaj rrinte e mbante vesh. I ngjante se dëgjonte zërin e komandantit kur bëri betimin. Kështu i thoshte Izetit. Ja... Ai mbante vesh dhe përsëriste zë-

rin... Pastaj shtrihej mbi bar e mendohej. Zogjtë i trazonin mendimet me cicërimën e tyre, kurse puhiza e pyllit i përkundte thinjat. Ngriheshin kur dielli varej nga deti e i hipnin një makine deri në qytetin e tyre bregdetar... Izeti ndjeu mall për vendlindjen. Kishte më se tre muaj që nuk kishte ndier erërat e tij të ngrohura. Përshëndetjet e të njohurve dhe valët shku mbëbardha që rrahin bregun me rërë. Aty kaloi fëmijërinë, rininë, derisa erdhën vitet e shkollës. Në një sezon të pushimeve, buzë detit që njohur me Verën.

Po tani që ai s'po vente, ç'mendonte ajo vallë? Ç'do t'i thoshte kur të shkonte në dhomë? Ajo do t'ia kuptonte në sy lodhjen. Gjithmonë e kishte kuptuar. Dhe njeriu është i lumtur kur ia kupton një shok brengën apo gëzimin. Dhe ke dëshirë të flasësh apo të tregosh për atë që të bren apo të gëzon, derisa ai shok i mirë të marrë pjesë me ty. Atëherë e ke më të lehtë edhe ti.

Inxhinier Izeti ndjeu të dridhura. Mushamaja i qe bërë akull nga shiu i ftohtë. Lëvizi mbi pista dhe iu afrua dy punëtorëve që zbraznin bykun.

— Edhe sa thasë keni? — pyeti Fatmirin. Ai ngriti supet.

— A mjafton të derdhim edhe për një orë?

— Mundet, — foli punëtori tjetër.

— Mirë, — tha ai dhe shkoi te pompat. Atje zhurma ishte shurdhuese. E pyeti pompistin për pompën rezervë. Ai i tha, se ishte në gatishmëri të plotë.

— Mirë, — tha përsëri dhe ngjiti shkallët me vërtik për të ngrohur gjymtyrët. Në bazament Asimi seç i tha. Ai pyeti me zë. Zhurma e motorëve nuk e linte të dëgjonte. Afroi veshin pranë buzëve të kryesondistit.

— Nuk po ngrihet më, — thirri Asimi duke i treguar manometrin.

Ai e vështroi në sy. Ç'do të thoshte kjo? Puna deri atëherë kishte shkuar në rregull. Shihte fushën e bardhë të manometrit dhe shigjetën që dridhej në të. «Nuk bëhet në masë qarkullimi», mendoi dhe zbriti shkallët. Rendi te pompisti dhe i bëri shenjë të ndizte pompën rezervë. Derrisa ai e ndezi, qëndroi aty në këmbë. «Lava është shumë e trashë dhe pompa nuk e shtyn sa duhet», tha me vete. Shkoi buzë kanalit dhe u mbështet në mbajtëset. Dy punëtorët vunë re shqetësimin e tij dhe nuk thanë asgjë. Nuk e kuptoi sa qëndroi ashtu. E përmendi një vërshëllimë e fortë.

Ngriti kokën dhe në krye të shkallëve pa kryesondistin. Ai tundi dorën në ajër dhe i tha «në rregull». Mori frymë thellë. Në heshtjen e gjatë ai kishte sjellë përsëri ndër mend ç'mund të kishte ndodhur në fontanë. Përse e mendonte atë shpesh atë? Kur e mendon fatkeqësinë, ajo merr përmasa të mëdha. Pa nga dy punëtorët që vazhdonin të derdhnin bykun. U afrua dhe pati dëshirë t'u thoshte dy fjalë. Mandej ndjeu një mall të papërshekruar për ata të dy, për Asimin, për motoristin, për gjithë brigadën. Kishte vite që punonte me ta. Bashkë kishin bredhur shumë vendburime dhe i kishin dhënë atdheut naftë. Dhe gëzimi që kishin ndier ata, ishte i përbashkët, siç kishte qenë edhe munda. Punëtorët nuk ia ndanin sytë inxhinierit. Dhe patjetër thoshin me vete që ky inxhinier Izeti nuk dallon nga punëtorët, ai jeton me ta, ha në një tryezë, pushon në një dhomë dhe vishet me peliçe e çizme si një punëtor argjile.

Herë-herë ai ngrinte kokën e pyeste Asimin. Kryesondisti tundte dorën në ajër: «në rregull». Atëherë ai shihte natën për tej kufijve të dri-

tës. Përfytyroi barakat e punëtorëve. Në një nga ato baraka e shoqja me fëmijët festonin Vitin e Ri. I trokitnin në vesh pyetjet e fëmijëve:

«Mama, babi nuk po vjen.»

«Do të vijë, xhan.»

«Po festa po mbaron. Ja, gota e babit mbeti pa pirë.»

«Do të vijë e do të ngrejë një shëndet për ne.»

«Do të pimë për babin tonë, që nuk trembet nga shiu e nata», thoshte Entela.

«Ti, Entela, mos e pi të gjithë gotën, se do ta tokim me babin.»

Andi i vogël ngre kokën nga shtrati dhe shikon në dhomë.

«Eli babi?»

«Tani vjen. Po ti fli që të rritesh.»

«Ka flikë babi?»

«Babi është i madh.»

«I madh», — thotë Andi dhe mbyll përsëri sytë. Në tryezë nuk ngrihet asnjë gotë. Gjithkush mendon e dëgjon trokëllimën e shiut nëpër natë. Spikerja e Radio-Tiranës uron për vitin që porsa hyri.

Ai lëvizi në kreun e kanalit për të ngrohur pak gjymtyrët. Të ftohtët kishte nisur ta mpinte. Vuri re se punëtorët që zbraznin bykun e vështruan gjatë. Ktheu kokën dhe e tundi ngadalë. Edhe punëtorët tundën kokën «mos ki merak» dhe buzëqeshën. Asimi i tregoi me gisht shigjetën e manometrit. Presioni që normalizuar. Ai mbeti në këmbë, duke mos ia shqitur vështrimin. Një valë e ngrohtë ia përshkoi trupin, një forcë dukej sikur po e ngrinte peshë; ngriti dorën dhe e përplasi fort në pëllëmbën e krye-

sondistit. Kur u shkëputën, ngjiti me të shpejtë shkallët dhe u tha dy punëtorëve të ndalonin zbrazen e bykut. Vakuumi qe mbushur. Argjila nisi të dilte. I thirri pompistit të fikte pompën rezervë dhe zbriti të lahej. Kur mbaroi, thirri Asimin, i la porosi e pastaj mori rrugën për në barakë. Shiu binte e binte me rrëke. Zhurma e fortë e motorëve po zbehej. Ai kaloi kthesën dhe ajo u fik në veshët e tij. Atëherë e ndjeu më tepër lodhjen. Ngriti sytë nga udha dhe dallooi dritat e ndezura të barakës së vet.

Kishin nisur të shkëmbeheshin minutat e një viti të ri. Ai mendoi diçka për punëtorët e pusit S 4 që kishin mbetur në sondë. Nëpër peletinën e errët të natës me shi luhateshin llambat elektrike. Sy të tjerë rrinin zgjuar atë mbrëmje e ndoshta ecnin si ai, nëpër udhën me baltë, pas detyrës e për në detyrë.

MALLI PËR KËNGË

Vajza e bariut

Ishin ditët e fundit të majit. Qielli herë kal-tërohej, herë mbushej me re të bardha që vozitnin drejt jugut. Dielli po ulej për t'u fshehur mbrapa malit, atje ku Mit Vetullziu e dinte se gjendej deti. Ai u ngrit mbi samarin e mushkës e vështroi pas. Stani vargohej në të përpjetë.

Bariu solli ndër mend rrugën që kishte bërë atë ditë. Kishin kaluar dy bregore të buta, një lumë me shtrat të gjerë, një fushë ku kuaknin bretkosat, të trembura nga tingujt e këmborëve dhe tani ranë në këtë mal që s'po i gjendej fundi. Në të përpjetë stanin e kishte shoqëruar py-

lli me drurë të dendur; kur humbiste ai, sikur të kishin mbirë nga dheu, dukeshin shkëmbinjtë e bardhë që mend plasaritëshin nga vapa.

Stani shëtites kishte tri ditë që ishte nisur maleve për verim. Mit Vetullziu, i zoti i stanit, printe kaluar në mushkë. Kafsha shkelte me siguri në udhët e shkreta të malit, pas tundeshin këmborët e deshve që e prinin kopenë. Tingujt e këmborëve sajnin një melodi të ëmbël, që dukej sikur tretej në shkëmbinj.

Bariu ecte kaluar dhe me sy përfshinte gjithë hapësirën para tij. Kjo nuk ishte një ditë e zakonshme. E gërryente një shqetësim që e ndoqi gjatë gjithë udhëtimit.

Mit Vetullziu ishte bari që kur lindi. Ninanë ai pati këmborët dhe blegërimat e deleve. Por atë ditë nuk po e ndiente melodinë e rrallë të këmborëve me jehonën që përcjell pylli.

Ai udhëtonte duke e kthyer kokën shpesh. Mushka djersinte nën peshën e tij, sepse bariu ishte sa dy burra. Qëndronte ulur në njërin krah të samarit, në krahun tjetër kishte lidhur shtrojat e fjetjes. Sepse stanin e zinte nata kudo nën yjet e largëta, në fushë, në mal, në pyll, në lëndinë e mbi shkëmb.

Kaluan përsëri një pyll e dolën në disa lëndina të blerta në faqen e malit. Aty rritej tërfili i ëmbël për bagëtinë. Zhurma e karvanit trembi zogjtë e malit. Ata braktisën strehën, ku mendonin të kalonin natën, dhe fluturuan mbi kope duke përplasur krahët.

Mit Vetullziu mendoi të mos ndalej as në këto lëndina. Më tej do të gjente të reja, tani që edhe qafa e malit po shfaqej në një ngushticë drurësh. Vështroi edhe një herë pas. Dhentë e ndiqnin duke ngritur një pluhur të imët që kundërmonte qumësht e bajgë.

Për dhentë kujdesej Peçoja, që mbyllte kar-

vanin, hipur në mushkën me barut. E shoqja dhe Dilla ecnin në këmbë pas dy mushkave të ngarkuara dinga me plaçka të stanit.

Çobani përsëri solli ndër mend bisedën që pati bërë me komitin Malo Gjakmarri. Ndoshta ngaqë stani po kalonte nën strehën ku fshihej komiti me çetën e vet. E dinte se Malo Gjakmarri bëhej firar e pastaj të mbinte në mes të udhës, ku nuk e prisje. Vdekjen me sy kishin parë ata që ishin ndeshur me të. Por komiti nuk sulmonte këdo, ai sulmonte karvanët e turqve e hasmin e vendit, që shëtitnin me vdekjen në shpinë në ato vise gjysmë të egra.

Dikur edhe komiti kishte qenë një bari i mirë, që lozte e gëzohej luadheve me qengjat e vegjël, të cilët e kishin lëshin të butë si kaçurrelat e tij të bukura. Fëmijë, ai vraponte nëpër bar, këpuste lule për t'ia dhënë qengjit, por i çuditur shikonte se ai sa u merrte erë e nuk i përtypte. Kështu ai kuptoi se lulet s'duhej t'i këpuste, se mbushnin luadhin me erë të mirë. Pastaj Maloja shtrihej mbi bar me duar të hapura, si të pushtonte lulet, mbushte gjoksin me erën e tyre e qëndronte ashtu gjersa nga stani e thërritnin prindërit. Ai vraponte me duart ende të hapura, sikur të mbante gjithë lulet e lëndinës. Çobani e çobanka gëzoheshin për djalin, që e donte aq shumë tokën e tyre e lulet e saj.

Ende nuk ishte rritur mirë Malo Gjakmarri, kur mbeti jetim. Stanin e plaçkitën turqit. Ata i vranë prindërit, kurse atë e morën me vete. Më vonë, pas disa muajve, djali i vogël ra në dorë të ca barinjve që e rritën në stanin e tyre. Malo jetimi nuk qëndroi gjatë me barinjtë e mirë. I vlonte në gji hakmarrja e fshehur aty me vite.

Mit Vetullziu thoshte se ai ishte gjallë i ati e tërr nuk ia bënte syri. Kërkonte gjakun e prin-

dërve dhe hakmarrje për vendin e shkretuar nga të huajt. Një ditë hodhi pushkën në sup e doli komit malit. Gjeti atje dhe shokë të tjerë. Dalngadalë emri i tij u përhap në të gjithë krahinën. Turqit u munduan ta vinin në çark, por ishte e kotë. Ku dilte sot, s'dilte nesër. Asnjë nuk dinte ku gjendej në të vërtetë. Vidhej nga njëri mal në tjetrin, nga njëri pyll në tjetrin. Nuk ishte çudi të dilte edhe përpara stanit. Mit Vetullziu e besonte këtë më tepër se kushdo.

Ai po këndonte nën zë. Kur ishte i ri si Peçoja, e lëshonte zërin sa dridheshin edhe gjethet e pyllit. Këndonte edhe Peçoja. I biri i kishte ngjarë në këngë. Edhe Dilla. Ai kishte një vajzë të bukur si dielli, me një zë që linte pa mend këdo. Kushedi, mbase ajo kishte faj që komiti trokiti në portën e tyre. Ca thoshin se Dilla ishte e magjepsur, prandaj edhe dinte t'ua rrëmbente zemrën djemve (thoshin se magjirat i bënte me këngët e shumta që dinte). Ajo dilte në mbrëmje pranë një kroi a burimi e ia merrte këngës me një zë ëndërrues:

*Shkon bandilli anëso,
gërshetat qëndisuro,
mua më zuri në mëngë,
më hodhi në këngë*

Ajo këndonte dhe thurte gërshetat e flokëve të zinj. Sytë i kishte të kthjellët si burim mali, vetullat si harku i hënës, fytyrën të bardhë si bora e malit. Atë nuk ia pa kurrë dielli; kësulën me sërma ajo e hiqte vetëm mbrëmjeve me hënë e prandaj sytë e saj kishin dritën e kulluar të hënës.

Një ditë nëpër stane u hap fjala se Dillën e Mit Vetullziut e pa te burimi komiti Malo

Gjakmarri. Ai kishte kohë që rritej pyjeve, por përpara bukurisë së Dillës shtangu. Ishte mbështetur në degën e dëllinjës, kur Dilla lante fytyrën. Ajo ngriti kokën dhe e pa. Edhe komiti ishte i bukur, me trupin të drejtë si një degë lisi. Flokët i dredhonin gjer aty ku lidhet gjerdani i fishekëve. Pylli përcillte këngën e zogjve. Ata qëndruan një kohë të gjatë duke vështruar sytë e njëri-tjetrit. Komiti pa mjekrën e zezë në sytë e saj. Edhe ai kishte sy të bukur, të pastër, por të egër. Mjekra e dendur fshihte rininë e djaloshit. Ai e harroi etjen, ndërsa burimi gurgullonte duke shkarë ujin midis barit dhe thembrave të vajzës. Ajo u vodh e iku tuje duke u fshehur midis drurëve. Ai e ndoqi. E thau etja e zemrës djaloshare komitin, ndaj i ra pas. Vajza shkiste midis drurëve, ai e ndiqte. Pastaj ai u afrua, por ajo s'e pranoi. (Ishte e egër, tha më pas komiti, po si nuk e rrëmbeva në krahë atë zanë e ta merrja me vete.) I trullosur nga mahnitja, mbeti në vend. Atëherë vajza iku dhe si për inat ia mori këngës.

*Rri një ditë në burim,
vjen e më sheh një trim.
Unë e mjera thur gërshetë...*

Thonë se kur e dëgjoi komiti ra në tokë i zalisur. Ashtu e gjetën shokët kur e morën.

Kaluan ditë, por komiti nuk e harroi atë mbrëmje. Dhe një mëngjes la çetën në pyll e zbriti në stan. Mit Vetullziu e priti në portën e vathës. Malo Gjakmarri hyri brenda e u ul rëndë mbi postiqe, në mes të kasolles, mbështetur në strumbullarin e kulmit. Në krahun tjetër, përballë, u ul bariu. Komiti hodhi pas flokët e gjatë dhe ngadalë fërkoji me pëllëmbë mjekrën e pluhurosur. Bariu priti. Sytë e zinj, si

dy zgavra lisi, vështronin përdhe. Komiti kishte hije të rëndë, siç kishte të rëndë fjalën dhe plumbin. Bariu e dinte se ai kërkonte gjak hasmi. Kush ishte hasmi i tij, kishte mbi kokë një mal me borë. Mit Vetullziu nuk e vështronte në sy. Komiti fliste dhe shikonte xhamadanin e qëndisur të bariut. Një hall i madh e kishte zënë komitin, derisa la pyllin dhe i gjeti shtëpinë.

— Kërkoj Dillën për nuse, — tha ai më në fund.

Vetullat e dendura si streha e kasolles të bariut u kreshpëruan dhe u ulën mbi sy.

— Kam nder që më gjete shtëpinë, — foli bariu.

— Si shpërblim ke mbrojtjen time dhe të çetës, — tha komiti dhe i ndërroi supin tytës së shkurtër. Nën gunën e komitit, bariu vuri re gjerdanin me fishekë si një radhë dhëmbësh. Pastaj foli pa ngritur sytë.

— Besën për Dillën nuk ta jap dot.

Malo Gjakmarri nuk lëvizi asnjë fije floku. Vështronte xhamadanin e bariut dhe ngjyrat e harlisura në të.

— Përse nuk e jep?

— Nuk je i sërës sime. Ti je i fortë, ke çetë, ke nam. Por i harrove zakonet tona. Ku do ta futësh Dillën ti? Ajo nuk mësohet kurrë nën huqin tënd. Ajo e do bukurinë dhe trimërinë, por ty të mbeti bukuria maleve, o komit.

— Të dy na ngroh një diell dhe na tret një dhe, — foli komiti.

Mit Vetullziu nuk iu përgjigj. Nata po mbushte kasollet me pluhurin e saj.

Malo Gjakmarri një herë flet me fjalë, të dytën me plumb. Sot po e thyej, o bari i mirë.

— Humbe maleve dhe na harrove, o komit. Nuk e marr kurrë fjalën mbrapsht.

— Mblidh fiqirin, o bari, po flet keq.

Të dy ishin ngritur në këmbë. Komiti priti të thoshte bariu një fjalë. Bariu priti të largohej komiti. Malo Gjakmarri iku i përhumbur në egërsinë e vet...

Këto mendonte Mit Vetullziu hipur në mushkë. Stani po kalonte qafën e malit. Poshtë shtrihet lugina me dy male rrethuar. Pas qafës hyjnë në pyll. Freskia e pyllit sikur ia largoi mendjen nga komiti. Tani po gjente një vend të mirë për të kaluar natën. Përtej pyllit, jo shumë larg, dalloi një kodrinë të bleruar, pak e ngritur mbi të tjerat.

U hodh nga mushka dhe eci në këmbë për t'u shpirë. Dhentë u mblodhën rreth mushkës së tij. Kodra ngrihej në një shpatull mali, e zhveshur krejt nga drurët. Ngjante si kopicë bari të korrur. Pylli shtrihet poshtë nga perëndimi. Në njërin krah buzët e kodrës humbisnin në shtratin e ngushtë të rrjedhës së përroit malor, në krahun tjetër shtrihet një lëndinë me bar. Në fund të lëndinës nisin shkëmbinjtë e bardhë, që ngjiteshin deri në majë të malit. Ata duke shinin si të ishin koka kafshësh të ndryshme, ca të stërgjatura, ca të shkurtra, ndërsa në faqet e tyre diku lëshohej dritë, diku ajo mekej, e gjithë ai masiv nuk të jepte gjë tjetër përveçse një dritëhije të çuditshme.

Stani u ngrit shpejt. U shkarkuan plaçkat, qentë zunë pritat me veshët ngritur. Peçoja zuri këmborët dhe solli barutin.

— Shko ndihmoju grave!

Djali u largua me hapa të mëdhenj. I ati krenohej me forcën e tij. Si nuk ishte kujtuar t'i blinte një pushkë? Pa të mashkulli është si pa sy.

Mit Vetullziu hodhi gunën mbi kondakun e

pushkës dhe u shtri me fytyrë nga qielli. Yjet ndritnin varur mbi stan dhe mbi natën përreth. Ai po dëgjonte zëra. Ishin zërat e grave.

Nata mbuloi gjithçka; dalngadalë po pushton-te edhe sytë e tij e aty po fikte edhe dritën e yjeve. Dëgjohej fëshfëritja e pyllit. Me sytë e mendjes ai brodhi pyllin. Tej pyllit vinin toka. Ai ëndërroi të kishte tokë. Ishte lodhur shumë nga kjo jetë endacake. Zërat me kohë s'po dëgjohehin. Diku gratë përgatitnin diçka për darkë. Ai s'donte asgjë. Ishte lodhur shumë e më tepër këtë lodhje ia rëndonin mendimet, që s'po i ndaheshin si era e malit. Ai kishte thënë një herë «jo» dhe s'do ta kthente më. Sikur qielli e toka të bëheshin një. Vatra e tij nuk ishte mësuar të turpërohej... Ai dëgjonte. Nata ka veshë, dita ka sy. Bulkthi prishi qetësinë e asaj nate. Pastaj me të u përzie një këngë. Ai dëgjonte shkoqur fjalët. Njohu edhe zërat. Ja, ky është zëri i tij. Këndonte Peçoja. Shkoi ndër mend dasmën e ardhme të të birit. Gratë duke hequr valle në oborr të stanit. Te lesa vjen nishani i nuses. Ai pret miqtë me radhë, të tërë me feste të rrumbullakët mbi ballë... Kënga këndohej me vaje, të thumbonte zemrën e të mbushte sytë. Djaloshi ligjëronte për jetën e shkurtër që e preu plumbi i hasmit. Kënga dëgjohej në heshtje. Kur mbaronte, të bëhej të merrje pushkën dhe të vrisje hasmin. Si e dridhte zërin ky Peçua! Ke parë si dridhet gjethja në mbrëmje nga era e malit? Ti vështron gjethen. Ja, kur lëviz petali i lules, thua se kjo është era, kur shikon si pëlçet gjethja, thua se kjo është pranvera. Dhe zërin e dëgjon e të duket se ke pranë luftërat, të vdekurit, dashuritë. Ai është aq i bukur, sa është pylli këtu poshtë, sa është qielli me yje atje lart. Era ta lëngëzon syrin, po pse, zëri jo? Mit Vetull-

ziut i njomeshin sytë sa herë merrte këtë këngë. Ai mbante vesh e thithte me etje fjalët:

*O vëlla, të thërret motra,
presin krushqit te porta.*

«Mirë, moj Dillë, mirë.» Ai kishte një vajzë të bukur si dielli. Sa mirë ia kthente këngës! Zëri i saj ishte behar. Thonë se njerëzit edhe pas zërit dashurohen. Zëri i ëmbël sjell ëndrrat.

*Blegërijnë dhentë në breg,
... thirri babës të m'i mbledhë*

e kthente Peçoja. Mit Vetullziu u harrua nga kjo dynja. Kënga po ia shpinte mendjen si era e malit. Ai donte të mos mendonte asgjë tjetër e të mos i hapte sytë. Të flinte e të harronte gjithçka. Veç këngës. Të dëgjonte Dillën. E bija u rrit me manushaqe në gji, me erën e saj, me druajtjen e saj. Manushaqja rritet rrëzë një ferre, duke shpërndarë aromë fshehur syrit të njeriut. Dilla dilte vetëm mbrëmjeve pranë një kaçube a një buronje e këndonte.

Ashtu shtrirë, siç ishte, po i rëndonin sytë. I trembur, i hapi e u përmend. Jo, s'duhej ta zinte gjumi se zihej si zogu në çark. Sa të mbërrinte në Mazrek. Atje ishin shokët, ishin stanet e tjera. Kur je me shokë, e ke më të lehtë. Mali i Mazrekut gjendej larg. Stanet e tjera ndoshta kishin mbërritur. Ai kishte meranë e tij atje. Kush kishte mera në Mazrek, ishte i fortë e i paprekshëm...

Vetëm karvanët e turqve plaçkitnin gjithçka që ndeshnin. Udhëtimet i bënin natën në heshtje. Plaçkitnin, vritnin dhe iknin. Çeta e komitit Malo Gjakmarri, ama, nuk binte në grackën e tyre. Mit Vetullziu nuk donte të nde-

shej me karvanët e turqve. Ai nuk do të udhë-
tonte natën. Do të priste të zbardhte mëngjesi.
Turqit i ruheshin dritës. Ditën të mbinte Ma-
lo Gjakmarri në udhë...

Atë mbrëmje e ndiente veten tepër të lo-
dhur. Gjumë s'i flihej e rrjedha e mendimeve i
sillte lloj-lloj kujtimesh nga vitet e shkuara. Se
njeriu, sa më pranë pleqërisë është, aq më larg
e kullot mendjen nga vitet e rinisë. Dhe liva-
dhet ku po i kulloste mendja s'kishin të mba-
ruar... Yjet digjeshin mbi kokë. Si nuk po bin-
te një pikë shi? Të ngrohte tokën, të lëngë-
zonte barin. Doli njëri para njerëzisë me një
mushkë dinga me flori. Me se është barabar kjo?
Me shiun e majit... Sa ndenji shtrirë? Nata ki-
shte vënë në gjumë çdo qenie të gjallë. Edhe py-
lli teposhtë nuk merrte frymë. Ndjeu se së
shpejti do të zbardhte mëngjesi. Po kalonte edhe
kjo natë. Një qen iu afrua dhe i mori erë. Pas-
taj ai iku tutje me nxitim. Mushkat përtype-
shin ngadalë. Dhentë dremitnin në bark e në
këmbë. Qeni erdhi përsëri dhe iku duke nuhatur
tokën.

«Bisha, era e bishës», tha me vete bariu.

«Tkauu», shpoi errësirën një krismë.

U ngrit ndenjuri. Qentë lehën fort. Ai shtrën-
goi pushkën e nuk ndjeu se vrau gishtërinjtë.
Kërkoi me dorë në errësirë thesin me barut, e
preku atë dhe priti. Në krah u gjend Peçoja.

— Luaj, — foli Mit Vetullziu pa shkëputur
sytë nga nata.

Peçoja vështronte përgjumshëm natën e mu-
gët.

— Ç'm'i ngre ashtu veshët?

— Çfarë do jetë? — pyeti Peçoja.

— Çfarëdo, djall me brirë qoftë... hasm është,
gjersa vjen me krismë.

Peçoja hapi thesin dhe mbushi fishekët.

Qentë vazhdonin të rendnin përreth. Dhentë buisnin të trembura.

— Dil, o çoban!..

Zëri erdhi nga shkëmbinjtë e thepisur. Shpoi stanin si shigjetë dhe humbi tutje në shpatin e malit përballë e u përcoll poshtë, për t'u mbytur në pyjet e dendura.

U dëgjua më pas një krismë kuturu. Në natën e zezë nuk shquhej asgjë. Zbehnin vetëm shkëmbinjtë. Prej andej erdhi e njëjta thirrje.

— Turq, — thirri bariu dhe u hodh për të zënë pritë. Prej aty s'kishte gjëmë ta shkulte. Kush afrohej, do të kalonte si në pëllëmbë. Peçoja afroi thesin me barut.

— Mbushi, — foli bariu duke vështruar shkëmbinjtë.

— Vetëm do të jetë?

— Hasmi nuk vjen kurrë vetëm, — u përgjigj Mit Vetullziu.

Tani ai po shquante diçka me sytë e mprehtë. Ishin çallma të bardha. Vetëtimthi solli ndër mend karvanët e turqve dhe batërditë e tyre që kishin marrë dhenë.

Bariu ndoqi lëvizjen e hijeve dhe qëlloi. Shkëmbinjtë u përgjigjën menjëherë. Plumbi nuk zuri në shenjë.

— O çoban, s'ke ku shkon. Ti dhe nata ke ni mbetur.

— Për mua po vjen mëngjesi. Ty nuk të gjen gjallë drita!

Matanë u dëgjua një e qeshur e fortë.

Mit Vetullziu mundohej ta vinte në shenjë. Turku hidhej shkëmb më shkëmb. Bariu dallonte vetëm hijen e tij. «Turk dhe djall», tha me vete. Çeta shtinte kuturu. E kërkonin të gjallë gjahun, por i gjallë nuk jepej bariu

Yjet po fikeshin një nga një. Po shquheshin qartë konturet përreth. Turqit shtinin, kërcenin

pas shkëmbinjve dhe afroheshin. Fishekët po rralloheshin. Peçoja i mbushte shpejt, por ai qëllonte dendur. Baruti po ulej në trastë më shpejt sesa duhej. Turqit bënin përpara. Disa herë ai dëgjoi atë të qeshur të hidhur.

E shoqja erdhi me Dillën. Ai mendoi t'i largonte, por në fytyrat e tyre dalloi shqetësimin për të. Bëri shenjë të nxitonin.

Pas pak fishekët në gunë u shtuan. Tani qëllonte më shpesh. Turqit kapën buzën e lëndinës, qëndruan mbi shkëmbinjte e fundit dhe atij iu duk se po loznin me plumbat e tij. Në lëndinë do ta kishin më të vështirë të përparonin dhe ai, i ngazëllyer, humbi në të shtëna të pandërprera. U përmend vetëm kur thirri Peçoja:
— Mbaroi baruti.

Mit Vetullziu ktheu i lodhur kokën e rënduar. Qafa i ishte mpirë. Mbi gunë kishte mbetur vetëm një fishek. Rrezet e diellit, fshehur diku prapa malit, po largonin ngadalë mugëtirën në qiell. Ai dalloi qartë në ballë një turk. Çallma i fryhej sa herë hidhej përpara. Pushka mbante fishekun e fundit. Diçka po i digjej brenda bariut, që e ndezi të tërin. Ku ta nxirrte atë zjarr? Si ta shfrynte? Turku ishte afruar shumë, edhe një kërcim e doli mbi shkëmbin aty pranë. Bariut iu lodh syri; turku bënte dredha. Maja e thepit shkoi pranë gjoksit, kaloi qafën dhe ndali sa një të marrur frymë në ballin e turkut.

U dëgjua një e shtënë dhe trupi i turkut fluturoi nga shkëmbi. Krisma trembi zogjtë e fundit që fluturuan mbi lëndinë, duke përplasur krahët në ditën që po lindte.

Turku dergjej mbi lëndinë.

Mit Vetullziu po bënte çudi. Ai s'kishte arritur të shtinte. Fisheku i fundit flinte në folenë e pushkës. Por s'paqi kohë të mendohej gjatë. Kris-

mat e tjera pasuan njëra-tjetrën. Ato vinin nga pylli.

Bariu njohu krismën e Malo Gjakmarrit. Njohu edhe atë nga flokët e zinj. Turqit këputeshin si degë të thata. Krismat zgjatën një copë herë. Bariu zbrazi fishekun e fundit dhe u turr poshtë me jatagan në dorë, atje ku po luftonte çeta e komitit.

Turqit u zbrapsën më në fund. Ç'mbetën gjallë, ikën me të vdekurit ngarkuar.

Në lëndina ai kishte mbetur me çetën e Mala Gjakmarrit. Në fytyrën e komitit u ndezën rrezet e kuqe të diellit fshehur pas malit. Po afronte një mëngjes i kaltër i ndritshëm. Mit Vetullziu vështroi edhe një herë fytyrën e bukur të komitit dhe u kthye me vërtik nga ishte stani. U ngjit turravrap në kodër dhe ktheu kokën vetëm kur arriti te Peçoja. Në lëndinë, veças çetës, trupi i drejtë i komitit vështronte gjithnjë lart, nga ishte stani.

Drita e mëngjesit po zbardhte gjithçka. Vesa nisi të shndriste mbi bar e gjethe. Stani u ngarkua i tëri. Mushkat bënë kaba të madhe me plaçka. Mit Vetullziu qëndroi pranë mushkës me kapistrën në dorë. Mbi pyll, poshtë, pranë luginës, ndehej një mjegull e hollë si guna e tij e hirtë. Më në fund dielli nxori ballin e kuq nga maja e malit.

Ai mblodhi kapistrën dhe kërceu mbi samar. Dhentë ulën kokat dhe e ndoqën të bindura, duke shpërndarë melodinë e këmborëve. Tingujt e këngës së vjetër pushtuan ajrin e freskët të mëngjesit. Mit Vetullziu njomi sytë. Ai uroi nga zemra të birin dhe në çast u kujtua se si nuk i bleu një pushkë. Ecte e shijonte këngën. Mushka trokëllinte, dhentë buisnin në renë e pluhurit. Papritur ndali. Diçka ndjeu në ajër, në këngë e në shushurimën e pyllit. Një boshllëk që sa vin-

te e pllakoste mbi çdo gjë. Ktheu kokën me vrull. Këngën e djalit nuk po e përcillte njeri, ndërsa e shoqja kishte shtangur e po shihte rrotull e hutuar.

Dilla nuk qe më me stanin. Ajo ishte zhdukur me hijet e fundit të natës, me mjegullën e luginës dhe çetën e Malo Gjakmarrit.

Kënga del nga shpirti

(Në çdo etapë të jetës së tij, populli shkëput nga shpirti ndjenjën e madhe, që rrëfimin për heroin e shndërron në këngë. Kush bie në këngë, bie në pavdekësi.)

Mbi kamp ra fresku i mbrëmjes. Shkëlqimi u zbeh e fill pas tij u mek edhe ajo zhurmë që lëshon gjëja e gjallë e natyrës. Kuajt dolën nga hijet ku kishin kënduar gjithë ditën gjinkallat, përkulën qafat drejt tokës së përzhitur dhe ndenjën në radhë të çrregullta në she-

shin e ngrehur aty për aty nga kryengritësit. Për disa çaste kuajt mbetën ashtu, me qafë varur, derisa erdhën kryengritësit me takëme dhe i shaluan mirë e bukur. Kafshët formuan në shesh një figurë të çrregullt e të valëzuar.

Çadrat e kampit qenë shpërndarë buzë lumit, pranë një pylli me rrape të ulëta. Mbi zallin e bardhë të lumit dalloheshin formacionet e fundit të kryengritësve, që e kishin larguar zhegun duke u freskuar në ujin e ftohtë që zbriste nga malet e Çikës, aty ku shkrinte dëbora. Po afronte koha e nisjes. Njerëzit nisën të lëviznin drejt sheshit. Kur mbërritën aty, bashkuan kuajt dhe u hoqën mënjanë grupe-grupe në pritje. Malet përreth ishin të veshura me shkurre të dendura. Tej nga jugu ngrihej Çika e kaltër, me qeleshen e bardhë mbi krye.

S'kaloi shumë dhe prej çadrës ku qe mbledhur Mbrojtja Kombëtare doli një grup luftëtarësh me qeleshe të bardha. Njëri prej tyre u shkëput e vështroi qiellin lart.

— Erdhi koha të nisemi, — tha ai. Edhe të tjerët vështruan qiellin pas shembullit të tij. Nga perëndimi shtrihej një fashë e mekur drite që mezi zbardhte tokën. Qielli i qershorit dukej më i zbardhëlluar nga avujt e dendur të ditës që po perëndonte.

Luftëtari që tha të niseshin, u kthye nga grupi i të tjerëve.

— Të shkojmë, o Osman Haxhia?

Tjetri hodhi disa hapa para, pastaj u përqa-fuan.

— Të priftë e mbara, Selam Salaria! — Osman Haxhia u përkul pak kur e përqafoi, se shoku i tij qe më i shkurtër.

Ai që quhej Selam Salaria u përshëndosh me të gjithë dhe eci drejt grupit të kuajve. Bino-

ku i tij gjendej në ballë. Kërceu mbi të e shtrëngoi fort frerët.

— Të mirë u pjkeshim në Vlorë, — thirri duke tundur dorën në ajër. Edhe të tjerët përshëndetën me dorë, pastaj Binoku e i zoti u hodhën përpara. Mbas tyre tërë ajo figurë e çrregullt lëvizi dhe u shndërrua në një gjerdan të murrëtyer që nisi të ngjitej kodrës së Drashovicës.

Selam Musa Salaria që shkëputur nga çetat. Kali i tij kapërcente me trokth shkurret dhe ai e ndjeu veten të lehtë nën filladitjen e mbrëmjes. Ktheu kokën pas dhe vuri re se që shkëputur si tepër. Shtrëngoi frerët dhe priti. Mbrëmja po binte e freskët dhe e bukur. Përreth tij ndeheshin kodrat e buta me shkurre dhe ai vuri re se kishte qëndruar në pikën më të lartë. Prej andej shqoi kodrat e Vlorës, të veshura me ullinj. Diku atje qenë trupat e armikut. «Do t'i mundim — tha, — do t'i hedhim në det breshkaqentë!» Dhe mendoi për të satën herë i kishte thënë këto fjalë atë ditë.

Më në fund që vendosur sulmi mbi Vlorën. Mezi e kishte pritur këtë sulm. Luftëtarët e tij kishin korrur fitoren mbi Kotë. Dhe ja tani marshonin drejt Vlorës.

— Do t'i mundim, — tha ngadalë, duke vështruar ullinjtë mbi kodër. Çetat qenë afruar. Murgëtira e mbrëmjes po vishte kodrat përreth. Ata shpejtonin që të mbërrinin para natës në kodrat e Vlorës, atje do ta kishin më të lehtë të përgatiteshin për mësymje. Selam Musai ecte në krye, thundrat e kuajve linin pas një re pluhuri të lehtë e të verdhë. Në kodrat e Vlorës u ndezën projektorët e parë. Atëherë ai dha urdhër të ndalnin. Luftëtarët erdhën dhe iu mblodhën përçark.

— Do t'i afrohem armikut të maskuar, — foli duke hetuar fytyrat e shokëve.

— Ashtu të bëjmë, — u hodh Dule Dalani, — komandanti e ka menduar mirë.

— Ti, Dule, zgjidh dy burra dhe nisu përpara! Shiko njëherë ç'bëhet.

Dule Dalani humbi mes' kryengritësve. Komandanti priti fjalë nga shokët. Por ata nuk folën. Prisin betejën. Dëgjohej vetëm kënga e vetmuar e një zogu e përzier me trokthin e kalit që përplaste këmbët me padurim.

— Të pushojmë, djema. Secili të presë një degë mare e bezge, që të ruhet nga drita e projektorëve. Nga mesnata do të nisemi. — Ai zbriti nga kali dhe ia la Melunit të kujdesej për të. Pastaj hodhi lehtë hapat, thirri Memë Sherifin, Dule Dalanin e të tjerë dhe dolën mbi breg.

Si ca shigjeta të zjarrta, nga pozicionet e armikut, derdheshin dritat e projektorëve. Mугë-tira e mbrëmjes shkërmoqej në qindra pjesë dhe secila shfaqte një copë tokë ku do të shkelnin ata. Ai mendoi se dega e shkures do t'i fshih-te mirë veshjet e bardha të kryengritësve. Deri në çastin e nisjes kishtë kohë. Porositi Dulen të vinte dy burra të zgjedhur pranë pozicioneve të armikut. Ata do të prisnin atje e për çdo gjë do të lajmëronin menjëherë.

— Do t'u biem pa na vënë re, — foli Selam Musai.

— Do t'i zëmë në befasi, — tha Memë Sherifi. Ata qenë kthyer për nga llogoret e armikut.

— Në të gdhirë jemi në Vlorë.

— Të lumtë goja, — i tha Selam Musai.

Pastaj ra përsëri heshtja e mbrëmjes. Me të u përzie një këngë. Luftëtarin e çlodh kënga. Por ai s'po u besonte veshëve. Kaq shpejt e kishin thurur? Kënga ngrihej shtruar. Cili grup do të qe? Ai u harrua pas saj.

*Ç'u shkule nga Drashovica,
lule, more Selam, lule,
me treqind e ca komita...*

Melodia ngrihej e qetë, e lehtë e me zëra të plotë. Sa, shpejt që e ngritën. Ai kërkoi me sy Melunin. Me siguri ai, duke u kujdesur për kalin që ulur atje dhe shënonte fjalët e këngës. Iu kujtua dita kur kishte dhënë urdhër për ta vrarë... E kishte në mes të robërve kur morën Kotën. Ai fliste shqip dhe mendoi se do të qëndonjë tradhtar. Tradhtisë i duhej zhdukur farrë. Por ai nuk që nga ajo farë. Kishte mbetur aty nga e keqja. Më pas e mësoi këtë dhe e mbajti pranë, ngaqë dinte shkrim dhe këndim. I foli Melun, si i pafat në jetë.

Kënga pushoi dhe përsëri u vendos qetësia e mbrëmjes. Errësira mbulonte vendin si napë e zezë. Herë-herë atë e grisnin dritat e projektorëve. Në qiell yjet dukeshin të rralla. Qielli i qershorit i largon yjet.

Ai që pranë shokëve. Edhe ata vështronin qiellin. Selam Musai mbështeti maliherin në sup dhe pa fytyrat e tyre. Djemtë kishin vënë re se komandanti ditët e fundit i vështronte gjatë. Nga grupi i luftëtarëve që ishin më pranë u dëgjua një këngë tjetër. Dikur edhe ai e kishte kënduar këtë këngë. Atëherë kur ishte në Jemen, nizam për turkun. Kjo këngë i kujtoi të shkuarën.

Mbeçë, more shokë, mbeçë...

Ashtu kishte kënduar bashkë me Aqif Llakën, kur shkuan kundër turkut. Qenë nisur aty ndaj mbrëmjes. Aqifi që më i ri. Te kroi i parë i kishte ndalur e ëma e Aqifit. Ajo e puthi në ballë: «Selam, të kam lënë djalin në dorë, ma ki kujdes, se mezi e kam rritur». Aqifi që trim djalë. Mbi kodër të Salarisë ia kishte marrë këngës. Ai nuk e kujtoi se cilën. Ndoshta që ajo këngë. Mbetën ca kohë andej. Pastaj Selami që

kthyer vetëm. Plumbi i armikut i kishte marrë jetën shokut.

*I falmë shëndet nënesë,
të dy qetë të m'i shesë...*

Kaluan vite dhe erdhi greku. Ai mblodhi çetën e u nis. Në çetë kishte hyrë Aliu, vëllai i Aqifit. Në grykë të malit, çetës i doli përpara nëna e Aliut. Ajo iu afrua Selamit dhe e puthi në ballë: «Selam vëlla, të kam lënë në dorë djalin tjetër. Kije kujdes, se më zhuritet zemra.» Por qe thënë që kjo nënë të mbetej qyqare për djem. Aliu ishte më trimi i shokëve. Luftonte gjithmonë në krah të Selamit... Ajo qe betejë e rreptë. U ngrit Aliu dhe i vajti me maliher në dorë oficerit grek. Qëlluan flakë për flakë... Kur e gjeti shokun, i pikoi zemra mbi shkëmb. E dhembjen e shoi mbi trupat e armikut...

*Në pyet nëneja për mua,
i thoni që u martua.*

Grupi këndonte ende. Ai tha me vete se do të qe më mirë të mos këndohej atë natë ajo këngë. Le të pushonin e të tregonin historira. Por asnjëri s'po fliste. Ishte e para natë që edhe ai po heshte. Edhe shokët atë mendonin. Komandanti s'donte të fliste atë mbrëmje para betejës. Rrinte dhe mendohej. Kënga vazhdonte. Ai përplasi buzët dhe i mbajti iso këngës me zë të ulët.

— Këndojnë djemtë para betejës, — foli ngadalë Memë Sherifi.

— I thoni që u martua për Shqipërinë, — rrahu fjalën gjetkë komandanti. Më në fund kënga heshti. Sa dendur po shtrohej heshtja atë natë. Me se ta largonin?

— I ka pjekur uria për lirinë e Shqipërisë,
— tha Selam Musai.

— Çlodhen kur këndojnë, — tha një luftëtar.

— Ashtu është, o Shefqet, — tha komandanti.

— Tani u këndon zemra, pastaj do t'u këndojë pushka.

— Të bëhemi gati, komandant? — pyeti Memë Sherifi.

— Si shpejt më duket. Mos t'i nxitojmë trimat.

— Na trego gjëkafshë, o komandant.

Selam Musai e shikoi në sy atë që foli. E ç'ti tregonte? Jeta e tij kishte qenë vetëm luftë. Që kur kishte lindur e deri atë çast. A nuk po e priste edhe tani beteja? Çastet e luftës kishin ndjekur njëri-tjetrin, sa atij i ngjante si një jetë e zakonshme. Për trimërinë ndoshta rrëfen ai që ka mbetur borxhli përpara saj... Kështu mendonin edhe shokët dhe heshtën.

Në natën e errët kryqëzoheshin dritat e projektorëve, duke e bërë errësirën të mugët si para agut. Selam Musai vështroi yjet në qiell. Koha po afronte. Ai mbështolli mirë gunën e hirtë. U dëgjuan hapa dhe ca pëshpërime të lehta që vinin drejt tyre. Pas pak u dalluan katër burra me qeleshe të bardha. Në krye qe Dule Dalani, pas tij ecte Ibrush Muçoja me dy luftëtarë.

— Ç'e mirë ju solli këtu? — pyeti Selam Musai.

— Le të flasë Ibrush Muçua, — foli njëri nga luftëtarët.

Ibrush Muçoja hodhi dy hapa majtas dhe zbuloi luftëtarët. Ata të dy qenë veshur me të leshta, kurse në dorë mbanin nga një sëpatë bishtshkurtër.

— Përse jemi mbledhur këtu, komandant? — foli Ibrush Muçoja pasi u hodhi një vështrim luftëtarëve.

Selam Musai e vështroi thellë, nën vetullat e dendura. Dy rrudhat në faqe, që preknin çipin e mustaqeve, u thelluan edhe më. Ku donte të dilte Ibrush Muçua?

— Për lirinë e Shqipërisë, — iu përgjigj atij Shefqet Shehu.

Selam Musai u ngrit në këmbë dhe rregulloi gunën e shkarë supeve. Pastaj ngriti brezin e rëndë të fishekëve dhe hodhi dy hapa drejt të porsaardhurve.

— Mos të ka hyrë lepuri, Ibrush Muçua? — foli duke e hetuar të tërin.

— Mos e thuaj atë fjalë, komandant. Më mirë i pres këmbët dhe duart, por pas nuk kthehem. Ti më njeh, — ndali një grimë dhe pa përsëri dy luftëtarët. — Por llafin e kisha, gjetkë... a pranon mëri në mes të luftëtarëve lufta kundër armikut?!

— Mëria është gjysma e mortjes, — tha Selam Musai.

— Aty më rri, komandant. Këta dy luftëtarë, për një mëri të vjetër që kanë fiset e tyre, për pak u therën sonte.

Ai hoqi ngadalë sytë nga Ibrush Muçoja dhe pa dy luftëtarët. Ata ia kishin ngulur sytë tokës.

— Nga ç'shtëpi je ti, more? — pyeti njërin.

— Nga Elezajt, — u përgjigj ai.

— Po ti?

— Nga Deliajt.

Selam Musai u afrua, i vështroi përsëri dhe ngadalë u hoqi sëpatat nga dora. Luftëtarët nuk patën forcë ta kundërshtonin.

— Salaria nuk është mësuar të turpërohet. Kthehuni në fshat tani, se Shqipëria bën edhe pa ju!

Dy luftëtarët nuk lëvizën nga vendi. Selam Musai u ktheu shpinën e iku tutje. Qëndroi në këmbë, me fytyrë nga pozicionet e armikut. Ai

e ndjeu se të dy luftëtarët ishin ende aty, me sytë përtokë.

— Komandant, — u dëgjua zëri i një luftëtari, burri i Salarisë më të rëndë ka t'i heqin armën nga dora, se vdekjen me sy hapur.

— Armët na duhen për lirinë, — ia ktheu Selam Musai.

U shtrua përsëri heshtja, që qëndroi si shkëmb në supet e të gjithëve.

— Të na vërë në provë edhe një herë At-dheu, — tha një nga luftëtarët.

Selam Musai nuk u përgjigj. Rrotulloi shpinën dhe vështroi shokët me radhë. Pastaj pyeti Ibrush Muçon:

— Ç'mendon ti trim?

— Guximin t'ua shohë armiku.

— Po ti, Dule Dalani?

— Të bëhet dëshira e Ibrushit.

Komandanti u kthye nga të dy luftëtarët, u la sëpatat në dorë dhe u rrahu supet.

— Hajt, bëhuni vëllezër si tërë shqiptarët!

Dy luftëtarët u afruan me druajtje por, kur dalluan vështrimin e rreptë të Selam Musait, u përqaftuan e u puthën.

Një fashë e zbehtë drite ra mbi kodër. Ajo për një çast ndriçoi festet e bardha dhe shkoi tutje duke shkelur mbi kodra, si një nimfë e bardhë që vraponte të fshihej në errësirën e luginës. U ndje një këngë tjetër. Selam Musai dëgjoi fjalët. Edhe ajo që këngë e re. Isoja dridhej në hapësirë me ca zëra të shtruar, të ngrohtë e me mall. Atij iu kujtua shtëpia. Edhe kënga për stanet fliste. Këndonte bariu, atje larg, me kërrabën e balon pranë:

*Nënë, do më tresë malli,
apo do më tresë behari?!*

Atij iu lagën sytë. Edhe stani i tij kishte mbetur thellë në malet e Salarisë. Kopeja e tij gjendej pa bari. Të çlirohesh Shqipëria njëherë... Ai mendonte dhe dëgjonte në heshtje. Sa shumë kishin kënduar atë natë. Thonë se kënga të zgjat jetën.

— Ju këndoftë zemra, o djema, — shqiptoi ai ngadalë, aq sa shokët mezi e dëgjuan.

Memë Sherifi rregulloi gunën krahëve dhe u kthye nga komandanti.

— Përse thonë, komandant, «më qafsh», dhe jo «më këndofsh»? Nderi më i madh për njeriun është kur këndon për të.

Selam Musai e vonoi përgjigjen.

— Një lloj kënge është edhe kur qan njeriu, kënga e dhimbjes së shpirtit. Ne burrat atë këngë e themi pa zë. Në të vërtetë e këndojmë dhe është kënga, më e shtrenjtë, sepse del me lot nga shpirti.

— Mbas vdekjes sime do të doja vetëm një këngë, komandant.

— Si të jetë vdekja. Po të na dalë shpirti në luftë kundër armikut, s'ka vdekje më të mirë.

— Pa e marrë Vlorën, nuk kthehem i gjallë, komandant, — foli Shefqet Shehu.

— Vlora është nderi i tërë Shqipërisë sonte. Atë do ta marrim, gjallë a vdekur! — foli Ibrush Muçoja.

— Çohemi atëherë, djema, se erdhi koha. Bëhuni gati, — tha Selam Musai dhe u hodh në këmbë. Kur ata ikën, thirri Melunin. Ai erdhi bashkë me Binokun. Selam Musai i rrahu qafën kalit dhe kërceu mbi të. Ai mendoi t'i priste më tej çetat. Binoku fluturoi drejt kodrave të Vlorës. Ndali pastaj hapin e kalit, i cili nisi të çapitej mes shkurreve. Ktheu kokën pas. Pranë daloj Melunin me çantën e meshintë supeve. Atë çantë ia kishin kapur një gjenerali kur morën

Kotën. Meluni ecte kokëvarur. Kushedi se ç'thur atje brenda, mendoj komandanti duke parë çantën me shkresa. Ngriti kokën lart. Harusha e Madhe fekste mirë. Tamam çasti i sulmit, mendoj ai. I zbriti kalit dhe priti. Meluni u hoq mënjanë me Binokun. Përreth nuk ndihej asnjë lëvizje. Ku do të jenë, pyeti veten. Priti dhe ca duke parë nga kodrat me ullinj, ku ndritnin projektorët si ca sy të mëdhenj të tokës. Befas dëgjoi zërin e Dule Dalanit. Ktheu kokën dhe mezi shqoi luftëtarët. Ata marshonin të maskuar. Pas pak erdhën të gjithë kapedanët. Ata raportuan se çetat e Kurveleshit, Mallakastrës dhe të Lumit të Vlorës qenë shpërndarë në formacion luftimi. Selam Musai dëgjoi i heshtur. Ata prisnin urdhrin e tij. Këtë e kuptoi nga heshtja e tyre.

— Atëherë, oburrani në Vlorë, — u foli djemve dhe çau përpara. Maliherin e shtrëngonte fort në dorë. Shokët e ndiqnin hap pas hapi. Diku i zuri syri armikun e parë. Në këmbë, siç qe, ngriti maliherin dhe shtiu. Edhe shokët shtinë njëherësh. Britmat e luftëtarëve ushtuan në terr. Ai ecte dhe qëllonte. Ndali përsëri, u mbështet në gjunjë dhe shtiu. Kur u ngrit, thirri me zë të fortë:

— Përpara, djem, në Vlorë!

Vendi u ndriçua nga projektorët e shumtë. Plumbat binin si breshër. U bë tym kudo e nuk shihje as tre hapa para. Po i qëllonin me artilleri. Përpara u dukën telat. Armiku matanë shtinte dhe zbrapseej. Ai ndali dhe vështroi përreth. Shokët shtinin dhe thërritnin fort. Dukej sikur armiku rrëzohej nga zëri i tyre. U bë me krahë. Hodhi gunën mbi tela dhe për një çast u gjend në llogoren e armikut. Diku shtinte një top. Ai pengonte shokët të çanin përpara. U afrua me shpejtësi dhe shtiu mbi ushtarët. Njëri që kishte mbetur gjallë ngriti duart lart. Selam Mu-

sai e shtyu tutje. «Paske mbetur si bajgë në shi», foli nëpër dhëmbë dhe kapi grykën e topit. Ai qe i rëndë. Gryka u kthye nga deti. Shefqet Shehu po shtinte më tej.

— Kujdes, — thirri dikush, — mos ec shumë përpara!

Poshtë kodrave shtrihej Vlora. Edhe një sulm dhe ai me djemtë do të gjendeshin atje. Një kolonel italian shtynte grupin e ushtarëve drejt kodrës. Selam Musai fluturoi si veri. Qëndroi dhe priti. Koloneli ishte një fyell i gjatë e i thatë. Fytyra i fekste nga bardhësia. «S'e ka zënë dielli», tha me vete Selam Musai, «flaka e barotit do ta nxijë.» Koloneli vazhdonte të shtynte ushtarët. Dule Dalani u gjend në krah. Selami e pa dhe iu bë zemra mal. Shefqet Shehu në krahun tjetër ngriti pushkën. Ai zgjati dorën dhe ia uli.

— Prit të afrohen, — i pëshpëriti... Dhe në çast iu kujtua dita kur qenë mbledhur në Beún. Shfeqet Shehu kishte ardhur nga dreka. Selam Musai e pyeti se ç'armë kishte sjellë. Ai kishte zgjatur maliherin dhe tetë fishekë. Po vetëm tetë fishekë kishte. Pastaj qe ulur dhe kishte çarë me strall plumbat.

«Përse i çan, o trim?» — e kishte pyetur.

«Një plumb të vrasë dy armiq», — qe përgjigjur ai.

Koloneli ishte afruar së tepërmi. Ai vuri re grupin e vogël të luftëtarve dhe ngriti revolen. Selam Musai e shënoi më parë në lule të ballit. Koloneli u rrëzua me një thirrje të gjatë. Ushtarët hodhën armët dhe u kthyen mbrapa. Britmat e shokëve mbushën gjithë vendin. Ata kishin kaluar brezin e parë të llogoreve të armikut. Ai kthente kokën pas që të shihte.

— Përpara, o djem, — thirri me sokëllimë dhe eci poshtë, drejt qytetit. Tani atë nuk e ndalte asgjë. Plumbat binin gjithandej. Por ai ecte

dhe thërriste. Pas, shokët mezi e arrinin. Ai turrej para dhe shtinte. Pastaj ndalte dhe dëgjonte pushkët e luftëtarëve. Pas thirrjes së tij, ata përgjigjeshin në kor...

Sa do të qe larg mëngjesi? Ata ishin betuar që në mëngjes të kapnin Vlorën. Udhës ai ndeshte ushtarë të shpërndarë në panik. Ja dhe Vlora. Ajo shtrihej poshtë, nën këmbët e kodrës, me dritat e pakta, e vuajtur dhe e plakur nga pushtimi. Atij i dhembti zemra si të qe ajo një fëmijë. Në agim luftëtarët do të kalonin fitimtarë në rrugicat e qytetit. Ai vetë do të ecte kaluar me Binokun. Meluni do të brohoriste nga gëzimi duke rrahur fort çantën e meshintë që ia kapi gjeneralit. Pastaj diku do të ulej dhe do të shënonte fjalët e ndonjë kënge të re.

*Kush e njuh Selam Musanë,
burr'i shkurtër, leshrabardhë...*

Pastaj kënga do të hapej gjer në Salari. Po Meluni do të këndonte? Do të këndonte e do të tregonte. Çfarë do të tregonte?

Po shokët ku do të ishin? Në çast dëgjoi britmat e tyre. «Oho — oho», u përgjigj me hov. «Përpara, o djem, në Vlorë, kapini breshkaqentë me dorë!» Po Meluni ku do të qe? Mos e kishte marrë plumbi? Atij do t'i therte zemra si për të vëllanë... Por ç'po ndodhte kështu mbi kodër? Nuk donin të tërhiqeshin. Gjenerali vetë shtynte ushtarët i egërsuar. Selami u hodh përpara dhe priti me maliher në dorë. Ushtarët ngjiteshin duke u rrëzuar. Kurse ai i priti në këmbë.

Në qiell po binte drita. Mbi Vlorë, mbi detin e lodhur e të përgjumur, po shtrihej agu si mjegull e lehtë. Tej nga ishulli shtyhej në horizont

një fjollë tymi. Po vinin përforcime për armikun. Një sulm i ri po niste. Ai do të qe sulmi i fundit.

Ushtarët ngjiteshin. Gjenerali ecte në mes. Selam Musai dalloi trupin e madh të tij të veshur e të qëndisur, me xhufka ngjyra-ngjyra. Dikush i thirri të kthehej. Por nuk lëvizi. Britmat e shokëve po afroheshin. Ja, ai hodhi disa hapa dhe u doli përpara armiqve. Gjenerali shtangu. Sytë e tyre shkëmbyen vështrime urrejtjeje. Ç'ishte ai plak i bardhë, luftëtar apo e kishte lindur mjegulla e mëngjesit? Po, ç'ishte ai plak i bardhë, me xhamadan shqyer e gjoksin hapur, me atë fytyrë të ndritur, me mustaqet e bardha e sytë e zjarrtë, me vetullat e rënda sikur të qe ulur aty gjithë dhembja e vatanit? Gjenerali nuk e ngriti dorën. Ai mendoi se do të qe erë e nuk e zinte plumbi. Ç'kërkonte atëherë me atë maliher në dorë e gunën çapëlyer supeve? Gjenerali ia nguli sytë maliherit, i cili u ngrit vetëtimthi dhe mori shenjë ballin e tij. Edhe dora e gjeneralit u ngrit vetiu dhe mori shenjë zemrën e Selamit. Gjenerali ra i vdekur në vend. Kur po rrëzohej, tha edhe një herë me vete se ai tjetri qe erë dhe nuk e zinte plumbi.

Lindja po derdhte mëngjesin e bardhë. Por tani ushtarët qëllonin me breshëri mbi të. Ai u ngrit edhe një herë. Flaka dhe tymi që mbinte nga dheu i pushtuan trupin. Vendi po digjej. Edhe një herë ai pa qytetin mes flakës, pastaj së fundi dëgjoji thirrjet e shokëve që vraponin mes agut, drejt Vlorës së tyre.

G o g a

Mëngjesi i asaj dite hapi kanatet nga maja e bardhë e Tomorit; retë e rënda u çanë dhe rrezet e diellit derdhën mbi tokën e tharë një dritë të zbehtë. Nisi pastaj era e lindjes e ngjau sikur edhe ajo doli së bashku me rrezet nga maja e bardhë. Pylli aty pranë u përgjigj me kërcitjen e thatë të krahëve gjumashë dhe nga kraharori i tij i verdhë u shkëputën gjethet e para. Goga mori një gjethe në dorë. Në gjethen e tharë e të rreshkur si lëkura e saj, ajo dalloi damarët e bardhë, njollat e errëta dhe me zemër të thyer e lëshoi. Si krah fluturë gjethja ra në tokë.

Kishte ardhur vjeshta. Gjethja po thahej e tëra e pas kësaj do të thaheshin edhe sisët e dhive. Nga kasollja vinin blegërima dhe Gogës i sëmboi në zemër. Asaj gjithmonë i ngjante kjo blegërimë si e qara e foshnjës për qumështin e nënës dhe gjoksi i psherëtinte me sëmbime që nuk i duron dot asnjë zemër nëne. Sepse zemra e nënës tkurret e fishket, kur s'ka një gëzim në kasolle, një pjellë të saj që t'i fërkojë gjoksin me turirin e njomë. Ndoshta ky mall e kishte plakur Gogën më shpejt se vitet dhe ajo ngjante dy herë më e moshuar.

Ajo hapi lesën e kasolles. Dhitë, posa, e ndienë i lëpinë duart dhe rrobat. Ato ishin tri dhi të thata që mezi mbaheshin në këmbë. Goga i nxirrte çdo mëngjes në pyll për njomështirë. Kur pylli thahej, ajo i çonte më tej, në bregoren mes shkurreve, ku vjeshta vononte të ngjitej.

Në pyll ishte bukur. Ajo lëshonte dhitë dhe ulej në hije e mendohej. Zilet e dhive përhapnin këngën që humbiste mes drurëve të pyllit. Asaj i dukej sikur thithnin gjethet e gjelbra në njomështinë e tyre.

Kjo ndodhte në pranverë e në verë, kur pylli, siç thoshte ajo, jetonte, fliste me erën shuu-shuu, derisa nga këndi tjetër ia merrnin këngës zogjtë. Në vjeshtë e në dimër nuk i bënte zemra t'i afrohej. Dhitë i nxirrte lart në shkurre dhe prej andej, duke parë pyllin lakuriq, mendonte se ai ishte si gjarpri, që një herë në mot ndërron lëkurën. Megjithatë, kur shihte që vjeshta i zverdhte fletët, Gogës i dhimbte shpirti si t'i mbeteshin fëmijët pa bukë. Dhe çudi, gjërat në këtë botë Goga i maste gjithmonë me dhembshurinë e nënës për fëmijën e vet.

Ajo ishte vjeshta e parë që e gjeti vetëm në stan. Një mot si tani, Ndini i saj iku në mal, te shokët. Që atë ditë ajo nuk e kishte parë më.

Disa herë ai i dërgoi lajm me Pilon dhe i thoshte se qe mirë. Piloja i pati thënë se ishte korrier dhe shëtiste mal më mal. Shokët e Partisë ia besuan këtë detyrë si më i moshuar, (ndoshta Ndini i saj qe më i moshuari mes partizanëve). Vendin e njihte natë e ditë në ato anë, kudo e hidhte hapin pa ngurrim.

Ajo i la dhinë të fërkonin turirin pas fustanit të saj një copë herë të mirë. Pastaj zgjati duart, i përkëdheli si fëmijë, u hodhi gjethet e doli. Hapat i bënte të rëndë. Eci kuturu në vathë. Vështroi qiellin e errët. Po vinte dimri me cikmën dhe shirat e ftohta. Asaj i erdhi keq për djemtë e malit. Ishte nënë edhe ajo dhe kishte dhembshuri.

Pranë pusit qe një kërcu i thatë dhe mbi të një pllakë e vjetër guri që zinte grykën. Ajo hoqi pllakën dhe u ul mbi kërcu. Atëherë u kujtua përsëri për kampin armik. Ai erdhi bashkë me vjeshtën atë mot dhe u ngul buzë pyllit. Natën bënin zjarr të madh, e flaka ndriçonte gjer te stani i saj. Thoshin se me ta qe një ballist barklopë, i cili u rrëfente udhën, e mbrëmjeve u shërbente. Disa herë kishin plaçkitur fshatin. Ata që i kishin parë, thoshin se s'kishin të ngopur dhe gjë të gjallë nuk lanë në këmbë. Po përse qenë ngulur aty? Vonë u mësua se ata ishin të një ekspedite që kërkonte mademe të një guri të zi, të butë, sa shkrinte edhe nga dielli. Ai gur gjendej në kodrën e butë, nën themelet e kasolleve të fshatit. Në një nga ato kasolle kishte lindur Goga. Prindërit e lanë jetime shpejt. Ajo nuk e mbante mend sa vjet jetoi vetëm. Pastaj erdhi Ndin Buzalli, i ikur nga hasmëria, e mori e u ngul aty buzë pyllit, veças fshatit, i përgjuar nga hasmi. Ikën vitet, por ajo nuk ia gëzoi pragun me të qarën e një fëmije, sepse ndodhi shtrat shterpë Goga. Por jeta

i dha një gëzim, dashurinë për Ndinin dhe djem-
të e malit. Ata i gëzonin stanin kur vinin, pran-
daj, sa herë që malet vishnin hijen e reve, asaj
i dhimbte xhani për ata djem që do ta kalonin
edhe këtë dimër në mal. Ajo kishte mbledhur
disa palë çorape, ca bukë e ca djathë dhe i
mbante lidhur në trastën e leshtë fshehur në
stan. Nga çasti në çast priste të vinte Piloja.
E priste të vinte bashkë me Ndinin. E kishte
djegur malli, sepse duke rendur drejt pleqërisë,
këto vite bëhen përherë e më të ngrohta.

Ajo ndjeu të ftohtë nga kërcuri i lagësht.
Lëvizi dhe shpiu trupin e tharë. Në tokë u ndeh
hija e saj e gjatë. Plaka Gogë (ashtu e thërritnin
në fshat, edhe pse nuk i kishte mbushur të dy-
zetat), kishte një trup të gjatë, me shpinën disi
të kërrusur e dy duar e këmbë ku dalloheshin
kyçet e dala si nyja rrap. Hapin e hidhte të
madh, duke shkelur në potinat e leshta, ndërsa
fustanella, e zezë me pala, që e kishte punuar
dikur me leshin e deleve, dukej sikur ia shton-
te moshën. Atëherë që më e re dhe punonte
shumë. Në këtë botë plaka Gogë e kishte
mbajtur barrën sa të mushkës...

Qielli u vesh. Pas pak ai lëshoi pika të
mëdha e të rralla si ca zaje që binin me kër-
citje të thata mbi gjethet e rëna të vjeshtës.
Ajo nxitoi të mbulonte pusin me pllakën e
rëndë. Në pasqyrën e ujit pa fytyrën e saj.
Dy rrudha të thella nisin hendekun nga go-
ja gjer te sytë. Ajo mbështeti palat e kësul-
lës së zezë mbi flokë dhe zgjidhi kollanin e
syrin të vrarë. Atë e kishte vrarë vite më pa-
rë. Kur jetonin prindërit, u rrëzua nga një
man i lartë. Nëpër degë syrin ia shpoi një
gjemb i hollë e i plasi gjaku. Erdhi i ati, ia
mbylli syrin dhe ia lidhi me shami të palo-
sur. Dhe prej asaj dite ajo nuk e hoqi më ko-

llanin që fshihte syrin e vrarë. «Edhe me një sy e shikoj dynjanë», thoshte. Por njëherë Ndini i tha të shtinte me pushkë. Ajo gati sa nuk lëshoi lot. Plaka Gogë rrallë kishte qarë në jetë, ndoshta vetëm atëherë kur i vdiqën prindërit. E kishte kuptuar nga babai se një-rëzit e fortë nuk qajnë kurrë. Dhe ajo nuk qau kur Ndini i vuri pushkën në dorë. Qëlloi mirë, vetëm se iu drodh pak zemra, por më vonë thoshte se iu drodh nga gëzimi.

Pylli vazhdonte të dridhej si në ethe. Nisi të frynte me forcë era, ajo lozte me gjethet e thara, i përdridhte, derisa i hidhte tujtje, në ujërat e turbullta të lumit. Gogës i theri zemra për dhitë dhe vështroi qiellin. Dielli fshihej i druajtur pas reve.

Në mbrëmje duhej të vinte Piloja. Djemtë do t'i nisin lajm. «Nëno, kur të çlirojmë vendin, ty do të të ndërtojmë një shtëpi të re në mes të fshatit. Shtëpia do të jetë e madhe, e bukur, prej guri. Ti, nënë, ke djem shumë dhe ne do të të urojmë pleqëri të mbarë me plakushin tënd, që i ka mustaqet sa bishti i dhelprës». Kështu do t'ia thoshte fjalët e shokëve Piloja. Dhe plaka Gogë e dinte se ashtu do të ndodhte. Se, ç'thoshin ata dhe nuk e bënë? Në gji kishin një zjarr që i ndizte. Atë zjarr ua ndezi ajo Parti që rrinte atje në mal me ta dhe i drejtonte. Dhe gjersa djemtë e saj qenë lidhur me të, do të ishte për fukaranë... Plaka Gogë ëndërronte shtëpinë e re prej guri. Si do të qe ajo? Ku do ta ngrinte? Me se do ta mbushte? Mjaftonin djemtë e malit dhe gëzimi i tyre. Ajo do të ulej në qoshen e oxhakut, në qoshen tjetër ai, Ndini i saj. Zjarri do të bubulonte dhe ai do të tregonte për luftën. Po të heshte, ajo do ta pyeste përsëri.

Atë çast ndjeu përsëri mall për të shoqin.

Po mbushej viti që nuk e kishte parë. S'e linte detyra atë. U ngrit dhe eci drejt kasolles. Te porta ndali. Në udhë dalloj një njeri. Me syrin e vetëm ajo mezi shqoi se nuk qe për të mirë. Ai ecte duke u lëkundur dhe bënte kaba të madhe nga larg. Pa u menduar gjatë, hyri në kasolle, kërkoi trastën dhe e fshehu te gjethet.

Doli kur dëgjoi zë. Pas lesës së stanit qëndronte ballisti.

— Ka qenë stani? — thirri ai.

Ishte barklopa që u shërbente gjermanëve. Ajo eci drejt tij, por ndërkohë ballisti hapi lesën dhe hyri. «Paska frikë qeni nga qentë», mendoi Goga. Ballisti, pa e bërë të gjatë, shkoi te pusi.

— Do marr ujë për gjellë, plakë, se u turbullua i flamosuri që mbrëmë, — tha ai duke ngritur pllakën e gurit nga pusi.

«Plaka e satëme», tha me vete ajo duke i vajtur pranë. «Qenka fryrë si lopa kur pi vesë». E hetoi nga koka te këmbët. Ballisti dukej i ushqyer mirë. Në brez i varej një kobure e rëndë me zinxhir të ndritshëm. Ai nxori kovën e parë dhe e la mbi kërcu. Të dytën nuk e lëshoi, por mbajti vesh. Blegërinin dhitë. La kovën dhe hodhi hapat drejt kasolles. Dhitë blegërinë përsëri. Gogës i ngriu zemra. Ballisti shpejtoi hapat. Ai hapi shpejt lesën e kasolles dhe nxori dhitë. Goga i doli ta ndalte, por ai e shtyu tutje.

— Ik, lanet, se do të të paguajmë.

Por Goga nuk e dëgjoi. E mallkoi fort dhe ktheu dhitë. Ballisti i shtyu ato drejt daljes por ajo nuk e la. Pastaj u kacafytën. Ajo e shtyu dhe e rrëzoi në tokë. Ai u ngrit, nxori koburen e rëndë dhe e qëlloi me dorezë në kokë. Goga ra pa ndjenja.

Kur u përmend, i dhimbte koka. Lesa e

vathës kishte mbetur hapur. U tërhoq me mundim deri te pusi dhe lagu ballin me ujë e ftohtë. Këmbët mezi e mbanin. Mbylli lesën e u kthye. Kasollja që bosh e në çast mendoi për dhinë që s'do i shihte më. Hyri në kolibën e saj dhe u plandos në tokë, mbi gjethë. «Ku do të jetë Ndini», mendoi. Ra në gjumë të thellë...

Ndjeu kur po binte shi. Ai kërciste jashtë me forcë. Lëvizti ngadalë dhe preku trastën; ishte aty. Jashtë dëgjoheshin edhe gjëmime. Bëhej luftë në mal. «Të që Ndini... Oh, sa më dhemb, o i mallkuar». Preku edhe një herë plagën me dorë dhe doli te dera. Dielli ishte fshehur diku në kupën e përmbysur të qiellit të hirtë. Era dridhte pyllin, e pemët shkundnin gjethet.

Kur pushoi shiu, doli nga vatha dhe shkoi në pyll. Era sikur ra. U ul mbi një degë të thyer dhe dëgjoi herabelat. Ata ishin zogj mali që shkonin në çdo vend. Ndoshta e kishin parë dhe Ndinin e saj kur luftonte për liri. Dikur kishte dëgjuar që zogjtë e malit çojnë haber, ndaj dhe nisi të këndonte.

*O ju zogj, që fluturoni,
kam një mall të m'i thoni...*

Qortoi veten se s'duhej ta humbiste mendjen ashtu. Gjethet kërcitnin nën këmbët e saj. Me të dëgjohej mbytur uturima e ujërave të turbullta të lumit. Kur hyri në stan, mendoi se ajo ditë kishte qenë më e gjatë se zakonisht. Pritja dhe ankthi e ngadalësojnë kohën. Dhe plaka Gogë po priste lajme nga mali atë mbrëmje. Qëndroi një çast te dera. Brenda kishte hyrë mugëtira e muzgut. Hyri dhe ndenji pranë guvës ku ndizte zjarrin, derisa sytë iu mësuan me errësirën. Pastaj zgjati dorën dhe ndezi kandilin me eshkë. Flaka e tij ndriçoi faqet e murit, trye-

zën e drurit ku ajo nuk qe ulur që kur iku Ndoni, disa enë në këndin tjetër dhe në fund kornizën e derës. Atje, për çudi, qëndronte Piloja. Ai hodhi hapat lehtë, si për të mos e ndër njeri dhe pas tij hynë dy të tjerë.

«Nënokë, a je e fortë, mbahesh?» Kështu thoshte kur vinte.

Pastaj nuk foli. Në dritën e kandilit ajo dalloi fytyrat e lodhura të djemve, që rrinin më këmbë, te dera, pa thënë asnjë fjalë. «Ç'kanë djemtë e nënës?» Kushedi që kur s'kanë ngrënë.» Ajo i përqafoi dhe i puthi të tre me radhë, pastaj hapi trastën dhe u ndau bukën.

— Nënokë..., — theu heshtjen Piloja.

— Fol, bir... Po pse nuk uleni?... E di, mos ma thuaj. Janë shokë, gjersa jeni bashkë.

— Kemi ngrënë, nënë, — foli njëri prej partizanëve.

«Sa mirë tha, «nënë.» Ku do ta ketë nënën e vet vallë? Edhe atë e ka marrë malli. Malli i nënës është zog që kalon male.»

— Po atëherë uluni e çlodhuni, — tha ajo.

— Nënokë, ti gjithmonë ke qenë e fortë...

— Të gjitha nënat të forta janë, mor bir.

«Kanë një hall djemtë... Eeeh, mallkuar qofsh, moj luftë që na plake djemtë!»

Piloja iu afrua, i hodhi dorën në sup e me zë të mekur tha:

— Ti na ke djemtë e tu, nënokë...

«Zëri i ëmbël i djalit e çlodh zemrën e nënës.»

— Ne kemi humbur në luftë babën tonë, shokun tonë më të mirë.

Zemra e Gogës u drodh. Vështroi tre shokët e malit. Atëherë vuri re që njëri mbante dy pushkë në krah. «Pushkë e Ndinit», tha me zë dhe u mbështet në krahun e Pilos. Oh, sa

të forta janë nënat, syri i zi u derdh lot dhe dhimbje, zemra u pikon gjak e prapë, kur thërrasin «nënë», «nënë», na ngjan se largojmë frikën, brengën, trishtimin...

Ata ikën ndaj të gdhirë. Piloja i tha se së shpejti do të vinin me komandantin. Kishin biseduar gjatë dhe ajo tani përsëriste me zë fjalët. «Ra si trim i rrallë, nënoke. Ishte shoku ynë më i mirë, baba ynë... Kishte një detyrë të rëndësishme, por e pikasën në qafën e malit dhe i zunë pritë. Luftoi derisa iu mbaruan fishekët... E gjetëm të gjallë kur shkua. Kishite marrë tri plagë në gjoks. Na dha amanet pushkën e tij»... Përsëri ajo e pa veten vetëm. Jashtë kishte lindur pa u vënë re një ditë tjetër. Ajo dalloi pushkën e Ndinit që heshte vaur në gardh. Ndini i saj heshte diku në mal. U dëgjuan gjëmime të largëta. Lufta po zbriste nga malet, kurse armiku gjithnjë e më tepër po mbyllej poshtë.

«Po këta kur do t'i shkulin?»... mendoi për ekspeditën e gjermanëve. «Do t'u vijë ora edhe këtyre», tha dhe doli në derë. Qielli qe plumb nga retë e shumta. Fryu një puhizë e lehtë që i ledhatoi fytyrën: me të erdhi një erë e thatë lulësh nga kurorat e varura përgjatë strehës. Goga ato i thurte në pranverë në lëndinë. Çdo pranverë thurte shumë dhe i varte në derën e kasolles. Ndini e shihte kur kthehej nga dhen-të.

«Edhe tani që u plake, s'hoqe dorë nga lulët», i thoshte. Ai fliste që tej, pa hyrë në vathë. Kur afrohej, ajo i hidhte një kurorë mbi festen e bardhë.

«Ik, moj plakë, se nuk është koha për to.»
Pastaj ajo i varte ato rrotull strehës e atij çdo mëngjes i mbusheshin mushkëritë.

«Na solle livadhin në vathë, moj plakë.»

Kur ikte ai, ajo shkonte për shkarpa dhe, kur kthehej, thurte të reja.

Tani ato qenë tharë nga era e vjeshtës. Kurora e bërë bujashkë iu shkërmoq në dorë. Asaj i erdhi keq, sepse Ndini i donte shumë. Ai tani flinte atje thellë, në mal, ku rriteshin shumë lule. Pranvera do të vinte përsëri dhe ajo do të thurte të reja nga lulet e malit. Pastaj do t'i vendoste përqark varrit të tij, derisa të çelnin lule të reja. Kështu çdo pranverë...

— E, moj plakë, të erdhën mendtë?

Goga u ngrit në këmbë. Ishte ballisti me një kusi në dorë.

— Mendtë në kokë i kisha e i kam. Po ti, ditëzi, ç'kërkon më? — foli pa u tundur nga vendi.

— Ujë, dua ujë... Ky pusi yt qenka akull e ta boshatis barkun, sikur s'ke ngrënë gjë.

Ai iu avit pusit dhe uli kusinë.

— Erdha herët, se do ngrihen sot ata me plaçka e laçka, — foli ballisti tërë qejf.

— Ujë...? «Ujë për hasmin. Ai vetëm plumbin do. Atë do dhe ti, or qen.»

Ballisti lidhi litarin në vjegë. Zbriti pllakën e gurit që zinte grykën dhe vështroi poshtë. Goga iu afrua prapa. Ballisti e ndjeu dhe ktheu kokën.

— Mos u afro, plakë, — foli ballisti.

Ajo ndali. E kuptoi se ai i ruhej. Si t'i afrohej? Ballisti ktheu përsëri kokën me frikë.

— Çfarë mendon, plakë? Pse je nxirë si reja e shiut?

Ai kishte nxjerrë një kovë, por të dytën nuk po mundte. Kova diku kishte ngecur. «He, barklopë, nuk e ngre dot, se të janë rënduar tulet?» Ballisti jepte e merrte me kovën dhe nuk harronte të kthente kokën nga ajo. Goga kishte mbetur në vend. Befas nisi të këndonte e të

vështronte gjetkë. Gryka i qe tharë dhe zëri
mezi i dilte. Ballisti e pa dhe tundi kokën. Go-
ga këndonte me zor. Në pushimet që bënte hi-
dhte një hap drejt ballistit. Ishte afruar pranë,
aq sa i ndjeu erën e djersës përzier me të ra-
kisë. Zëri i saj sa vinte e ulej. Por ajo nuk don-
te t'i fikej zëri. Fjalët mezi i nxirrte, me ca no-
ta dridhëse e që e rrëqethën ballistin. Ajo qe
afruar aq, sa e fshiku me frymën e këngës,
pastaj menjëherë ia vendosi pëllëmbën ndër
këmbë, e ngriti peshë trupin e tij dhe e lëshoi
kokë poshtë në grykën e pusit. U dëgjua një
ulërimë e thellë. Pastaj një mbllacitje në ujin
e errët. Goga e ngriti pllakën mbi grykë dhe
mori frymë thellë. Mbllacitjet u shuan përgjith-
një. Ajo e ndjeu veten të qetë dhe nuk e kuptoi
pse pati dëshirë të këndonte përsëri.

Ishte mëngjes herët. Qielli po çahej. Dielli
nxori syrin e kuq nga maja e Tomorit dhe der-
dhi mbi stan e gjetkë dritën e mëngjesit.

Kam mall për këngë

— Të na ngrohet zemra, o bij, t'ia marrim një këngë, se edhe udha sikur bëhet më e lehtë. Shpuzë ta bën zemrën në këtë të ftohtë.

Dhe vërtet, shkurti nuk po e linte ngricën, edhe pse ishin ditët e fundit. Ato po kalonin mes acarit e thuprës së mprehtë të erës që të priste. Qielli nuk mbante re, por dielli mezi të ngrohte lëkurën. Toka gdhihej gur e fortë, por, kur dielli ngjitej në kupën e qelqtë, ajo zbutej si moçal. Këmbët ngjitnin, pastaj në të përpjetë rrëshqitnin e gjithë ajo udhë që bënë u

mbush me brazda të holla, të çrregullta, që nga-
tërroheshin njëra me tjetrën.

Ata kishin lënë të ecte në krye Ndon Bërdi-
llën. Kjo ngjante si e bërë me dashje, me-
gjithse ata nuk kishin marrë një vendim të til-
llë. Ai ishte më i moshuari në atë grup, dhe ata,
pa e kuptuar, duke ecur, kishin lënë distancë e
dalngadalë në krye printe më plaku i grupit.

Grupi përbëhej prej shtatë vetash. I shtati
hyri në fshatin e fundit që kaluan. Ndon Bër-
dilla priste të shtoheshin akoma. Ai u nis ve-
të i tretë nga fshati. Fshatin e parë e gjetën gër-
madhë. Autokolona italiane që kishte kaluar një
ditë më parë e kishte djegur. Fshatarët qenë
ngjitur të tërë në mal. Nga ato familje që zbri-
tën atë mëngjes u shkëputën dy. Kështu u bë-
në pesë. Pasi ecën edhe një orë, hynë në një
fshat tjetër. Edhe ky qe djegur. Midis gërma-
dhave gjetën një fëmijë në djep. Në gjoks i
kuqëlonte njolla e gjakut, kurse fytyra ngjante
sikur qeshte ende. Armiku do ta kishte vrarë
kur ajo qeshte, dhe ashtu i qe ngrirë fytyra.
Përreth nuk dukej frymë njeriu. Kur u nisën,
nga gërmadhat doli një burrë çehrevrarë. Ai
tha se ishte i ati i fëmijës. Qëndroi para djepit
dhe ata vunë re se sytë iu lagën. Kur ata ikën,
ai i ndoqi pas, duke shkelur gjurmët e tyre.
Rrugës mësuan se quhej Belo. Ishte i madh,
shpatullgjerë, kur ecte kërrusej disi. Fytyra e tij
ishte katrore dhe atje zbuloje një qetësi të çu-
ditshme. Ishte qetësia e vuajtjes... Kurse i shta-
ti e pati të vështirë të hynte. Ai erdhi duke
hequr zvarrë një patickë italiane që fshikte dhe-
un. Ndon Bërdilla e pa me vëmendje, por nuk
iu mbush syri. Ai quhej Sotir, një djalosh i imët,
buzaç, me një ecje të shpejtë, që e tregonte të
shkathët. Hoqi pushkën nga supi dhe mblodhi
rripin. Ndon Bërdilla iu afrua dhe i rregulloi

pushkën në sup, që as tyta e gjatë e as qyta e rëndë të mos preknin tokën. Ky veprim i çeli fytyrën djaloshit, sepse komandanti po e pranonte në grup.

Pra ata qenë shtatë dhe prisnin të bëheshin më shumë. Toka kishte nisur të ngrinte përsëri në buzëmbremjen e asaj dite. Ata kaluan qafën dhe fshati i fundit u zhduk nga sytë. Atëherë u ndje dhe zhurma e autokolonës armike. Ajo zvarritej teposhtë me uturimë për në fshatrat e tjera. Ndon Bërdilla u tha të mos ndaleshin, por të vazhdonin udhën e malit. Pas këtyre fjalëve, ai propozoi t'ia merrnin këngës. Dhe e nisi vetë i pari:

Qajnë malet me lot...

Zëri iu duk i huaj. Shokët e pasuan dhe ai harroi se donte ta niste përsëri nga fillimi.

Në fushë e në brinjë...

Vazhdoi kënga. Ata hidhnin hapin me ritmin e këngës. Ndon Bërdilla u printe. Në gjoks, fshehur thellë nën xhamadanin e leshtë, mban-te letrën që i dha kryetari i këshillit në Selë. Shumë-shumë shokët e malit do t'i ndeshte të nesërmen në mëngjes.

Dhe erdhi një çast kur këngën e vazhduan shokët. Kurse ai mendonte dhe dëgjonte. Kanë mall për këngë, tha. Gjer atëherë këngën e kishte mbytur krisma e pushkës. Çfarë kishte rrëfyer udhës Sotiri? Gjashtë vjet jetoi jetim. Babanë ia vrau plumbi i hasmit. Pastaj i vdiq nëna nga veremi. U rrit për mëshirë. Një herë kishte shkuar gjer në buzë të greminës, por një fshatar i mirë e mbajti me krodhat e veta... Tani ai po këndonte. Sa të mirë e kishte zërin.

Zëri i hollë i djalit i kujtoi shtëpinë dhe i dhembti gjoksi. Të kishte ai një fëmijë, e donte. Por sëkëlldi nuk kishte vënë. Në Selë, në kasollen e stanit, atje buzë pyllit, kishte lënë gruan e vet, Rukën qyqare. Dhe kur një herë Maliq beu e kishte pyetur se ç'fëmijë kishte, ai ia fshehu.

«Kam një djalë, bej», kishte thënë.

«Ku e ke?» kishte pyetur beu.

«Atje në kasolle e kam.»

Beu kishte qeshur fort, duke nxjerrë stërka-la pështyme.

«Ti nuk ke as pleshta, o Ndon Bërdilla.»

Ndon Bërdilla nuk i qe përgjigjur e kishte ikur. Kur shkoi në stan, u bind edhe një herë se Ruka ishte djalë e kaluar djalit. Borxh ia kishte beu, një ditë do ta kujtonte atë fjalë.

Kënga kishte heshtur me kohë. Po afronte nata, por ata nuk do të ndaleshin. Ishin shtatë, por prisnin të bëheshin më shumë. I gjashiti, Beloja, pyeste Sotirin:

— Ku po shkon, o çamarrok?

— Atje ku po shkon edhe ti.

— Unë shkoj në dasmë, — ia priti Beloja, — në dasmën e armikut. Do ta martojmë me vdekjen.

— Në atë dasmë shkoj, — tha Sotiri.

— Me atë pushkë do vrasësh armikun ti?

— Do të rrëmbej të tjera, — u përgjigj Sotiri.

— Ç'ke që e ngacmon? — foli Ndon Bërdilla

— Nuk hidhet në shteg me fjalë, — tha Beloja.

— Merru me perëndinë, — tha ai.

— Ku është, nuk e shoh.

— Ngrije kokën lart, se atje do ta gjesh.

Beloja ashtu bëri, por s'pa gjë.

Atë ditë Ndon Bërdilla kishte mall për këngë. Pse s'po këndonin ata? Ishte natë dhe qetësi. Qielli lart ndezi yjet si ca qirinj të largët, të zbehtë, që dridheshin nga thupra e erës në lotimin e syve. Hijet e zhveshura të pemëve hollheshin edhe më, të shkrira në tokë. U dëgjuan të lehura qensh. Poshtë ishte fshati. Ndon Bërdilla e urrente heshtjen. Në fshat vendosi të hynte me këngë. Po cilën këngë të zinte? Ndër mend i erdhën këto fjalë dhe këndoi:

*Moj thëllëza në dafinë,
pse s'dërgove kartë tinë,
me ata që venë e vijnë?*

Hapësira e ftohtë e natës kumboi nga shtatë zëra. Gjysma e fshatit u zgjua. Dikush nxori një qiri në dritare dhe pa jashtë. Priste të shihte muhaxhirë. Por ata nuk qenë të tillë. Shkonin drejt lirisë. Muhaxhiri nuk këndon, atij i pikon zemra. Kënga e tij është vajtim e dhembje. Kurse kënga e tyre po ushtonte portë më portë. Diku Ndon Bërdilla ndali. Porta u hap vetiu. Miku që zgjuar me kohë.

— Zgjove tërë fshatin, Ndon Bërdilla.

— Boll ka fjetur.

Miku i vjetër nuk po e hapte portën.

— Ku e ke djalën? — tha Ndon Bërdilla.

— Nuk e kam këtu, — tha prerë miku.

— Mos e fshih. Njeriu i fshehur nuk ka duk.

— Nuk e fsheh, dëgjo t'anë. Prandaj erdhe?

— Erdha se të kisha mik. — Fjalën «të kisha»

e theksoi fort. Miku të porta po priste. Çfarë

priste ai? Ndon Bërdilla i ktheu shpinën. «Si

të hedhësh këmbët, ashtu do të ta heq vallen»,

tha me vete. Heshtja mbulonte grupin. Ata

ikën nëpër fshat. Kush e preu këngën? Dikush

i foli në emër nga ana e gardhit. Hajde, tha ai.

Kush donte lirinë, të bashkohej. Ishin dhjetë në të dalë të fshatit. Ai nuk e ktheu kokën asnjëherë. Kush ecën përpara, vështron drejt, larg.
— Kam mall për këngë, komandant!

Çeta ngjitej përherë. Pse s'po këndonin ata? Po cilën këngë?... Atë që këndonte kur ruante dhitë me të atin. Bile tani u kujtua se atë këngë ia mësoi ditën kur i ra fyellit për herë të parë... U ulën aty nën hije. Dhitë vaponin, i ati ia kishte marrë dhe atij i ngjau së e tha për herë të parë. Po si e tha? Ngadalë ngriti zërin dhe këndoi. Ashtu në këngë u përpoq të kujtonte zërin e të atit. Ndali. Si e kishte nisur ai? Ja kështu:

*Verdhoni, moj, verdhoni,
rrëzë rrapit vaponi,
rrëzë rrapit që po flet,
o Jonuz, me trembëdhjetë.*

Ai kishte menduar se, po ta pyeste të atin, nuk do t'i thoshte dot ato fjalë pa këngë. Më vonë i mësoi mirë, se këngën e dëgjoi shpesh.

Çeta po këndonte e tëra. Ndon Bërdilla pati dëshirë t'i përqafonte të gjithë. Kërkoj Sotirin me sy. E dalloj në fund dhe ngadalësoj hapat. U lodh vogëlushi, mendoi. Sotiri, si t'ia kishte lexuar mendimin në ballë, vrapoi e i qëndroi në krah. Ndon Bërdilla i hodhi dorën në sup e vazhdoi këngën.

Nata që e ftohtë dhe e mugët. Edhe qielli lëshonte dritë. Çdo send formonte hijen e vet. Pylli që rrëzuar i tëri në tokë, në ca vija të errëta e të çrregullta. Era e mprehtë dhe e akullt përplasej në degë me fishkëllimë. Ata nuk i ndienin këmbët. Kishin përpara një natë për të kaluar. Dhe do ta kalonin patjetër.

Pastaj do të agonte dhe do të gjenin shokët. Ndon Bërdilla u tha edhe një herë të mos e pushonin këngën. Kënga e tyre si një zë kushtrues trembte natën. Dikush nga të ardhurit ia mori rishtas këngës.

Kurse ai kujtonte fshatin. Ç'bënte Ruka vetëm në atë kohë në stan? Mirë i tha beut, «kam një djalë».

Ajo e përçolli deri në të dalë të fshatit.

«Nuk të nis për kurbet, por për liri», i kishte thënë.

«Ruaj stanin», i kishte thënë ai duke e parë në sy. Në vështrimin e saj dalloi vendosmëri e besnikëri.

Ata donin të qëndronin gjatë ashtu, por qenë të moshuar e nuk u kishte hije. Ai pati dëshirë të merrte edhe një këngë, së fundi, siç bënin mbrëmjeve në stan:

*Vllahu trimi prej malit,
e la nusen i hipi kalit.
Vllahu trimi me fustanë,
zjarr të kuq bëri dynjanë.*

Shokët e prenë këngën. Ai duhej të kishte kënduar me zë. Asnjë nga shokët nuk këndoi, sepse atë këngë nuk e dinin. Ai e kuptoi. Dhe vendosi t'ia mësonte grupit. E donte këngën e vjetër Ndon Bërdilla, sepse nuk qe pa gjë ajo.

Ndali grupin dhe thirri Belon e Sotirin. Vogëlushi dukej i lodhur, por nuk e jepte veten. Pas pak kënga mbushi tërë hapësirën e ftohtë të heshtjes. Çeta këndonte dhe atij iu bë zemra mal.

Duhej të kishte vajtur mesnata, se yjet u shtuan në qiell. Toka kërciste nën këmbë. Larg u dëgjuan gjëmime të forta, që mbushën natën me zhurmën e tyre. Autokolona armike duhej të

qe ndalur diku. Kushedi, ndoshta kishte rënë në përpjekje me partizanët. Jehona e gjëmimeve përcillej mal më mal. Kurse çeta e vogël ecte e këndonte. Dikush u rrëzua atje poshtë e dikush tjetër i dha dorën. Më tej duhej të ishte një fshat. Dhe vërtet, pas pak ai dalloj kasollet si ca njolla të errëta. Zbritën tatëpjetë duke u rrëzuar aty — këtu në tokë, derisa dëgjuan të lehurat e qenve.

Kasollet e fshatit dalngadalë po shquheshin mirë në brinjë. Duhej të kishte kaluar mesnata dhe fshati do të qe në gjumë të thellë. Por kënga të zgjon edhe prej varri. U dukën dritat e para. Dikush kishte ndezur kandilin, dikush tjetër zjarr në vatër. Atë nuk e pushuan këngën. Fshati duhej të zgjohej i gjithi. Por shtëpia e Ilo Dimës nuk po e ndizte dritën. Ilo Dima ishte miku i tij i vjetër.

Trokiti në portën e tij, por, për çudi, ajo qe e hapur. Ndon Bërdilla u tha të mos e ndërpritnin këngën. Ndërkohë hodhi hapat në oborr të shtëpisë.

— Këngë paçi përherë në zemra, — foli dikush nga kreu i oborrit. Ishte Ilo Dima.

— A do miq, o Ilo Dima?

— Ajo derë që ka miq, është e nderuar, — ia priti tjetri.

Kënga u pre vetiu.

— Përse s'ka dritë shtëpia? — pyeti Beloja.

Ilo Dima heshti një copë herë dhe vështroi lart.

— Jam në mort, — tha, — më ka vdekur vajza e vogël.

Ndon Bërdilla nuk la të vazhdonte heshtja. Në këto çaste ajo rëndon si shkëmb. Ndaj tha:

— Të na ndjesh, se nuk e dinim, or mik. Erdhëm për këngë, por qenke në mort.

— Kënga e harron mortin, harrojmë edhe fjallet, — foli ngadalë Ilo Dima.

— Rrofsh e qofsh, — tha Ndon Bërdilla dhe u kthye.

— Prisni! — thirri Ilo Dima dhe humbi në errësirën e shtëpisë.

Në oborr ishin shtuar radhët. Ndon Bërdilla nuk u besonte syve. Ai tani s'mundi t'i dallonte të gjithë.

Ilo Dima doli bashkë me djalin. Kur iu afruan grupit, ndalën dhe u përqafuan fort. Pastaj djali hyri në grupin e tij, E ndërsa ata largoheshin, Ilo Dima u foli me zë të lartë nga pragu:

— Thirre përherë këngën, Ndon Bërdilla!

Çeta u nis për udhë përsëri. Edhe pak natë kishte. Fshati mbeti në qetësinë e frikshme që mbartte mbi shpinë. Edhe pak e do të agonte. Si ta vritnin edhe atë pak natë që kishte mbetur? Heshtnin. Errësira të dikton heshtjen. Nga larg era e ftohtë solli përsëri gjëmime. Bëhej luftë, luftonte ajeta me vdekjen, liria me shtypjen e robërinë. Luftë e ashpër kjo. Në fshat kishin thënë se armiku ishte egërsuar sepse po i vinte fundi e, për hakmarrje, rrafshonte fshatra. Por zemra e një populli nuk rrafshohet. Kur të thërret liria, s'ka forcë që të të mbajë. Heshtjen e natës po e mbushnin vetëm gjëmimet. Pse s'po këndonin? Befas, nga grupi u dëgjua një zë që u ndje një çast në errësirë si një shkëndijë që ndez zjarrin e madh. U ndje edhe një çast dhe heshti. I tërë grupi heshtte. Kush do të qe ai? Ndon Bërdilla nuk po e njih-te. Pa mbaruar mendimin, zëri u ndje përsëri. Këtë radhë më shtruar. Kur të gjithë prisnin të shuhej, ai kumbol më fort.

Atëherë Ndon Bërdilla njohu zërin e djalit të Ilo Dimës. Atë e pasoi një zë tjetër. Ishte

Beloja. Kënga mbeti ende varur mbi kokat e shokëve. Ai priti të dëgjonte më mirë fjalët:

*Është lufta finale, vendimtare mbi dhe,
Internacionale do të jetë bota e re!*

Dhe ia nisi me zë të lartë. Kënga çori hesh-tjen dhe errësirën dhe mbushi çdo gjë përreth. Ndon Bërdilla preku edhe një herë letrën që i dha kryetari i këshillit në fshat dhe në mes të këngës ngriti zërin e tha:

— Kam mall për këngë. Kënga—i mbledh trimat.

Çeta ecte e këndonte. Ai mendoi paskëtaj për shokët e malit. Ata tani nuk qenë larg. Edhe gjëmimet po ndiheshin më pranë.

1870
1871
1872
1873
1874
1875
1876
1877
1878
1879
1880
1881
1882
1883
1884
1885
1886
1887
1888
1889
1890
1891
1892
1893
1894
1895
1896
1897
1898
1899
1900

1901
1902
1903
1904
1905
1906
1907
1908
1909
1910
1911
1912
1913
1914
1915
1916
1917
1918
1919
1920
1921
1922
1923
1924
1925
1926
1927
1928
1929
1930

1931
1932
1933
1934
1935
1936
1937
1938
1939
1940
1941
1942
1943
1944
1945
1946
1947
1948
1949
1950
1951
1952
1953
1954
1955
1956
1957
1958
1959
1960

1961
1962
1963
1964
1965
1966
1967
1968
1969
1970
1971
1972
1973
1974
1975
1976
1977
1978
1979
1980
1981
1982
1983
1984
1985
1986
1987
1988
1989
1990

1991
1992
1993
1994
1995
1996
1997
1998
1999
2000
2001
2002
2003
2004
2005
2006
2007
2008
2009
2010
2011
2012
2013
2014
2015
2016
2017
2018
2019
2020

2021
2022
2023
2024
2025
2026
2027
2028
2029
2030
2031
2032
2033
2034
2035
2036
2037
2038
2039
2040
2041
2042
2043
2044
2045
2046
2047
2048
2049
2050

2051
2052
2053
2054
2055
2056
2057
2058
2059
2060
2061
2062
2063
2064
2065
2066
2067
2068
2069
2070
2071
2072
2073
2074
2075
2076
2077
2078
2079
2080

2081
2082
2083
2084
2085
2086
2087
2088
2089
2090
2091
2092
2093
2094
2095
2096
2097
2098
2099
2100
2101
2102
2103
2104
2105
2106
2107
2108
2109
2110

2111
2112
2113
2114
2115
2116
2117
2118
2119
2120
2121
2122
2123
2124
2125
2126
2127
2128
2129
2130
2131
2132
2133
2134
2135
2136
2137
2138
2139
2140

2141
2142
2143
2144
2145
2146
2147
2148
2149
2150
2151
2152
2153
2154
2155
2156
2157
2158
2159
2160
2161
2162
2163
2164
2165
2166
2167
2168
2169
2170

2171
2172
2173
2174
2175
2176
2177
2178
2179
2180
2181
2182
2183
2184
2185
2186
2187
2188
2189
2190
2191
2192
2193
2194
2195
2196
2197
2198
2199
2200

2201
2202
2203
2204
2205
2206
2207
2208
2209
2210
2211
2212
2213
2214
2215
2216
2217
2218
2219
2220
2221
2222
2223
2224
2225
2226
2227
2228
2229
2230

2231
2232
2233
2234
2235
2236
2237
2238
2239
2240
2241
2242
2243
2244
2245
2246
2247
2248
2249
2250
2251
2252
2253
2254
2255
2256
2257
2258
2259
2260

2261
2262
2263
2264
2265
2266
2267
2268
2269
2270
2271
2272
2273
2274
2275
2276
2277
2278
2279
2280
2281
2282
2283
2284
2285
2286
2287
2288
2289
2290

PASQYRË E LËNDE

Një mbrëmje vonë	3
Edhe gabon... ..	15
Gjyshi	28
Lirikat e dy stinëve	38
Rita	47
Në të kthyer të vitit	56

MALLI PËR KËNGE

Vajza e bariut	67
Kënga del nga shpirti	81
Goga	95
Kam mall për këngë	100